



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Drejtësisë  
Studime të ciklit të dytë  
Programi studimor “E drejta civile”

## TEZA E MAGJISTRATURËS

Tema:

“Kontrata e përfaqësimit në legjislacionin dhe praktikën e  
Republikës së Kosovës dhe në të drejtën komparative”

Kandidati:  
Egzon Gajtani

Mentori:  
Prof. dr. Emine Zendeli

Tetovë, 2019



## Tabela e përmbajtjes

Hyrja.....	5
<b>KAPITULLI I .....</b>	<b>6</b>
1. Instituti i përfaqësimit .....	6
1.1. Llojet e përfaqësimit.....	8
2. Zanafilla dhe zhvillimi i institutit të përfaqësimit .....	12
2.1. Përfaqësimi dhe kontrata e përfaqësimit në të drejtën romake .....	13
2.2. Përfaqësimi dhe kontrata e përfaqësimit në të drejtën mesjetare .....	16
2.3. Përfaqësimi dhe kontrata e përfaqësimit në të drejtën moderne.....	18
2. Kontrata e përfaqësimit.....	20
2.1. Karakteristikat e kontratës së përfaqësimit .....	21
2.3. Palët e kontratës së përfaqësimit .....	22
3. Kushtet për lidhjen e kontratës së përfaqësimit.....	23
3.1. Puna e përfaqësuesit .....	24
3.2. Shpërblimi i përfaqësuesit.....	25
3.3. Zgjatja kohore e kontratës së përfaqësimit .....	26
4. Shuarja e kontratës së përfaqësimit.....	26
4.1. Shuarja e kontratës me marrëveshjen e palëve .....	26
4.2. Shuarja e kontratës me kryerjen e punës .....	27
4.3. Shuarja e kontratës me skadimin e kohës .....	27
4.4. Shuarja e kontratës me humbjen e aftësisë së veprimit të përfaqësuesit ose të përfaqësuarit .....	27
4.5. Shuarja e kontratës me vdekjen e përfaqësuesit ose të përfaqësuarit .....	28
4.6. Shuarja e kontratës për shkak të pamundësisë së kryerjes së punës .....	28
4.7. Shuarja e kontratës me revokim .....	29
4.8. Shuarja e kontratës me denoncim .....	30
5. Pasojat e shuarjes të kontratës së përfaqësimit .....	30
<b>KAPITULLI II .....</b>	<b>31</b>
1. Efektet e kontratës të përfaqësimit .....	31
1.1. Të drejtat dhe detyrimet e të përfaqësuarit.....	31
1.2. Të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit.....	33
2. Llojet e autorizimit.....	34
2.1. Autorizimi i përgjithshëm .....	34
2.2. Autorizimi i veçantë.....	35
2.3. Autorizimi i pakufizuar .....	36
2.4. Autorizimi i kufizuar .....	36
2.5. Autorizimi shprehimor .....	36
2.6. Autorizimi i heshtur .....	37
2.7. Autorizimi i njëfishtë .....	37
2.8. Autorizimi i shumëfishtë .....	37
3. Krahasimi i kontratës së përfaqësimit.....	38
3.1. Kontrata e përfaqësimit dhe përfaqësimi ligjor .....	38
3.2. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata e ndërmjetësimi.....	39
3.3. Kontrata e përfaqësimit dhe prokura .....	41
3.4. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata në dobi të personit të tretë.....	42
3.5. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata për veprën .....	44
3.6. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata e shitjes me dekret.....	45

**KAPITULLI III ..... 46**

<b>1. Kontrata e përfaqësimit në Kosovë .....</b>	<b>46</b>
2.1. Kuptimi i kontratës të përfaqësimit .....	46
2.4. Autorizimi .....	47
2.4.1. Bartja e autorizimeve .....	47
2.4.2. Tejkalimi i kufirit të autorizimit .....	48
2.4.3. Lidhja e kontratës nga personi i paautorizuar .....	50
<b>2. Prokura.....</b>	<b>51</b>
3.1. Dhënia e prokurës .....	52
3.2. Forma e veçantë e prokurës .....	53
3.3. Vëllimi i prokurës.....	53
3.4. Revokimi dhe kufizimi i prokurës .....	54
3.5. Shuarja dhe kufizimi i prokurës ndaj personave të tretë .....	54
3.6. Rastet e tjera të shuarjes së prokurës.....	55
<b>3. Autorizimi afarist .....</b>	<b>56</b>
4.1. Autorizimi i punonjësit .....	56
4.2. Përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve .....	57
<b>4. Kontrata e përfaqësimit tregtar .....</b>	<b>58</b>
5.1. Forma dhe lidhja e kontratës të përfaqësimit tregtar .....	59
5.1.1. Lidhja e kontratës në emër të urdhërdhënësit .....	60
5.2. Lloji i përfaqësimit tregtar .....	60
5.3. Pranimi i përmbushjes .....	61
5.4. Pranimi dhe ekzekutimi i deklaratave .....	61
5.5. Masat e sigurimit .....	62
5.6. Efektet juridike të kontratës të përfaqësimit tregtar .....	63
5.6.1. Detyrimet e përfaqësuesit tregtar .....	63
5.6.2. Detyrimet e urdhërdhënësit .....	67
5.7. E drejta e pengut e përfaqësuesit tregtar .....	71
5.8. Shuarja e kontratës të përfaqësimit tregtar .....	72
5.9. Harmonizimi i kontratës së përfaqësimit tregtar me direktivën evropiane mbi agentët tregtar ...	74

**KAPITULLI IV..... 77**

<b>1. Kontrata e përfaqësimit në regjion .....</b>	<b>77</b>
1.1. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Maqedoninë e Veriut.....	77
1.2. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Shqipëri .....	78
<b>2. Kontrata e përfaqësimit në shtetet e tjera .....</b>	<b>80</b>
2.1. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Itali .....	80
2.2. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Zvicër .....	83
2.3. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Gjermani .....	85
2.4. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Francë.....	88
<b>Përfundim dhe rekomandime .....</b>	<b>91</b>
<b>Literatura e shfrytëzuar .....</b>	<b>94</b>
<b>Modele të kontratës së përfaqësimit, prokurës dhe autorizimit .....</b>	<b>96</b>
Shembulli Nr. 1 .....	96
Shembulli Nr. 2 .....	98
Shembulli Nr. 3 .....	100
Shembulli Nr. 4 .....	101

## Hyrja

Kjo tezë synon të analizojë në mënyrë sistematike institutin e përfaqësimit i cili është një prej instituteve më të rëndësishme në sferën ligjore, veçanërisht në të drejtën detyrimore dhe tregtare. Një numër i veprimeve juridike nuk do të ishin të mundura në qoftë se nuk do të ekzistonte përfaqësimi. Ky institut e ka zanafillën e lashtë dhe përgjatë kohës e ka ndryshuar formën e tij, por qëllimi për të cilin është krijuar ngelet gjithmonë i njëjtë. Qëllimi i përfaqësimit, gjegjësisht kontratës së përfaqësimit ka qenë, është, dhe gjithmonë do të jetë lehtësimi i veprimeve të njeriut në sferën juridike materiale dhe në atë procedurale. Elementet e para të përfaqësimit janë paraqitur në formë krejtësisht ndryshe nga mënyra se si sot është i rregulluar përfaqësimi, por që kanë qenë të domosdoshme në formësimin e institutit aktual të përfaqësimit.

Punët juridike zakonisht i kryejnë vetë personat fizik gjegjësisht personat juridik, por në raste të caktuar subjektet e së drejtës nuk janë në gjendje që vetë të ndërmarrin veprime juridike të caktuara apo t'i kryejnë punët juridike. Për shkak të paraqitjes të rasteve të tilla që do të trajtohen në vazhdim të kësaj teze, lindi nevoja për përfaqësim gjegjësisht ekzistimin e kontratës së përfaqësimit. Përmes kontratës së përfaqësimit, një subjekt i së drejtës autorizon një subjekt tjetër të së drejtës që në emër dhe llogari të tij, të ndërmarrë veprime të caktuar juridike dhe t'i kryejë punët e besuara. Kontrata e përfaqësimit është një nga kontratat kyçe në të drejtën detyrimore dhe tregtare, ku edhe është simbol për këto dy degë të së drejtës.

Arsyeja e hulumtimit mbi këtë temë është për shkak se kontrata e përfaqësimit paraqet një kontratë të rëndësishme në qarkullimin juridik dhe është e aplikueshme në shumë degë të së drejtës. Mirëpo edhe duke e kuptuar rëndësinë që kjo kontratë ka, nuk është trajtuar aq sa meriton në literaturën juridike në gjuhën shqipe. Kështu që duke e vërejtur rëndësinë që e ka, dhe neglizhimin që kjo kontratë ka hasur, si nga ligjvënësi po ashtu edhe nga literatura juridike, vendosëm të hulumtojmë mbi këtë kontratë në mënyrë që të pasurohet literatura juridike në gjuhën shqipe. Duke e marrë parasysh që instituti i përfaqësimit është një temë shumë e gjerë, përqendrimi i ynë do të jetë mbi kontratën e përfaqësimit, gjegjësisht do të përqendrohemi në rëndësinë e kësaj kontrate, zanafillën, elementet thelbësore dhe llojet e kësaj kontrate, si dhe do të krahasohet rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Kosovë me rregullimin ligjor të kësaj kontrate në legjislacionet e shteteve të ndryshme.

# KAPITULLI I

---

## Përfaqësimi dhe kontrata e përfaqësimit

---

### 1. Instituti i përfaqësimit

Nevoja për përfaqësim paraqitet për shkak se personat nuk mund t'i ndërmarrin vetë të gjitha veprimet juridike apo t'i lidhin punët juridike, kjo nënkupton që subjektet e së drejtës në disa raste nuk mund t'i realizojnë autorizimet që paraqesin përmbajtjen e të drejtave të subjekteve civile, ashtu edhe detyrimet që paraqesin përmbajtjen e raporteve juridiko-civile. Arsyet e pamundësisë së ndërmarrjes së veprimeve juridike dhe lidhjes së punëve juridike mund të jenë të natyrës juridike dhe faktike.

- Arsyet juridike për pamundësinë e ndërmarrjes dhe lidhjes së punëve juridike paraqiten për shkak mungesës të zotësisë së veprimet të përfaqësuarit, e cila sjell në pamundësi të shprehjes së vullnetit si element esencial në lidhjen e punëve juridike.
- Arsyet faktike vijnë në shprehje kur subjekti i së drejtës e ka të pamundur të ndërmarrë ose lidhë punët juridike për shkak të mosprezencës ose mungesës së aftësisë së veçantë profesionale ose juridike, e domosdoshme për lidhjen e punës përkatëse.<sup>1</sup>

Në parim, përfaqësimi është i mundur tek të gjitha punët juridik përveç punëve me karakter të theksuar personal, në rastet kur ligji e ka paraparë se një punë e caktuar nuk mundet të lidhet me përfaqësim, si p.sh. me lidhjen e martesës.<sup>2</sup> Për lidhjen e martesës në fakt, është e nevojshme prezenca e të dy të personave ndërsa përjashtimisht në rastet e veçanta mund të lejohet, që martesa të lidhet në prezencën e njërit nga bashkëshortët e ardhshëm dhe përfaqësuesit të tjetrit.<sup>3</sup>

Është i pakontestueshëm fakti që në mungesë të përfaqësimit, qarkullimi juridik nuk mund të funksionojë. Rëndësia e përfaqësimit vërehet përmes funksioneve të përfaqësimit:

- Funkzioni i parë i përfaqësimit ndërlidhet me pamundësinë e personave me zotësi të kufizuar të veprimit apo pa zotësi të veprimit, për të shprehur vullnetit e tyre

---

<sup>1</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 197). *Опит дел на граѓанското право*. Шкуп.

<sup>2</sup> Ligji për familjen (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 2004/32). Neni 28.

<sup>3</sup> Станковић, О. dhe Водинић, В. (2007, fq. 194). *Увод у граѓанско право*. Београд.

në lidhjen e punëve juridike. Përmes këtij funksioni, personat pa zotësi veprimi ose me zotësi të kufizuar të veprimit lidhin punët juridike përmes përfaqësuesve të tyre, të cilët do të lidhin punët juridike në emër dhe llogari të tyre.

- Funksioni i dytë i përfaqësimit i mundëson personave fizik dhe juridik që në të njëjtën kohë të ndërmarrin veprime juridike dhe të lidhin më tepër punë juridike përmes përfaqësuesve.
- Funksioni i tretë i përfaqësimit mundëson realizimin efikas të procedurave juridike të personave që nuk u dihet vendbanimi ose vendqëndrimi, si dhe në rastet kur nuk dihet kush është bartësi i të një drejthe të caktuar subjektive.
- Funksioni i katërt ndërlidhet me rastet kur bartësi i ndonjë të drejthe apo detyrimi të caktuar nuk ka qëllim apo nuk dëshiron për arsye morali të paraqitet në vendin e caktuar dhe të ndërmarrë veprimet e caktuara juridike. Rast të tillë kemi në dhënien e deklaratës për atësi të fëmijës së lindur jashtë martesës i cili mund të realizohet përmes përfaqësuesit.<sup>4</sup>

Me përfaqësim nënkuptojmë kryerje të veprimeve juridike në emër dhe në llogari të huaj. Me këtë nënkuptojmë që një person, kryen punë të caktuara juridike në emër dhe llogari të një personi të tretë. Në institutin e përfaqësimit duhet të ekzistojnë dy palë, dhe ato janë përfaqësuesi dhe i përfaqësuarit. Personi që kryen veprime juridike në emër dhe në llogari të personit tjetër quhet përfaqësues. Ndërsa personi i cili e autorizon përfaqësuesin që të kryej veprime juridike në emër dhe llogari të tij quhet i përfaqësuarit.<sup>5</sup>

Nga definicioni i cekur më sipër, i vërejmë katër elementet konstitutive të përfaqësimit, që janë: veprimi juridik, autorizimi, në emër të huaj, dhe në llogari të huaj. Në esencë përfaqësimi paraqet ndërmarrjen e veprimeve juridike nga ana e përfaqësuesit që sjell në krijimin, ndryshimin ose shuarjen e ndonjë raporti civilo juridik.<sup>6</sup> Për sa i përket elementit të dytë, përfaqësimi themelohet në bazë të autorizimit për përfaqësim. Autorizimi mund të burojë nga: a) ligji; b) akti i përgjithshëm i personit juridik; c) akti i organit kompetent; d) deklarimi i vullnetit të të përfaqësuarit.<sup>7</sup> Meqë përfaqësuesi nuk i ndërmerr veprimet juridike në emër të tij, por në emër të huaj gjegjësisht në emër të përfaqësuarit, në mënyrë të

---

<sup>4</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 235-236). *Општ дел на граѓанското право*. Shkup.

<sup>5</sup> Janevski, A. dhe Zoroska-Kamilovska, T. (2011, fq. 200). *E drejta procedurale civile, e drejta kontestimore* (përkthyer nga Zendeli, E. dhe Zendeli, N.). Tetovë: Universiteti i Evropës Juglindore.

<sup>6</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 204). *Општ дел на граѓанското право*. Shkup.

<sup>7</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 72.

drejtpërdrejtë veprimet juridike e ndërmarra konsiderohen sikur vetë i përfaqësuari t'i ketë ndërmarra. Elementi i katërt i përfaqësimit nënkupton që përfaqësuesi hyn në raporte juridike në emër të përfaqësuarit, respektivisht si palë në punët juridike paraqitet i përfaqësuari e jo përfaqësuesi. Përkatësisht të drejtat dhe detyrimet të cilat burojnë nga ato raporte juridike ndikojnë të përfaqësuarin dhe jo përfaqësuesin.<sup>8</sup>

Roli i përfaqësimit sot është i madh, pa të është e paimagjinueshme jeta jonë e përditshme. Personave pa zotësi veprimi në këtë mënyrë u mundësohet të fitojnë të drejta dhe detyrime nga pothuajse të gjitha punët juridike, gjegjësisht kontratat. Nëpërmjet përfaqësimit organizohet mbrojtja e interesave të personave në mungesë dhe personave që nuk u dihet vendqëndrimi, si dhe u mundësohet personave juridik të marrin pjesë në qarkullimin juridik. Por, sado që të na duket e thjeshtë dhe e natyrshme sot, deri tek kjo nuk është ardhur në mënyrë të menjëhershme, por gradualisht dhe përmes zhvillimit shumë shekullor.<sup>9</sup> Në qarkullim juridik aktual, duhet të kuptohet edhe rëndësia e përfaqësimit vullnetar që nuk ka lindur për shkak mungesave juridike, ose për shkak pamundësisë për qasje në qarkullim juridik, por për shkak të zhvillimit dhe rritjes së numrit të punëve juridike që një subjekt i së drejtës duhet t'i kryejë.

### 1.1. Llojet e përfaqësimit

Autorizimi për përfaqësim themelohet:

- Në bazë të ligjit;
- Me aktin e përgjithshëm të personit juridik;
- Me aktin e organit kompetent
- Në bazë të vullnetit të përfaqësuarit.<sup>10</sup>

Duke e marrë parasysh mënyrën e themelimit, përfaqësimi ndahet në:

- Përfaqësimin ligjor, që themelohet në bazë të mënyrës së parë dhe të tretë të themelimit.
- Përfaqësimi statutor, që themelohet në bazë të mënyrës së dytë të themelimit.
- Përfaqësimi kontraktual, që themelohet në bazë të mënyrës së katër të themelimit gjegjësisht nga vullneti i të përfaqësuarit.

<sup>8</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 208). *Општ дел на граѓанското право*. Shkup.

<sup>9</sup> Станковић, О. dhe Водинелић, В. (2007, fq. 196-197). *Увод у граѓанско право*. Београд.

<sup>10</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 72 paragrafi 2.



Me përfaqësim ligjor nënkuptojmë përfaqësimin e një personi i cili nuk ka zotësi të veprimit ose për arsye tjera nuk ka mundësi që t'i mbrojë interesat e veta. Në këtë rast përfaqësimi nuk krijohet nga vetë vullneti i palëve kontraktuese, por është i paracaktuar nga ligji. Sipas ligjit, përfaqësimi ligjor paraqitet për disa kategori të personave, kur ata nuk kanë zotësi veprimi, apo edhe për shkaqe të përcaktuara në ligj atyre ju nevojitet përfaqësimi ligjor. Përfaqësuesi ligjor ka për obligim që të merr veprimet e nevojshme juridike në interes të përfaqësuarit.

Përfaqësimi ligjor ndahet në: përfaqësim ligjor i drejtëpërdrejtë (përfaqësimi ligjor në kuptimin e gjerë) dhe në përfaqësim ligjor i tërthortë që përbëhet nga përfaqësimi ligjor-gjyqësor dhe përfaqësimi gjyqësor (përfaqësimi ligjor në kuptimin e ngushtë). Përfaqësimi ligjor i drejtëpërdrejtë është përfaqësimi i cili themelohet drejtëpërdrejtë në bazë të ligjit, kur me ligj është i përcaktuar paraprakisht përfaqësuesi i të përfaqësuarit dhe vëllimi i autorizimeve.<sup>11</sup> Shembull tipik i përfaqësimit ligjor është përfaqësimi i personave të mitur dhe personave të rritur për të cilët është vazhduar e drejta prindërore pas arritjes së moshës madhore. Prindërit janë përfaqësues ligjor të fëmijëve të tyre të mitur, me atë që prindërit bashkërisht me marrëveshje kanë të drejtë dhe detyrë ligjore t'i përfaqësojnë fëmijët e tyre të mitur.<sup>12</sup> Në mes adoptuesve dhe të adoptuarit rrjedhin të njëjtat drejta dhe detyrime që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijës, ku adoptuesit po ashtu janë përfaqësues ligjor të adoptuarve të vet të mitur.<sup>13</sup>

Po ashtu personat juridik duhet të kenë një përfaqësues të autorizuar ligjor, i cili do t'i ndërmerr veprimet juridike në emër dhe llogari të personit juridik. Në bazë të ligjit për shoqëri tregtare, në rast kur nuk është paraparë ndryshe me statut apo me marrëveshje të ortakërisë, përfaqësues të autorizuar të shoqërive tregtare janë:

- Për bizneset individuale, përfaqësues është pronari i biznesit individual;
- Për ortakëritë, përfaqësues të autorizuar janë ortakët e përgjithshëm;
- Për korporata, përfaqësues është drejtori gjegjësisht drejtorët menaxhues;
- Për degët dhe zyrat e përfaqësisë të shoqërive të huaja tregtare, janë përfaqësuesit e autorizuar të emëruar nga shoqëria e huaj tregtare.<sup>14</sup>

<sup>11</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 212). *Општ дел на граѓанското право*. Shkup.

<sup>12</sup> Ligji për familjen (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 2004/32). Neni 133.

<sup>13</sup> Po aty, neni 167.

<sup>14</sup> Ligji për shoqëritë tregtare (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 06/L-016). Neni 24.

Përfaqësimi i tërthortë ligjor gjegjësisht përfaqësimi ligjor-gjyqësor dhe përfaqësimi gjyqësor ekziston në rastet kur autorizimet e përfaqësuesit janë të parapara me ligj, por personi i cili vepron në cilësi të përfaqësuesit përcaktohet me akt të organit kompetent ose gjykates.<sup>15</sup> Shembull për përfaqësimin e tërthortë ligjor është përfaqësimi i personave të rritur të cilëve plotësisht ose pjesërisht u është marrë zotësia e veprimit dhe kujdestari caktohet si përfaqësues ligjor i personit nën kujdestari. Në rast se organi i kujdestarisë vendos që detyrën e kujdestarit ta ushtrojë drejtpërdrejtë, atëherë organi i kujdestarisë është përfaqësues ligjor i personave nën kujdestari.<sup>16</sup> Rast tjetër të përfaqësimit të tërthortë ligjor ndodh në rastë të hapjes së procedurës së likuidimit gjegjësisht falimentimit, administratori i falimentimit është përfaqësues i pasurisë falimentuese, gjegjësisht administratori do të administrojë me të gjithë pasurinë falimentuese, ai mund të padisë dhe të jetë i paditur në emër të pasurisë falimentuese, si dhe të kryej detyrat e tjera të përcaktuara.<sup>17</sup>

Një rast tjetër të kemi në të drejtën trashëgimore kur nuk dihen të gjithë ose disa prej trashëgimtarëve, atëherë gjykata cakton kujdestarin e përkohshëm të pasurisë trashëgimore për të përfaqësuar trashëgimtarët në përgjithësi, gjegjësisht kujdestari i përkohshëm është i autorizuar që në emër të trashëgimtarit: të padisë dhe të paditet, të realizojë kërkesat dhe të paguajë borxhet.<sup>18</sup> Një nën lloj i përfaqësimit ligjor në çështje gjyqësore është përfaqësimi i përkohshëm. Përfaqësuesin e përkohshëm e përcakton gjykata në situatën në të cilën duhet domosdo të kryhet ndonjë veprim procedural kundrejt palës që nuk ka zotësi të veprimit, e as përfaqësues ligjor, apo palës që ka zotësi të veprimit, por nuk i dihet vendqëndrimi, ose kur shkaqet e tjera të arsyeshme e kërkojnë këtë gjë të tillë.<sup>19</sup> Përveç përfaqësuesit të përkohshëm, kemi edhe përfaqësuesin e përkohshëm për pranimin e shkresave, i cili caktohet nga gjykata kur i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij, nuk kanë përfaqësues me prokurë dhe ndodhën jashtë shtetit, kurse dërgimi i shkresave nuk ka mundur tu bëhet.<sup>20</sup>

Me përfaqësim statutor të personave juridik nënkuptojmë përfaqësimin tek i cili vëllimi i autorizimeve të përfaqësuesit janë të përcaktuara me statut ose me akt tjetër të përgjithshëm juridik të personit juridik. Përfaqësimi statutor është prezent tek organizatat joqeveritare, ku

---

<sup>15</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 215). *Опит дел на граѓанското право*. Shkup.

<sup>16</sup> Ligji për familjen (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 2004/32). Neni 246.

<sup>17</sup> Ligji për falimentimin (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 05/L-083). Neni 7.

<sup>18</sup> Ligji për trashëgiminë (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 2004/26). Neni 129.

<sup>19</sup> Brestovci, F.; Morina, I. dhe Qehaja Rr. (2017, fq. 105). *E drejta procedurale civile, procedura kontestimore*. Prishtinë.

<sup>20</sup> Ligji për procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 03/L-006). Neni 79.

përfaqësuesi i autorizuar përcaktohet përmes aktit të themelimit dhe statutit të organizatës joqeveritare.<sup>21</sup> Përfaqësimi statutor paraqitet edhe te personat e tjerë juridik, që vetë përmes statutit dhe në përputhje me ligjin, përcaktojnë përfaqësuesit e vet si dhe përcaktojnë llojin e veprimeve dhe punëve juridike që përfaqësuesi mund t'i ndërmerr dhe kryej në emër dhe llogari të personit juridik.

Me përfaqësim vullnetar nënkuptojmë përfaqësimin e një personi në punë juridike dhe ndërmarrjen e veprimeve juridike në emër dhe llogari të tij. Ky lloj i përfaqësimit quhet vullnetar për arsye se krijimi i kësaj marrëdhënie juridike rrjedh nga vetë vullneti i palëve. Ky lloj i përfaqësimit krijohet me lidhjen e kontratës mes dy palëve që janë përfaqësuesi dhe i përfaqësuarit.<sup>22</sup> Në këtë lloj të përfaqësimit përkundrazi llojeve tjera të përfaqësimit, palët nuk kanë ndonjë pengesë ligjore apo mungesë të zotësisë së veprimit, por për shkak të arsyeve të ndryshme si koha e kufizuar, angazhimet e tepërta, rritje të efikasitetit të punëve dhe për shkak të arsyeve të tjera, dëshirojnë që në disa punë juridike të caktuara t'i përfaqësojë një person tjetër dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme juridike në emër dhe llogari të tyre.

Për sa i përket përfaqësimit në procedurat gjyqësore civile, varësisht nëse pala ka zotësi procedurale gjegjësisht të veprimit, kemi përfaqësimin ligjor dhe përfaqësimin me prokurë. Personat të cilët nuk kanë zotësinë procedurale, në procedurën kontestimore përfaqësohen nga përfaqësuesit e tyre ligjor. Përfaqësuesi ligjor i personit fizik caktohet në bazë të ligjit ose në bazë të organit kompetent, ndërsa përfaqësuesi ligjor i personit juridik caktohet me ligj apo me aktin e përgjithshëm të personit juridik.<sup>23</sup>

Ndërsa palët me zotësi procedurale mund të kryejnë veprime në procedurë personalisht ose me anë të përfaqësuesit me prokurë.<sup>24</sup> Përfaqësues me prokurë i palës mund të jetë çdo person që ka zotësi të plotë për të vepruar.<sup>25</sup> Përkundrazi procedurave penale ku si përfaqësues me prokurë mund të paraqiten vetëm një kategori e personave të paraparë me ligj, në procedura civile ligji për procedurën kontestimore e lejon që çdo person që ka zotësi

---

<sup>21</sup> Ligji për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr.06/L-043). Neni 23.

<sup>22</sup> Janevski, A. dhe Zoroska-Kamilovska, T. (2011, fq. 208-209). *E drejta procedurale civile, e drejta kontestimore* (përkthyer nga Zendeli, E. dhe Zendeli, N.). Tetovë: Universiteti i Evropës Juglindore.

<sup>23</sup> Ligji për procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 03/L-006). Neni 75.

<sup>24</sup> Po aty, neni 85.

<sup>25</sup> Po aty, neni 86.

të veprimit të mund të përfaqësojë një person tjetër. Kjo normë hap mundësinë e përfaqësimit me autorizim dhe nuk sanksionon diçka tjetër më shumë. Por se kush ka të drejtë të kryejë përfaqësimin dhe si ekziston kjo e drejtë, është e rregulluar me ligj të veçantë, me ligjin për avokatinë dhe me ligjin për ndihmën juridike falas.<sup>26</sup> Megjithatë sipas ligjit për ndihmën juridike falas, të drejtën për shërbimet e përfaqësimit dhe mbrojtjes në procedura gjyqësore e kanë vetëm avokatët.<sup>27</sup> Këtë e mbështet ligji për avokatinë, ku ceket se të drejtën për dhënien e ndihmës juridike që përfshin edhe përfaqësimin e kanë vetëm avokatët, nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj.<sup>28</sup> Nga e gjithë kjo rezulton se vetëm avokatët mund të ofrojnë ndihmë juridike dhe e kanë të drejtën e përfaqësimit në procedura gjyqësore, edhe se në bazë të ligjit për procedurën kontestimore, çdo person që ka zotësi veprimi mund të përfaqësojë një palë tjetër.

## 2. Zanafilla dhe zhvillimi i institutit të përfaqësimit

Instituti i përfaqësimit ka ekzistuar për një kohë të gjatë dhe është e kuptueshme se me kalimin e kohës ka pësuar ndryshime dhe është shndërruar në institutin që e njohim sot. Është e çuditshme të mendohet që ky institut nuk ka ekzistuar gjithmonë por e ka zanafillën prej një kohe të caktuar, për shkak se aktualisht përdorimi i këtij instituti është i përditshëm. Kuptohet që zanafilla e saktë është vështirë të gjendet, por në bazë të burimeve të ndryshme që do të përmenden në vijim, ky institut ka lindur me lindjen e skllavërisë. Në kohën e zanafillës së tij, ky institut ka qenë i ndryshëm nga instituti i përfaqësimit që e njohim sot. Kështu që nuk mund të themi që ky institut është paraqitur me skllavërimin, por që disa nga elementet thelbësore të këtij instituti janë shfaqur me lindjen e skllavërimit. Me paraqitjen e institutit të përfaqësimit, nuk është paraqitur edhe kontrata e përfaqësimit. Kjo kontratë është paraqitur më vonë me shfaqjen e klasës së avokatëve në çështjet ligjore.<sup>29</sup>

Instituti i përfaqësimit daton rreth shekullit të XII të erës tonë. Zanafilla e këtij instituti ashtu siç njihet sot mendohet të jetë rreth fundit të shekullit XII dhe fillimit të shekullit XIII në

---

<sup>26</sup> Morina, I. dhe Nikçi, S. (2012, fq. 190). *Komentar: Ligji për procedurën kontestimore*. Prishtinë.

<sup>27</sup> Ligji për ndihmë juridike falas (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-017). Neni 29 paragrafi 7.

<sup>28</sup> Ligji për avokatinë (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-193). Neni 10 paragrafi 2.

<sup>29</sup> Hailezgi, A. dhe Damtie, A. (2 mars 2012). *Genesis and development of the law of agency*. Marrur nga: <https://www.abysinnialaw.com/component/k2/item/383-genesis-and-development-of-the-law-of-agency> (qasur më 20 janar 2019)

sistemin anglosakson, ndërsa në sistemin e të drejtës së shkruar daton në mes shekullit XV dhe XVI. Ky institut u shfaq me lindjen e skllavërimit, më saktësisht me lindjen e marrëdhënieve në mes pronarit dhe skllavit.<sup>30</sup> Pronari i skllavit ka qenë i detyruar të përmbush detyrimet ose të kompensoj dëmet e shkaktuar nga skllavi. Në këtë rast pronari ka pasur përgjegjësi për veprimet e skllavit për shkak se skllavërit janë quajtur si objekt e jo persona. Një prej elementeve të institutit të përfaqësimit në këtë marrëdhënie mes pronarit dhe skllavit është përgjegjësia ligjore e pronarit për veprimet e ndërmarra të skllavit me urdhër të tij. Në këtë rast elementi i përgjegjësisë ose i detyrueshmërisë që e ka i përfaqësuar ndaj veprimeve të ndërmarra nga përfaqësuesit brenda autorizimit, është prezent edhe në marrëdhënien mes pronarit dhe skllavit.

Është me rëndësi të ceket një prej rasteve më të rëndësishme të këtij instituti ku për herë të parë konfirmohet parimi i përgjegjësisë të përfaqësuarit ndaj vendimit të përfaqësuesit për blerjen e sendeve me urdhër të përfaqësuarit. Ky rast është *rasti i Costace kundër Forteye* për të cilin është vendosur më vitin 1389 në Londër. Ky është rasti i parë që ka krijuar një precedent mbi këtë parim. Ky rast ka të bëjë me Costace që ka qenë praktikant dhe avokat i një biznesi lokal në Londër, i cili ka blerë verë nga një biznes francez për punëdhënësin e tij në këtë rast si i përfaqësuar, i quajtur Forteye. Në këtë rast punëdhënësi nuk e kishte përmbushur detyrimin e tij të pagesës dhe përfaqësuesi është dënuar me burgim. Kështu që përfaqësuesi është ankuar me pretekstin se ai e ka marrë verën për të përfaqësuarin dhe ai e ka miratuar vendimin e tij. Në këtë rast u morë vendimi që i përfaqësuarit të bëjë pagesën e verës dhe përfaqësuesi të lirohet nga burgi.<sup>31</sup> Përmes këtij rasti për herë të parë u vendos mbi një çështje të institutit të përfaqësimit, ku u vërtetua parimi i përgjegjësisë të përfaqësuarit ndaj veprimeve të përfaqësuesit.

## 2.1. Përfaqësimi dhe kontrata e përfaqësimit në të drejtën romake

Burimi kryesor i legjislacionit pozitiv të Kosovës si dhe të çdo shteti që i përket sistemi euro kontinental është e drejta romake. E drejta romake ka qenë çelësi dhe burimi kryesor në krijimin dhe zhvillimin e së drejtës ashtu siç e njohim sot. Një numër i madh i instituteve kanë ekzistuar prej asaj kohe, por jo të gjithë. Instituti i përfaqësimit nuk ka qenë i njohur në të

---

<sup>30</sup> Hailezgi, A. dhe Damtie, A. (2 mars 2012). *Genesis and development of the law of agency*. Marrur nga: <https://www.abysinnialaw.com/component/k2/item/383-genesis-and-development-of-the-law-of-agency> (qasur më 20 janar 2019)

<sup>31</sup> Po aty.

drejtën romake për arsye se ka qenë i zëvendësuar nga veprimet juridike që marrëdhëniet tjera ekzistente kanë ofruar në atë kohë. Kryesisht ky institut nuk ka ekzistuar për shkak të respektimit të parimit *alteri stipulari nemo potest*. Romakët e quanin jo të logjikshme që një person i tretë të marrë obligime dhe të përfaqësojë një person tjetër në një marrëdhënie juridike apo tregtare. Duhet të ceket që mungesa e këtij instituti filloj të vërehet me zhvillimin e shoqërisë romake. Mungesa e këtij instituti ndërlidhet me mënyrën se si familja ka qenë e rregulluar në mënyrë juridike. Familja ka qenë e rregulluar në atë mënyrë, që fëmijët dhe sklllevërit kanë qenë nën *patriapotestas* të zotit të shtëpisë. Kështu që një pjesë e zbrazëtirës që ka ekzistuar nga mos prezenca e institutit të përfaqësimit, ka qenë e plotësuar nga marrëdhëniet ligjore të krijuara nga mënyra se si familja ka qenë e rregulluar në të drejtën romake, si dhe përmes marrëdhënieve apo instituteve tjera juridike që kanë ekzistuar në atë kohë.

Institutit i përfaqësimit ka qenë i zëvendësuar kryesisht nga veprimet juridike që kanë dalur nga rregullimi i familjes, më saktësisht nga marrëdhëniet që kanë ekzistuar në mes *pater familiasit* dhe fëmijëve të tij, gruas së tij, si dhe sklllevërit e tij. Në sferën tregtare romakët e kishin lehtë që të kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme pa vështirësi, për shkak pushtetit dhe përgjegjësisë që e kishte *pater familiasi* mbi fëmijët dhe sklllevërve. Është për tu cekur që fëmijët dhe sklllevërit nuk kishin zotësi të veprimit dhe çdo gjë që ata ndërmerrnin ishte në llogari të *pater familiasit*, si dhe çdo gjë e fituar i takonte atij. Nuk ishte edhe e rëndësishme nëse *pater familiasi* e kishte urdhëruar kryerjen e një veprimit juridik, si dhe nuk ishte e rëndësishme nëse *pater familiasi* ishte në dijeni. Kështu që fëmijët, sklllevërit dhe gruaja e *pater familiasit* paraqiteshin si përfaqësues të tij dhe kryenin detyrat në emër dhe llogari të tij. Kjo ishte e lejuar për shkak se në të drejtën romake, familja është llogaritur si një njësi ku *pater familiasi* ishte udhëheqësi i kësaj njësie. Personat përmes të cilëve *pater familiasi* e shtrinte përfaqësimin e tij nuk ishin vetëm fëmijët, gruaja e tij dhe sklllevërit e tij, por edhe personat që *pater familiasi* i mbante në uzufukt, si dhe personat që *pater familiasi* ka menduar se janë sklllevër të tij ndërsa ata kanë qenë persona të lirë. Në rastin e tillë kjo nuk ka qenë e konsideruar si përfaqësim por sikur shtrirje të pushtetit të *pater familiasit* tek

anëtarët e familjes së tij. Ndërsa, edhe pse skllëvërit nuk ishin anëtarë të familjes të *pater familiasit*, ata ishin nën pushtetin e tij.<sup>32</sup>

Përveç kësaj, e drejta romake e ka njohur të ashtuquajturin përfaqësimin e tërthortë që edhe sot është në përdorim në disa shtete të caktuara si p.sh. Italia. Përveç përfaqësimit të tërthortë, zbrazëtira e institutit të përfaqësimit në të drejtën romake ka qenë e plotësuar edhe përmes dy instituteve të tjera. Këto dy institute ishin *procuratio* apo ndryshe të ashtuquajturit kujdestar të pasurisë, si dhe *peculium*.

Me përfaqësim të tërthortë, kuptojmë kur i ashtuquajturi përfaqësuesi apo më mirë të themi urdhërmarrësi, përmes një mandati apo urdhri nga i përfaqësuari, ka lidhur një kontratë me personin e tretë. Pas lidhjes së kontratës, përfaqësuesi është detyruar që të bartë të drejtat dhe detyrimet nga emri i tij në emër të urdhërdhënësit. Një mangësi e përfaqësimit të tërthortë është se këtu krijohen dy transaksione ligjore në vend të një transaksioni që ndodh në përfaqësimin e drejtpërdrejtë. Për sa i përket *procuratio*, ky ka qenë një institut që është përdorur nga njerëzit e pasur në të drejtën romake, ku një person i tretë e ka pasur për detyrë të kujdeset dhe të administrojë pasurinë e personit në fjalë. Zoti i shtëpisë, në këtë kohë, emëronte një person të lirë që ka qenë i trajnuar dhe përgatitur për këtë pozitë. Kështu që ky person, përgjatë realizimit të detyrës së tij, ka blerë dhe shitur gjësende në emër të zotit të shtëpisë, më saktësisht për personin për të cilin ka administruar pasurinë. Ky institut e ka shtrirë edhe më tej pushtetin e *pater familiasit* duke e bërë të mundur që veprimet për blerje, shitje si dhe çdo veprim tjetër të ndërmarrë nga kujdestari i pasurisë rreth pasurisë së *pater familiasit*, të quhen si veprime të *pater familiasit* dhe e drejta mbi ato t'i takoj atij.<sup>33</sup>

Së fundmi, një nga institutet tjera ka qenë edhe siç u cek ma herët, instituti *peculium*. *Peculium* ka qenë një fond financiar që i është dhënë skllavit nga *pater familiasi* për të kryer veprimet juridike dhe tregtare, që kanë qenë në interes të tij. Edhe pse *pater familiasi* e kishte alokuar këtë pasuri tek skllavi, kjo pasuri akoma ishte pronë e *pater familiasit*. Në qoftë se diçka do të blehej përmes këtij fondi, edhe nëse *pater familiasi* nuk ka qenë në dijeni apo nuk është informuar, do të llogaritet sikur që *pater familiasi* e ka blerë dhe tash është në pronësi të tij. Skllëvërit në këtë rast kanë qenë sikur agjent të përfaqësimit, të përhershëm apo edhe

---

<sup>32</sup> Van Der Bergh, R. (2015, fq. 361-362). *He's the one who minds the boss's business*. Fundamina. Vëllimi 21, numër 2. Afrika e Jugut.

<sup>33</sup> Zimmerman, R. (1992, fq. 49). *The law of obligations: Roman foundations of the civilian tradition*. Cape Town.

të përkohshëm, përderisa veprimet e tyre juridike apo tregtare janë realizuar me përdorimin e këtij fondi financiar të quajtur *peculium*.<sup>34</sup>

Nga e gjithë kjo arritëm të kuptojmë se si e drejta romake e ka plotësuar zbrazëtirën që ka ekzistuar në atë kohë për shkak mungesës të institutit të përfaqësimit. Fillimisht nga e gjithë kjo rrjedh, dështimi i romakëve të pranojnë institutin e përfaqësimit në të drejtën e tyre edhe përkundrazi faktit që mungesa e këtij instituti është vërejtur. Këtë fenomen *Schulz* e konsideron, si një fenomen që ka rrjedhur nga fakti se Romakët kanë qenë të përqendruar tepër në izolimin e së drejtës së tyre, si dhe respektimit të traditave.<sup>35</sup> Kështu që Romakët përmes instituteve dhe marrëdhënieve të cekura, kanë tentuar që të plotësojnë zbrazëtirën e institutit të përfaqësimit. Ku edhe se pse kjo zbrazëtirë nuk është arritur në masë të madhe të plotësohet, duhet të ceket se Romakët janë për tu çmuar me faktin që kanë arritur të kombinojnë të drejtat dhe veprimet që kanë dalur nga institutet dhe marrëdhëniet ekzistuese të asaj kohe, për të plotësuar këtë zbrazëtirë, me një cilësi dhe organizim kaq të lartë. Nga e gjithë kjo, mund të konkludojmë që e drejta romake nuk ka qenë e hapur për ndryshime dhe ka tentuar që t'i plotësojë zbrazëtirat e ndryshme që janë shfaqur për shkak zhvillimit të shoqërisë, përmes instituteve ekzistuese. Së fundmi, duhet të ceket që edhe përkundrazi faktit, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ky institut nuk ka ekzistuar në atë kohë, mund të themi që disa nga elementet kryesore që e përbëjnë këtë institut në legjislacionin aktual kanë qenë të pranishme edhe në të drejtën romake.

## 2.2. Përfaqësimi dhe kontrata e përfaqësimit në të drejtën mesjetare

E drejta mesjetare arriti të anashkaloj disavantazhet e shkaktuara nga mos pranimi i parimit të përfaqësimit në të drejtën romake. Përderisa e drejta romake në mënyrë strikte e ndalonte përfaqësimin me arsyen që asnjë person nuk mund të ndër marrë detyrime dhe të pranojë të drejta në emër të një personi të tretë, e drejta mesjetare përfaqësimin e trajtoj në një mënyrë tjetër. Pranimi i parimit të përfaqësimit në të drejtën mesjetare lindi nga vështirësitë që u paraqiteshin në përditshmëri, në kryerjen e veprimeve juridike në të drejtën tregtare. Ndryshimet e para për pranimin e parimit të përfaqësimit lindën nga e drejta

---

<sup>34</sup> Van Der Bergh, R. (2015, fq. 368-369). *He's the one who minds the boss's business*. Fundamina. Vëllimi 21, numër 2. Afrika e Jugut.

<sup>35</sup> Po aty, fq. 369.



kanonike, edhe pse avancimi i këtij instituti në të drejtën kanonike ka qenë i ndikuar nga konceptet teologjike hebraike.<sup>36</sup>

Në vitin 1200 përmes të ashtuquajturit *procurator* lindi një lloj i marrëdhënies të përfaqësimit, përmes të cilit është munduar të zgjidhet problemi i përfaqësimit. *Procurator* ka qenë në atë kohë si përfaqësues, i autorizuar nga një person tjetër për të administruar pasurinë e të përfaqësuarit (*procurator omnium bonorum*), për të kryer veprime të ndryshme në emër të përfaqësuarit (*procurator unius rei*), si dhe në disa raste e ka luajtur rolin e përfaqësuesit në çështje gjyqësore (*procurator ad litem*). Kjo marrëdhënie lindi nga parimi *procurator est qui aliena negotia mandatu domini administrat*. Edhe pse *procurator* e luante rolin e një përfaqësuesit, shumë autorë janë të mendimit se kjo marrëdhënie nuk është e përafërt me marrëdhënien e përfaqësimit e cila lind me kontratën e përfaqësimit. Arsyeja për këtë mendim të tillë ka qenë për shkak se në këtë periudhë *procurator* ka qenë vetëm një person i besueshëm i të përfaqësuarit, i cili ka pasur për detyrë vetëm administrimin e të gjitha punëve juridike të përfaqësuarit. Sipas këtij grupi të autorëve, arsyeja pse këto dy institute janë të ndryshme është me atë se marrëdhënia e cila lind nga kontrata e përfaqësimit është marrëdhënie kontraktuale e lidhur me vullnetin e të dy palëve, ndërsa marrëdhënia e lindur në mes *procurator* dhe të përfaqësuarit ka qenë e njëanshme, ku *procurator* ka qenë i autorizuar nga i përfaqësuarit për të administruar punët juridike të tij. Këto dy institute filluan të shfaqin ngjashmëri të shumta në kohën kur roli i *procurator*-it u rrit, duke e përfaqësuar të përfaqësuarin edhe në raste gjyqësore. Pas rritjes së rolit të *procurator* mund të themi që këto dy institute filluan të jenë më të ngjashëm, gjegjësisht me zanafillën e *procurat unius rei* dhe *procurator ad litem*, marrëdhënia e *procurator*-it dhe të përfaqësuarit filloj të konsiderohet si paraardhëse e marrëdhënies të krijuar nga kontrata e përfaqësimit.<sup>37</sup>

Në këtë kohë në sistemin anglosakson, kontrata e përfaqësimit gjegjësisht marrëdhënia në mes të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit u zgjerua duke u bazuar në marrëdhëniet në mes të pronarit dhe skllavit. Veprimtaria e përfaqësimit në të drejtën anglo-normandike u zhvilluar përmes *ballivus* dhe *attornatus*. Pozita e atëhershme e *ballivus*, e lejonte atë që të kryejë veprime tregtare për zotin e tij, marrëdhënie e cila rrjedhte prej marrëdhënies së mëhershme mes pronarit dhe skllavit në të drejtën romake. Më kalimin e

---

<sup>36</sup> Müller-Freienfels, W. (13 prill 2018). *Agency*. Marrur nga: <https://www.britannica.com/topic/agency-law> (qasur më 20 prill 2019)

<sup>37</sup> Provera, G. (1983, fq. 313-314). *Mandato*. Enciclopedia del diritto. Vëllimi XXV. Milano.

kohës, *ballivus* kishte autorizime të tjera duke e shndërruar atë në administrator të punëve të zotit të tij, e cila rrjedhi në dhënien e kompetencës për të vepruar për të zotin e tij në mënyrë të pavarur. Në anën tjetër, përderisa *attornatus* në fillim ishte vetëm përfaqësues i njërës nga palët në çështjet gjyqësore, me kalimin e kohës autorizimet e tij u zgjeruan dhe roli i tij u bë më i rëndësishëm. Ky rol i tij u lind me obligueshmërinë e lidhjes të disa kontratave në mënyrë gjyqësore. Për këtë arsye, lidhja e këtyre kontratave u realizonte në gjykata ku një *attornatus* e përfaqësonte njëren nga palët kontraktuese. Ky ishte fillimi i rolit të *attornatus* si përfaqësues i përgjithshëm.<sup>38</sup>

### 2.3. Përfaqësimi dhe kontrata e përfaqësimit në të drejtën moderne

Përkundrazi konflikteve teorike për ekzistimin e përfaqësimit, përfaqësimi si institut në praktikë gjithmonë ka ekzistuar në forma të ndryshme. Njohja e institutit të përfaqësimit ka ndodh si rrjedhojë e zhvillimit të veprimtarive tregtare, si dhe rrjedhojë e ndryshimeve të strukturave ekonomike, politike dhe shoqërore. Braktisja e parimit *alteri stipulari nemo potest* fillimisht ndodhi në statutet e qyteteve Italiane gjatë zhvillimit të hovshëm të tregtisë në këtë regjion. Një veprim i till i braktisjes të këtij parimi u paraqit edhe në sistemin juridik Holandez. Doktrina juridike Holandeze në këtë periudhë nxjerri disa nga parimet më kryesore që sot e formësojnë institutit e përfaqësimit, si p.sh. veprimet e përfaqësuesit e detyrojnë të përfaqësuarin, përfaqësuesi vepron në emër të përfaqësuarit, si dhe i përfaqësuarit është përgjegjës për veprimet e përfaqësuesit gjatë kryerjes së veprimtarisë së përfaqësimit. Pranimi i parimit të përfaqësimit në të drejtën e shkruar është pranuar në shekullin XVII. Në shkrimin e Hugo Grotius të quajtur *De Jure Belli ac Pacis*, është shpjeguar përfaqësimi, me atë që përmes mandatit përfaqësuesi mundet të ndër marrë veprime juridike në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Hugo Grotius është personi që anashkaloj parimin e së drejtës romake që lejonte përfaqësimin e zotit të shtëpisë vetëm përmes skllavit apo fëmijëve të tij. Në këtë periudhë, Instituti i përfaqësimit filloj të njihej nga kode të ndryshme, si Kodi Civil Prusian (1794), Kodi Civil Francez i Napoleon-it (1804), Kodi Civil Austriak (1811), si dhe nga kode të tjera.<sup>39</sup>

---

<sup>38</sup> Müller-Freienfels, W. (13 prill 2018). *Agency*. Marrur nga: <https://www.britannica.com/topic/agency-law> (qasur më 20 prill 2019)

<sup>39</sup> Po aty.

Poashtu, në po të njëjtën kohë në sistemin anglosakson u zhvillua kontrata e përfaqësimit duke u bazuar mbi marrëdhënien ekzistuese mes pronarit dhe skllavin. Juristët e shekullit XVIII e kanë marrë për bazë parimin *qui facit per alium, est perinde ac si facit per se ipsum* (ai i cili vepron përmes personit të tretë, llogaritet sikur të kishte vepruar vet ai). Parim i cili ndihmoi në masë të madhe krijimin e fiksionit të nevojshëm për zhvillimin e institutit të përfaqësimit. Përderisa teoritë e para praktike mbi përfaqësimin u shfaqën në fillim të shekullit XIX nga William Paley në Angli dhe nga Samuel Livermore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, doktrina juridike në sistemin eurokontinental vazhdoi të luaj rol in e saj tradicional në zhvillimin e institutit të përfaqësimit. Një zhvillim i madh në të drejtën e shkruar u shfaq në gjysën e dytë të shekullit XIX nga juristi Rudolf von Jhering dhe Paul Laband. Më herët përfaqësimi gjegjësisht kontrata e përfaqësimit është vështruar vetëm si marrëdhënie e përfaqësimit e krijuar nga autorizimi i dhënë e cila e detyron të përfaqësuarin, përfaqësuesin edhe personin e tretë. Jhering dhe Laband kanë qenë ndër të parët të bëjnë dallimin në mes të autorizimit të përfaqësuesit për të marrë të drejta dhe për t'i kryer detyrimet në emër dhe llogari të përfaqësuarit, dhe marrëdhënies së brendshme kontraktore mes palëve ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit. Ky dallim paraqet një nga shtyllat kryesore që e ka formësuar kontratën e përfaqësimit gjegjësinë veprimtarinë e përfaqësimit ashtu siç është e rregulluar sot në legjislacionin pozitiv.<sup>40</sup>

Përgjatë shekullit XIX i është dhënë mbështetje poashtu edhe parimit të njohjes të përfaqësuarit. Me atë që përmes këtij parimi, nënkuptohet se i përfaqësuarit është i detyruar nga veprimet e përfaqësuesit vetëm atëherë kur përfaqësuesi e njofton personin e tretë që është duke vepruar në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Përmes këtij parimi është bërë dallimi në mes përfaqësimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Ky parim kishte ndikim më të madh në sistemin eurokontinental, përderisa në sistemin anglosakson akoma kishte rëndësi përfaqësimi i tërthortë ku personi i tretë nuk njoftohej domosdo nga përfaqësuesi se është duke vepruar në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Për të pasqyruar të drejtën civile aktuale, gjegjësisht për tu përshtatur me zhvillimin e hovshëm ekonomik dhe shoqëror, trajtimi i kontratës së përfaqësimit është tërhequr nga konceptualizmi ekzistues artificial në shekullin XIX dhe është ndërlidhur me nevojat ekzistuese që rrjedhin nga rrethanat ekonomike dhe

---

<sup>40</sup> Müller-Freienfels, W. (13 prill 2018). *Agency*. Marrur nga: <https://www.britannica.com/topic/agency-law> (qasur më 20 prill 2019)

shoqërore. Poashtu është shmangur pabarazia e palëve, me atë që jetëgjatësia e kontratës të përfaqësimit nuk varej më vetëm nga vullneti i të përfaqësuarit, por edhe nga vullneti i përfaqësuesit. Gjithashtu, pas shekullit XIX nuk është konsideruar më bartja e të drejtave dhe detyrimeve nga personi i tretë tek i përfaqësuari përmes përfaqësuesit si dy veprime juridike, por vetëm si dy pjesë të një veprimi të vetëm juridik. Kështu që i përfaqësuari përdor ndihmën e përfaqësuesit përmes një veprimi të vetëm juridik i përbërë nga autorizimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit dhe nga veprimi i ndërmarrë nga përfaqësuesi.<sup>41</sup> Në mungesë të gjithë këtyre karakteristikave të lartpërmendura, veprimtaria e përfaqësimit gjegjësisht kontrata e përfaqësimit nuk do ta kishte formën dhe rëndësinë që e ka në sistemet juridike aktuale.

## 2. Kontrata e përfaqësimit

Kontrata e përfaqësimit është një kontratë, që bënë pjesë në grupin e kontratave për shërbim. Kjo kontratë lidhet në mes të përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit ose siç është cekur në literaturë, lidhet në mes autorizuesit dhe të autorizuarit, ku i përfaqësuari e autorizon përfaqësuesin që në emër dhe llogari të tij të kryej punë të caktuar, ose disa punë të caktuara, ose disa punë të llojit të caktuar, kurse nga ana tjetër përfaqësuesi obligohet që ta kryej punën me shpërblim ose pa shpërblim. Marrëdhënia e përfaqësimit e krijuar me kontratën e përfaqësimit dallohet nga përfaqësimi ligjor me vetë arsye që bazohet në përfaqësimin vullnetar dhe lidhet me vetë vullnetin e palëve.<sup>42</sup>

Me rëndësi të ceket në fillim është emërtimi i kësaj kontrate. Arsyeja e parë është me vetë faktin që fjala *përfaqësim* e përshkruan më mirë edhe vetë veprimin juridik që kryhet në emër të kësaj kontrate. Pasi që nga vetë nocioni i kësaj kontrate kuptohet që përfaqësuesi e ka për detyrë të kryejë punë dhe veprime juridike në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Së dyti, kontrata e përfaqësimit është më e gjerë nga vet fakti që në vete e përfshin kontratën e thjeshtë të përfaqësimit gjegjësisht kontratën mbi autorizimin, por edhe nuk e anashkalon kontratën e përfaqësimit tregtar, si dhe kontratën e përfaqësimit përmes avokatit.

Emërtimet e ndryshme të shfaqura në literaturën juridike janë bazuar varësisht se cilin kriter autorët e marrin për emërim. Në kontratën e përfaqësimit ekzistojnë tri marrëdhënie

---

<sup>41</sup> Müller-Freienfels, W. (13 prill 2018). *Agency*. Marrur nga: <https://www.britannica.com/topic/agency-law> (qasur më 20 prill 2019)

<sup>42</sup> Alishani, A. (1990, fq. 299). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

paralele dhe në bazë të këtyre marrëdhënieve edhe autorë të ndryshëm e emërojnë këtë kontratë. Këto tri marrëdhënie paralele janë urdhri (mandati), autorizimi dhe përfaqësimi. Me urdhër rregullohet marrëdhënia e brendshme ndërmjet urdhërdhënësit dhe urdhërmarrësit. Me autorizim kuptohet dokumenti me shkrim ku pushtetdhënësi e autorizon të autorizuarin apo përfaqësuesin, ku ju bëhet me dije subjekteve për ekzistimin e autorizimit. Ndërsa ky lloj i marrëdhënieve të jashtme që krijohet me autorizimin paraqitet një lloj i përfaqësimit të drejtpërdrejtë.<sup>43</sup> Përmes kësaj dua të theksoj që përzgjedhja për përdorim të emrit kontratë të përfaqësimit është marrë duke pasur parasysh marrëdhënien e jashtme që krijohet. Nga këndvështrimi i jashtëm, shihet qartë që kjo kontratë mundëson apo e bën të mundur përfaqësimin e një personi dhe veprimet e ndërmarra në bazë të kësaj kontrate llogariten sikur t'i kishte marrë vetë personi që e ka dhënë autorizimin për përfaqësim. Në vijim të kësaj teze të magistraturës, do të përdoret termi kontratë e përfaqësimit, por në raste të caktuara edhe si kontratë e autorizimit me vetë faktin që burimet të cilët janë përdorur në këtë kapitull e kanë emëruar këtë kontratë në atë mënyrë.

### 2.1. Karakteristikat e kontratës së përfaqësimit

Kjo kontratë dallohet nga kontratat tjera në sfera juridike për një mori arsyesh dhe dallohet përmes karakteristikave në vijim:

- Është kontratë e shërbimit, përmes së cilës palët merren vesh për kryerjen e një shërbimi të caktuar;
- Është kontratë e thjeshtë, me vetë faktin që elementet përbërëse janë të vetëm një kontrate, dhe nuk ekziston përzierje e më shumë elementeve për krijimin e një kontrate të përbërë;
- Forma e kontratës së përfaqësimit mund të jetë formale ose joformale, varësisht se çfarë kontrate lidhet si dhe varësisht nëse ligji kërkon një formë të caktuar të lidhjes të kësaj kontrate;
- Është edhe kontratë e njëanshme detyruese, në qoftë se është pa shpërblim, për arsye se i autorizuari ndërmerr veprime në emër dhe llogari të pushtetdhënësit. Ndërsa nëse kontrata e përfaqësimit lidhet me shpërblim, atëherë shndërrohet në kontratë të dyanshme detyruese;

---

<sup>43</sup> Dauti, N. (2001, fq. 349). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

- Është kontratë komutatitive, për arsye se palët e kësaj kontrate i dinë të drejtat dhe detyrimet e tyre në momentin e lidhjes të kësaj kontrate;
- Është kontratë kauzale, me vetë faktin që qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate është i ditur edhe për personat tjerë e jo vetëm për palët nënshkruese;
- Është kontratë konsensuale, për shkak se lidhet me vetë vullnetin e palëve.<sup>44</sup>

### 2.3. Palët e kontratës së përfaqësimit

Nga vetë nocioni përmes të cilit shpjegohet kuptimi i kontratës së përfaqësimit, arrijmë të kuptojmë se palë kontraktuese janë i përfaqësuarit dhe përfaqësuesi. I përfaqësuarit është personi i cili jep autorizime që puna juridike të lidhet në emër dhe llogari të tij.<sup>45</sup> I përfaqësuarit dëshiron të ndërmerr një veprim të caktuar apo të kryejë një punë juridike dhe vendos të autorizojë një person të tretë që në këtë rast është përfaqësuesi, për t'i ndërmarr ato veprime dhe t'i kryejë punët juridike që ai ka dashur t'i kryejë. I përfaqësuarit nuk i kryen këto punë juridike vet për arsye faktike, për shkak të pamundësisë t'i ndërmerr këto veprime vet apo ka dëshirë që këto punë t'i kryejë një person kompetent. Palë tjetër kontraktuese në këtë kontratë është përfaqësuesi. Përfaqësuesi është personi i cili deklaron vullnetin e të përfaqësuarit për lidhjen e punës juridike në emër dhe llogari të përfaqësuarit.<sup>46</sup> Përfaqësuesi paraqitet personi që i përfaqësuarit e ka autorizuar t'i ndërmarrë veprimet e caktuara juridike dhe t'i kryejë punët e besuara. Përfaqësuesi me lidhjen e kontratës e ka për obligim t'i kryejë punët juridike dhe të sjell rezultat në kryerjen e punëve për të përfaqësuarin.

Përmes kësaj kontrate, krijohen tri marrëdhënie juridike:

- Marrëdhënia juridike në mes të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit. Kjo marrëdhënie juridike krijohet në momentin e lidhjes së kontratës së përfaqësimit nga palët kontraktuese. Me lidhjen e kontratës, i përfaqësuarit dhe përfaqësuesi kanë të drejta dhe detyrime të caktuara ndaj njëri tjetrit.
- Marrëdhënia juridike në mes përfaqësuesit dhe personit të tretë. Kjo marrëdhënie juridike krijohet në momentin kur përfaqësuesi me ndërmarrjen e veprimeve juridike dhe kryerjen e punëve juridike bashkëvepron me personin e tretë si p.sh. me lidhjen

<sup>44</sup> Alishani, A. (1990, fq. 300-301). E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>45</sup> Aliu, A. (2013, fq. 341). E drejta civile, pjesa e përgjithshme. Prishtinë.

<sup>46</sup> Po aty.

e kontratës me personin e tretë. Në këtë rast përfaqësuesi është palë e marrëdhënies juridike, por nuk është palë e kontratës së lidhur me personin e tretë.

- Marrëdhënia juridike në mes të përfaqësuarit dhe personit të tretë. Personi i tretë është personi me të cilin përfaqësuesi lidhë punë juridike në emër dhe llogari të përfaqësuarit.<sup>47</sup> Kjo marrëdhënie juridike po ashtu krijohet në momentin e njëjtë që krijohet marrëdhënia mes përfaqësuesit dhe personit të tretë. Për dallim nga përfaqësuesi që në qarkullim juridik nuk paraqitet si palë e pavarur, ku të gjitha veprimet e ndërmarra dhe punët e kryera juridike konsiderohen veprime dhe punë të ndërmarra në emër dhe llogari të përfaqësuarit, i përfaqësuari paraqitet si palë e kontratës së lidhur mes përfaqësuesit dhe personit të tretë. Nga kjo kuptojmë, që me krijimin e kësaj marrëdhënie, i përfaqësuari dhe personi i tretë pajisen me të drejta dhe detyrime të caktuara ndaj tyre, varësisht prej kontratës që lidhin.

### 3. Kushtet për lidhjen e kontratës së përfaqësimit

Çdo kontratë për të qenë e plotfuqishme dhe të ketë efekt juridik është e nevojshme t'i plotësojë kushtet thelbësore. Kushtet për lidhjen e kontratës së përfaqësimit ndahen në dy kategori:

- Kushtet e përgjithshme, këto kushte janë kushtet që çdo kontratë duhet t'i përmbush për të qenë e plotfuqishme si dhe të njëjtat duhet të ekzistojnë edhe në kontratën e përfaqësimit. Këto kushte janë: aftësia e palëve kontraktuese, pëlqimi i vullnetit, lënda dhe baza e kontratës.
- Kushtet thelbësore, këto kushte apo elemente, i dedikohen vetëm kësaj kontrate dhe duhet të jenë të pranishme në këtë kontratë për të qenë e plotfuqishme. Këto kushte janë: puna e përfaqësuesit, shpërblimi i përfaqësuesit, dhe zgjatja e kontratës.<sup>48</sup>

Për sa i përket kushteve të përgjithshme siç edhe e cekëm më sipër, këto kushte janë të rëndësishme në plotfuqishmërinë e çdo kontrate si dhe të kontratës së përfaqësimit.

Aftësia e palëve kontraktuese ndërlidhet me vetë palët kontraktuese dhe zotësitë e tyre. I përfaqësuari (pushtetdhënësi) për të qenë pjesë e kontratës së përfaqësimit duhet të ketë zotësinë e veprimit. Arsyeja për këtë është se një person mund t'i bart vetëm të drejtat që ai

---

<sup>47</sup> Aliu, A. (2013, fq. 341). *E drejta civile, pjesa e përgjithshme*. Prishtinë.

<sup>48</sup> Alishani, A. (1990, fq. 301). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

i posedon dhe jo më tepër. Palë kontraktuese mund të jenë si personat fizik ashtu edhe personat juridik. Në këtë rast nëse i përfaqësuari ka zotësi të pjesshme, ai atëherë mund t'i bart te përfaqësuesi vetëm ato veprime për të cilat ai ka pasur mundësi t'i kryej edhe vetë. Përfaqësuesi gjithashtu duhet të posedojë zotësinë e plotë të veprimit dhe profesionale për të kryer punë të caktuara juridike. Në këtë rast nuk mundet që të kontraktohet një person pa zotësi të plotë të veprimit të kryej veprime juridike në emër të përfaqësuarit.<sup>49</sup>

Kushti i dytë i përgjithshëm është pëlqimi i vullnetit të palëve për lidhjen e kontratës. Personat kanë të drejtë që të zgjedhin, se cili person do t'i përfaqësojë dhe për kryerjen e cilave veprime juridike do të lidhet kontrata. Pëlqimi i vullnetit duhet të jetë i dyanshëm, sepse që të lidhet kontrata, vullneti i të dy palëve kontraktuese duhet të jetë i përputhur. Pëlqimi i vullnetit për të qenë i vlefshëm në plotfuqishmërinë e kontratës duhet të jetë i lirë, serioz, i vërtetë dhe i mundshëm.<sup>50</sup>

Lënda e kontratës është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Lënda është ajo për të cilën palët janë marrë vesh për të lidhur kontratën. Si lëndë e kontratës mund të jetë ndonjë send, veprim ose mosveprim.<sup>51</sup> Në këtë rast e kemi si lëndë të kontratës veprimin që përfaqësuesi duhet ta kryejë me udhëzimet e marra nga i përfaqësuari ose pushtetdhënësi në emër dhe llogari të tij. Lëndë e kontratës mund të jetë çdo punë juridike, qoftë edhe veprim që është i lejueshëm dhe i mundshëm.

Baza e kontratës është qëllimi juridik që e ka shtyrë ndonjë subjekt të marrë detyrime dhe që e ka caktuar karakterin juridik të punës juridik. Baza e kontratës është arsyeja për të cilën debitori merr detyrimin dhe duhet të ekzistojë në çdo kontratë që nga momenti i lidhjes së kontratës dhe është ditur për të gjithë që nga ai moment.<sup>52</sup>

### 3.1. Puna e përfaqësuesit

Puna e përfaqësuesit gjegjësisht të autorizuarit, paraqitet kusht thelbësor për plotfuqishmërinë e kontratës së përfaqësimit. Puna që e ndërmerr përfaqësuesi duhet të jetë

---

<sup>49</sup> Dauti, N. (2001, fq. 351). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>50</sup> Dauti, N. (2003, fq. 37). *E drejta kontraktuese, praktikum*. Prishtinë

<sup>51</sup> Dauti, N. (2001, fq. 65-66). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>52</sup> Dauti, N. (2003, fq. 42). *E drejta kontraktuese, praktikum*. Prishtinë fq. 42



ekskluzivisht juridike dhe jo faktike.<sup>53</sup> Përfaqësuesi e ka të drejtën të lidh kontratë, të ndryshojë kontratën apo edhe të kryej një veprim juridik apo detyrim që del nga lidhja e kontratës. Përfaqësuesi mund të blej, të shes apo edhe të ndërroj ndonjë send në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Në rastet kur kemi të bëjmë me përfaqësimin përmes avokatit, në këtë rast përfaqësuesi mund të parashtrijë akte juridike si padi, kërkesë në gjykatë, si dhe mund të iniciojë procedurën gjyqësore dhe të ndërmerr veprime juridike në gjykatë në emër dhe llogari të përfaqësuarit sikur edhe ai vet të kishte ndërmarr.<sup>54</sup>

### 3.2. Shpërblimi i përfaqësuesit

Shpërblimi i përfaqësuesit paraqitet si kusht thelbësor në rastet kur kjo kontratë lidhet me shpërblim. Shpërblimi i përfaqësuesit paraqet shpërblimin që i përfaqësuari duhet t'i paguaj përfaqësuesit për punën e kryer. Shpërblimi jepet në të holla, por edhe mund të jepet edhe në vlerë tjetër pasurore. Shpërblimi duhet të jetë i barabartë me vlerën e punës së kryer ose që duhet të kryhet nga përfaqësuesi. Shpërblimi duhet të jetë i drejtë, i caktuar ose i caktueshëm, i mundshëm dhe i lejuar. Lartësia e shpërblimit për punën e kryer ose që do të kryhet caktohet nëpërmjet kontratës së përfaqësimit, ose në rast që përfaqësimi ndodh përmes avokatit atëherë lartësia e shpërblimit caktohet përmes tarifës së avokatëve. Në rastet kur shpërblimi është tepër i lartë, pala kontraktuese e interesuar ka të drejtë që të kërkojë nga gjykata uljen e shpërblimit deri në vlerën e punës së kryer. Në këtë rast kur shpërblimi është tejet i lartë se sa vlera e përcaktuar nga dispozitat imperative, atëherë shpërblimi jepet në bazë të dispozitave imperative.<sup>55</sup> Qëllimi përse shpërblimi është element esencial është me vetë faktin e zhvillimit të tregtisë dhe profesionalizimit të personave të caktuar për kryerjen e punëve të tilla për një kompensim të caktuar. Për sa i përket dispozitave që e mbrojnë lartësinë e shpërblimit, këto ekzistojnë me qëllim që të mbrojnë palët kontraktuese përmes përcaktimit të lartësisë së shpërblimit në bazë të vetë vlerës së punës së kryer ose punës që do të kryhet.

---

<sup>53</sup> Dauti, N. (2001, fq. 352). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>54</sup> Alishani, A. (1990, fq. 303). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>55</sup> Po aty.

### 3.3. Zgjatja kohore e kontratës së përfaqësimit

Kontrata e përfaqësimit është kontratë me prestime të përhershme. Zgjatja kohore e kontratës së përfaqësimit varet nga vullneti i palëve kontraktuese që në këtë rast si palë kontraktuese është përfaqësuesi dhe i përfaqësuarit. Sipas vullnetit të tyre ata e përcaktojnë kohëzgjatjen gjatë lidhjes së kontratës. Kohëzgjatja e kontratës mund të jetë me kohë të caktuar dhe me kohë të pacaktuar. Zgjatja e kontratës me kohë të caktuar mund të jetë me afat mujor, vjetor ose me përfundim të punës që duhet të kryhet me lidhjen e kontratës.<sup>56</sup>

## 4. Shuarja e kontratës së përfaqësimit

Kontrata e përfaqësimit si çdo kontratë tjetër shuhet në mënyra të ndryshme, si në vijim:

- Me marrëveshjen e palëve;
- Me kryerjen e punës;
- Me humbjen e aftësisë punuese të përfaqësuesit apo të përfaqësuarit;
- Me vdekjen e përfaqësuesit apo të përfaqësuarit;
- Për shkak të pamundësisë së kryerjes së punës;
- Me revokim; dhe
- Me denoncim

Këto janë mënyrat përmes së cilave kontrata e përfaqësimit pushon të vlejë dhe shuhet. Në vijim do të shtjellohet thellësisht çdonjëra nga mënyrat e shuarjes të përmendura më sipër.

### 4.1. Shuarja e kontratës me marrëveshjen e palëve

Kontrata e përfaqësimit si çdo kontratë tjetër është e mundur që të shuhet me marrëveshjen e palëve kontraktuese. Në qoftë se palët pajtohen që kontrata të shuhet, kontrata e përfaqësimit pushon të vlejë. Ideja e kësaj rrjedh me vetë faktin që palët janë ata që e kanë lidhur kontratën, dhe ata kanë gjithashtu të drejtën që të shuajnë kontratën në qoftë se merren vesh. Kjo kontratë shuhet në shumicën e rasteve përmes një kontrate joformale, apo përmes klauzolës gojore. Në qoftë se kemi të bëjmë me një rast formal të kësaj kontrate, atëherë shuhet përmes një marrëveshje formale duke e marrë parasysh formën e kontratës, interesin e palëve si dhe interesin shoqëror.<sup>57</sup>

---

<sup>56</sup> Alishani, A. (1990, fq. 304). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>57</sup> Po aty, fq. 313.

#### 4.2. Shuarja e kontratës me kryerjen e punës

Kjo mënyrë e shuarjes të kontratës është mënyra natyrore e shuarjes, për arsye se realizohet qëllimi i kontratës dhe kontrata përfundon të vlejë me vetë faktin që qëllimi për të cilën është lidhur kjo kontratë është kryer me sukses. Me anë të kryerjes së punës për të cilën palët janë marrë vesh, kontrata shuhet në rastet kur kemi të bëjmë me autorizimin special gjegjësisht të posaçëm. Për sa i përket autorizimit të përgjithshëm, kjo mënyrë e shuarjes nuk vlen.<sup>58</sup>

#### 4.3. Shuarja e kontratës me skadimin e kohës

Kontrata e përfaqësimit mund të shuhet me skadimin e kohës, nëse palët janë marrë vesh. Në këtë rast palët pajtohen që pas kalimit të një afati të caktuar, kontrata të shuhet me arritjen e atij afati të caktuar. Ky afat i caktuar mund të jetë një datë e caktuar në rastet kur përfaqësuesi dhe i përfaqësuari pajtohen që kontrata e përfaqësimit të vlejë deri më datën 15.06.2019, një periudhë e caktuar kohore kur palët kontraktuese dakordohen që kontrata të shuhet pas një viti të lidhjes, si dhe me paraqitjen e një rrethane apo ngjarje të caktuar si p.sh. derisa i përfaqësuari të kthehet nga pushimet. Me këtë rast të shuarjes së kontratës, kemi të bëjmë me autorizim të kufizuar por është e mundur që përfaqësuesi dhe i përfaqësuari të dakordohen që të shtyhet afati kohor dhe këtë veprim duhet ta ndërmarrin para se të skadojë afati kohor i paraparë në kontratën e përfaqësimit, me ç'rast kemi të bëjmë me ndryshimin e përmbajtjes së kontratës ekzistuese. Në rast se palët kontraktuese vendosin që të zgjatin afatin kohor menjëherë pas skadimit të kohës, atëherë kemi lidhjen e kontratës së re duke mos e ndryshuar përmbajtjen e saj.<sup>59</sup>

#### 4.4. Shuarja e kontratës me humbjen e aftësisë së veprimit të përfaqësuesit ose të përfaqësuarit

Humbja e aftësisë së veprimit të përfaqësuesit apo të përfaqësuarit ndikon në vlefshmërinë e kontratës dhe është shkak për shuarjen e kontratës së përfaqësimit. Është me rëndësi të ceket se humbja e aftësisë së veprimit ndikon në mënyra të ndryshme në bazë të asaj nëse palët e kanë humbur, në mënyrë të plotë apo të pjesshme aftësinë e tyre punuese.

---

<sup>58</sup> Dauti, N. (2001, fq. 358). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>59</sup> Alishani, A. (1990, fq. 313-314). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

Për sa i përket pushtetdhënësit gjegjësisht të përfaqësuarit, disa autorë mendojnë se deri te shuarja e kontratës së përfaqësimit vjen vetëm me humbjen e plotë të zotësisë së veprimit. Ndërsa kur i përfaqësuari pjesërisht e humb zotësinë e veprimit, kontrata e përfaqësimit do të shuhet nëse është kufizuar zotësia e veprimit për punët për të cilat është dhënë autorizimi. Disa autorë të tjerë mendojnë se kontrata e përfaqësimit, gjegjësisht autorizimi i dhënë shuhet në çdo rast të humbjes së zotësisë së veprimit, qoftë ajo e plotë apo e pjesërishtme, ngaqë autorizim mund të japin vetëm personat me zotësi të plotë veprimit. Por megjithatë, në doktrinë vlen dhe përkrahet mendimi i autorëve të parë.<sup>60</sup>

Për sa i përket personave juridik, nëse personi i caktuar juridik i kufizohet veprimtaria e tij, si dhe përfaqësimi i dhënë ka të bëjë me ato punë që janë kufizuar, atëherë kontrata do të shuhet. Mirëpo nëse kontrata e përfaqësimit është lidhur për kryerjen e disa veprimeve të cilat nuk përfshihen në kufizimin e punëve të personit juridik, atëherë kontrata do të vazhdojë të vlejë përderisa ato punë nuk do të kufizohen që të kryhen nga personi juridik.<sup>61</sup>

#### 4.5. Shuarja e kontratës me vdekjen e përfaqësuesit ose të përfaqësuarit

Kontrata e përfaqësimit është kontratë *intuitu personae*, që nënkupton se kjo kontratë është e lidhur për cilësitë e veçanta të palëve. Duke e marrë parasysh këtë fakt, në qoftë se përfaqësuesi apo i përfaqësuari vdes nëse është person fizik apo shuan të ekzistoj nëse është person juridik, parimisht kontrata e përfaqësimit shuhet. Në rast se vdes përfaqësuesi, atëherë trashëgimtarit e tij e kanë për obligim që menjëherë ta informojnë të përfaqësuarin për vdekjen e përfaqësuesit si dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij. Në rast se palët janë marrë vesh se me vdekjen e përfaqësuesit kontrata nuk do të shuhet, atëherë trashëgimtarët e tij apo personi i përcaktuar në kontratë si trashëgimtar është i detyruar që të vazhdojë përfaqësimin e të përfaqësuarit dhe të marrë të gjitha veprimet e përcaktuara me kontratë.<sup>62</sup>

#### 4.6. Shuarja e kontratës për shkak të pamundësisë së kryerjes së punës

Një nga mënyrat e shuarjes së kësaj kontrate është në rastet kur është e pamundur të kryhet puna për të cilën është lidhur kontrata. Pamundësia e kryerjes së punës nuk duhet të

<sup>60</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 228). Општ дел на граѓанското право. Shkup.

<sup>61</sup> Alishani, A. (1990, fq. 314-315). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>62</sup> Dauti, N. (2001, fq. 359). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

ketë ekzistuar para lidhjes së kontratës por duhet të paraqitet pas lidhjes së kontratës. Kjo nënkupton se pamundësia e kryerjes së punës është e mëvonshme, dhe nuk ka ekzistuar para lidhjes së kontratës.<sup>63</sup> Ky rast i shuarjes ndodh nëse përfaqësuari ka autorizuar përfaqësuesin të lidh kontratën e shitjes së një automjeti, por pas lidhjes së kontratës së përfaqësimit deri në kryerjen veprimit të përcaktuar në kontratë që në këtë rast është lidhja e kontratës së shitjes së një automjeti nga përfaqësuesi, automjeti zhduket apo dëmtohet. Me ndodhjen e kësaj ngjarje, është e pamundur të realizohet veprimi i përcaktuar me këtë kontratë dhe nuk ka zgjidhje tjetër veç se të shuhet kontrata.

Mund të ndodh që pamundësia e mëvonshme të shkaktohet pas kryerjes së një pjese të punës, dhe punët tjera të përcaktuara në kontratë nuk mund të kryhen për shkak se është paraqitur pamundësia e mëvonshme. Gjithashtu mund të ndodhë që puna e përcaktuar për tu kryer të bëhet pjesërisht e pamundshme, atëherë parimisht kontrata ngel në fuqi por ndryshohet përmbajtja e saj.<sup>64</sup> Kjo rregull që kontrata të ngel në fuqi nëse paraqitet pamundësia e pjesërishtme vlen përderisa palët nuk janë marrë vesh ndryshe.

#### 4.7. Shuarja e kontratës me revokim

Kontrata e përfaqësimit mund të shuhet edhe përmes revokimit. Revokimi është shprehje e njëanshme e vullnetit të përfaqësuarit drejtuar përfaqësuesit, me të cilin e paralajmëron se nuk dëshiron që përfaqësuesi ta përfaqësojë më në punët juridike të besuara. Deklarata mbi revokimin mund të jepet në çdo mënyrë (gojarisht, me shkrim, përmes gjykatës ose në mënyrë jashtë gjyqësore, drejtpërdrejtë, tërthorazi, shprehimisht ose në bazë të veprimeve konkludente).<sup>65</sup> I përfaqësuari mund të bëjë revokimin e autorizimit në çdo kohë, pavarësisht nga ajo se me kontratë ka hequr dorë. Revokimi i shërben të përfaqësuarit për tu mbrojtur në rastet të keqpërdorimit të autorizimit nga përfaqësuesi. Revokimi i autorizimit vepron prej momentit kur i përfaqësuarit e njofton përfaqësuesin. Në qoftë se përfaqësuesi ndërmerr çfarëdo lloj veprimi pas revokimit të autorizimit, ai do të jetë i detyruar që të përfaqësuarit t'ia shpërblejë dëmin e pësuar nga veprimet e tij. Në raport me personat e tretë, revokimi i autorizimit ka efekt juridik ndaj personave të tretë prej momentit kur këto persona janë në dijeni për revokimin e autorizimit nga ana e të përfaqësuarit. Punët

---

<sup>63</sup> Alishani, A. (1990, fq. 316). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>64</sup> Po aty.

<sup>65</sup> Dauti, N. (2001, fq. 360). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

juridike të cilët personat e tretë i kanë lidhur me përfaqësuesin duke mos qenë në dijeni për revokimin e autorizimin, kanë efekt juridik dhe e detyrojnë të përfaqësuarin. Por në raste kur personat e tretë janë në dijeni për revokimin e autorizimin, atëherë puna juridike e obligon përfaqësuesin.<sup>66</sup>

#### 4.8. Shuarja e kontratës me denoncim

Me denoncim si mënyrë e shuarjes të kontratës së përfaqësimit nënkuptojmë shprehjen e njëanshme të vullnetit të përfaqësuesit drejtuar të përfaqësuarit me të cilin e paralajmëron për zgjidhjen e kontratës. Denoncimi mund të bëhet në mënyra të ndryshme (me gojë, me shkrim, në mënyrë gjyqësore, jashtë gjyqësore). Mirëpo, përfaqësuesi nuk mund të shuaj kontratën përmes denoncimit në kohën kur mund t'i shkaktojë ndonjë dëm të përfaqësuarit me rastin e zgjidhjes së kontratës së përfaqësimit.<sup>67</sup> Nga vetë ekzistimi i denoncimit si mënyrë për shuarjen e kontratës së përfaqësimit, e tregon që edhe përfaqësuesi ka të drejtë të zgjidh kontratën ashtu siç ka i përfaqësuarit të drejtë të zgjidh kontratën përmes revokimit.

### 5. Pasojat e shuarjes të kontratës së përfaqësimit

Shuarja e kontratës së përfaqësimit shkakton apo sjell disa pasoja juridike, që ndikojnë palët kontraktuese, por mund të ketë pasoja edhe për personat e tretë, në qoftë se kanë qenë të pandërgjegjshëm. Në rastet kur kontrata ka qenë me shpërblim dhe shuhet, atëherë bëhet kthimi në gjendjen e mëparshme dhe palët kontraktuese detyrohen të kthejnë atë që kanë marrë me kontratë. Efekti i shuarjes të kësaj kontrate mund të ketë efekt në të ardhmen apo të ketë efekt retroaktiv. Shuarja e kontratës ka efekt vetëm në të ardhmen në rastet kur punët që janë kryer deri në momentin e shuarjes llogariten si të plotëfuqishme. Në këtë rast, të gjitha punët e kryera dhe veprimet e ndërmarra nga përfaqësuesi deri në momentin e shuarjes janë të vlefshme, ndërsa prej momentit të shuarjes, kontrata nuk krijon më efekte. Ndërsa, shuarja e kontratës ka efekt retroaktiv në rastet kur kontrata që është lidhur ka qenë e ndaluar dhe në ndërkohë anulohet, atëherë merret se kontrata nuk ka krijuar efekte prej fillimit gjegjësisht kontrata llogaritet sikur mos të kishte qenë e lidhur fare.<sup>68</sup>

---

<sup>66</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 227). *Опыт дел на гражданското право*. Shkup.

<sup>67</sup> Dauti, N. (2001, fq. 360). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>68</sup> Alishani, A. (1990, fq. 318-319). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

# KAPITULLI II

---

## *Efektet, llojet dhe krahasimi i kontratës së përfaqësimit*

---

### 1. Efektet e kontratës të përfaqësimit

Kontrata e përfaqësimit krijon efekte të caktuara mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit si palë kontraktuese të kësaj kontrate. Efektet e kontratës së përfaqësimit shprehen në të drejtat dhe detyrimet e të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit.

#### 1.1. Të drejtat dhe detyrimet e të përfaqësuarit

Në bazë të kontratës së përfaqësimit, i përfaqësuari ka disa të drejta dhe detyrime të caktuara që lindin nga lidhja e kontratës. Me vetë lidhjen e kontratës i përfaqësuari fiton disa të drejta të caktuara ndaj përfaqësuesit si dhe ngarkohen me disa detyrime të caktuara.

I përfaqësuari i ka të drejtat në vijim:

- Ka të drejtë të kërkojë që kontrata të ekzekutohet. Kjo nënkupton që përfaqësuesi duhet të kryej veprimin e caktuar juridik të paraparë në kontratë në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Veprimi juridik i caktuar duhet të kryhet në mënyrën siç janë marrë vesh palët dhe brenda kohës së përcaktuar me kontratë;
- Ka të drejtë të shuajë kontratën përmes revokimit të autorizimit. Në qoftë se veprimet e ndërmarra nga përfaqësuesi e çenojnë përfaqësuesin apo janë në kundërshtim me kontratën, atëherë i përfaqësuari e ka të drejtën të kërkojë revokimin dhe të shuaj kontratën;
- Ka të drejtë t'i ratifikojë ose t'i mos ratifikojë tejkalimet e bëra nga përfaqësuesi. Në rastet kur përfaqësuesi e ka tejkaluar autorizimin e përcaktuar me kontratë, atëherë i përfaqësuari mund të ratifikojë tejkalimin dhe veprimi i ndërmarrë apo kontrata e lidhur nga përfaqësuesi do të aprovet, ose mundet që i përfaqësuari mos e ratifikojë tejkalimin dhe në këtë rast veprimi i ndërmarrë apo kontrata e lidhur nuk e detyron të përfaqësuarin. Në disa raste të caktuara i përfaqësuari po ashtu ka të drejtë të intervenojë gjatë kryerjes së veprimit nga përfaqësuesi;
- I përfaqësuari gjithashtu ka të drejtë të kërkojë llogari nga përfaqësuesi për veprimet e ndërmarra apo për punën e kryer. I përfaqësuari ka të drejtë që përgjatë kryerjes së

veprimeve dhe punëve të përcaktuara në kontratë, të kërkojë nga përfaqësuesi llogari mbi gjendjen e punëve të kryera dhe suksesin e realizimit të tyre.<sup>69</sup>

Përveç të drejtave të cekura më lartë, i përfaqësuari është i ngarkuar me një numër të caktuar detyrimeve ndaj përfaqësuesit. Këto detyrime janë si në vijim:

- Ka për detyrë t'ia paguajë përfaqësuesit shpërblimin për punën juridike të kryer, nëse kontrata ka qenë me shpërblim. Në kontratë përcaktohet shuma e shpërblimit, vendi dhe koha kur duhet të kryhet pagesa. Në qoftë se në kontratë nuk është përcaktuar vendi saktësisht, atëherë nëse shpërblimi është në të holla paguhet në vendbanimin e përfaqësuesit, ndërsa nëse shpërblimi nuk është në të holla paguhet në vendbanimit e të përfaqësuarit. Në qoftë se edhe koha e pagesës nuk është kontraktuar me kontratë, atëherë paguhet kur të kryhet puna juridike për të cilën është lidhur kontrata;<sup>70</sup>
- Ka për detyrë t'ia paguaj përfaqësuesit të gjitha shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme. Nga kjo nënkuptojmë që i përfaqësuari duhet t'ia paguajë këto lloje të shpenzimeve të cilat përfaqësuesi i ka bërë me rastin e ndërmarrjes së veprimeve apo përgjatë kryerjes së punëve juridike të përcaktuara. I përfaqësuari është i detyruar t'ia paguajë këto shpenzime edhe nëse me punën e përfaqësuesit nuk janë realizuar me sukses veprimet e përcaktuara me kontratë;
- Ka për detyrë shpërblimin e dëmit të përfaqësuesit nëse gjatë kryerjes së punëve juridike të përcaktuara me kontratë, përfaqësuesi ka pësuar dëm. Për të qenë i detyruar, i përfaqësuari për shpërblimin e dëmit, duhet që dëmi të ekzistojë, si dhe të ketë ndodhur gjatë kryerjes së punëve juridike në emër dhe llogari të përfaqësuarit, dhe dëmi mos të ketë ndodhur për shkak të fajit të përfaqësuesit. Në rast se përfaqësuesi ka pësuar dëm për shkak të fajit të tij, atëherë i përfaqësuari nuk është i detyruar të shpërblejë dëmin e pësuar.<sup>71</sup>

---

<sup>69</sup> Alishani, A. (1990, fq. 305). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>70</sup> Po aty.

<sup>71</sup> Dauti, N. (2001, fq. 356). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.



## 1.2. Të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit

Përfaqësuesi ashtu si i përfaqësuari ka disa drejta të caktuara që i takojnë me lidhjen e kësaj kontrate si dhe ngarkohet me disa detyrime që e ka për obligim t'i kryejë ndaj të përfaqësuarit. Të drejtat e përfaqësuesit janë:

- Ka të drejtë në shpërblimin e caktuar, nëse kontrata është lidhur me shpërblim. Nëse koha e shpërblimit nuk është përcaktuar me kontratë, atëherë shpërblimi bëhet në momentin e kryerjes së punës apo punëve juridike. Në qoftë se pa fajin e tij, përfaqësuesi ka kryer pjesërisht punën juridike, atëherë atij i takon një shumë e shpërblimit që është proporcionale me punën e kryer;
- Ka të drejtë t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e dobishme dhe të domosdoshme për t'i kryer punët e caktuara juridike për të cilën palët janë marrë vesh përmes kontratës;
- Ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve të bëra lidhur me kryerjen e punëve juridike;
- Ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar rreth kryerjes së punëve të caktuara juridike që kanë dalur nga lidhja e kontratës, nëse dëmi i është shkaktuar me ndërmarrjen e veprimeve të përcaktuara me kontratë dhe përfaqësuesi nuk është fajtor për dëmin e pësuar.<sup>72</sup>

Përveç të drejtave të cekura më lartë, përfaqësuesi është i ngarkuar me një numër të caktuar detyrimeve ndaj të përfaqësuarit. Këto detyrime janë si në vijim:

- Ka për detyrë të kryejë punën e besuar me kontratë. Ky është detyrimi kryesor dhe më i rëndësishëm që përfaqësuesi duhet ta realizojë në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Përfaqësuesi punën e besuar, duhet ta kryej ashtu siç janë marrë vesh palët me kontratë, ose ta kryej punën sipas standardit të caktuar. Përfaqësuesi gjatë kryerjes së punës së besuar, duhet të veprojë si ekspertë i mirë, dhe në mënyrë profesionale dhe etike. Ai duhet të veproj sipas udhëzimeve që i pranon nga i përfaqësuari. Në rast se përfaqësuesi dëshiron që të ndryshoj mënyrën e punës apo diçka që ndërlidhet me kryerjen e punës së besuar, ai e ka për detyrë që të merr pëlqimin nga i përfaqësuari;
- Ka për detyrë të kryejë personalisht punën e besuar nga i përfaqësuari. Mund që dikush tjetër ta kryej punën e njëjtë të besuar nëse përfaqësuesi ka marrë pëlqim nga

---

<sup>72</sup> Dauti, N. (2001, fq. 357). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

i përfaqësuarit, nëse kryerja e punës nga dikush tjetër ka qenë e domosdoshme ose nëse rrethanat e rastit e kanë lejuar që të kryhet puna nga dikush tjetër. Përfaqësuesi përgjatë kryerjes së punës së besuar ka përgjegjësi të madhe, sidomos është përgjegjës nëse puna është kryer nga dikush tjetër dhe nuk është marrë pëlqimi paraprak i të përfaqësuarit;

- Ka për detyrë që të jep llogari dhe të paraqes raportin për punën e kryer dhe veprimet e ndërmarra. Ky informim dhe dhënie të raportit mund të jetë kohë pas kohshëm, periodike, apo me kryerje të disa punëve të besuara. Në qoftë se ekzistojnë më shumë përfaqësues për kryerjen e punëve juridike të njëjta, atëherë të gjithë e kanë për detyrë të informojnë të përfaqësuarin për gjendjen e punëve të besuara, si dhe t'i japin edhe raportin mbi ndërmarrjen e veprimeve dhe kryerjen e punëve juridike;
- Ka për detyrë të shpërblej dëmin që mund të pësoj i përfaqësuarit gjatë ndërmarrjes së veprimeve juridike dhe kryerjes së punëve të besuara.<sup>73</sup>

## 2. Llojet e autorizimit

Duke i marrë për bazë praktikën gjyqësore dhe doktrinën juridike, llojet e kontratës së përfaqësimit dallohen nga llojet e autorizimeve në vijim:

- Autorizimi i përgjithshëm
- Autorizimi i veçantë
- Autorizimi i pakufizuar
- Autorizimi i kufizuar
- Autorizimi shprehimor
- Autorizimi i heshtur
- Autorizimi i njëfishtë
- Autorizimi i shumëfishtë.

### 2.1. Autorizimi i përgjithshëm

Autorizim i përgjithshëm është një lloj i autorizimit ku përfaqësuesi autorizohet për ndërmarrjen e të gjitha punëve juridike të besuara nga i përfaqësuarit, pa përcaktuar punën

---

<sup>73</sup> Alishani, A. (1990, fq. 306-307). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

që duhet të ndërmerren. Në të drejtën tonë, në bazë të këtij autorizimi nuk mund të ndërmerren të gjitha punët juridike të përfaqësuarit, por vetëm ato punë që bëjnë pjesë në fushëveprimin e punëve të zakonshme. Nga praktika e deritanishme, mund të përcaktohen llojet e punëve juridike që hyjnë në fushëveprimin e rregullt, të cilat janë: realizimi i kërkesës, pagimi i borxhit, deponimi i parava të gatshme në kursim, shitja në treg, disponimi me sendet ose të drejtat me vlerë më të vogël, qeraja afatshkurtër.<sup>74</sup> Me autorizim të përgjithshëm mund të ndërmerren edhe punët juridike në vijim si: kryerja e punëve për mirëmbajtjen e hapësirës banesore, kryerja e punëve rreth arkëtimit të qirasë, kryerja e punëve rreth pagimit të borxheve të përfaqësuarit, ndërmarrja e veprimeve rreth disponimit me pasurinë e të përfaqësuarit, etj.<sup>75</sup>

## 2.2. Autorizimi i veçantë

Autorizimi i veçantë është një lloj i autorizimit ku i përfaqësuari e autorizon përfaqësuesin të kryejë një punë ose disa punë të caktuara juridike. Me këtë lloj të autorizimit, përfaqësuesi autorizohet që të lidhë kontrata të llojit të njëjtë apo të kryejë punë të caktuara juridike, si p.sh. shitja e shtëpisë të përfaqësuarit nga ana e përfaqësuesit. Duhet të ceket që në mungesë të autorizimit të veçantë, përfaqësuesi nuk mundet të ndërmerr detyrimin kambialor, të lidhë kontratë për dorëzaninë, për pajtimin, për gjykatën e zgjedhur ose arbitrazhin, për tjetërsimin apo ngarkimin e paluajtshmerive, dhe nuk mund që të përfshihet në një kontest, e as të heqë dorë nga ndonjë e drejtë pa shpërblim.<sup>76</sup> Nga praktika e deritanishme, pa autorizim të veçantë përfaqësuesi nuk mund të ndërmerr punën juridike si: tjetërsimin ose ngarkimin e pasurisë të përfaqësuarit, kthimin e testamentit *de cujusit* i cili gjendet në ruajtje të gjykatës, deklarimin mbi marrjen ose mos marrjen e trashëgimisë, lidhjen e kurorës, ngritjen e padisë për shkurorezim, parashtrimin dhe tërheqjen e padisë, pohimin e kërkesëpadisë, tërheqjen e kërkesëpadisë, si dhe çdo veprim tjetër gjyqësor.<sup>77</sup> Këto janë disa nga punët juridike për të cilat legjislacioni pozitiv kërkon që përfaqësuesi të ketë marrë autorizimin e veçantë nga i përfaqësuari.

---

<sup>74</sup> Станковић, О. dhe Водинелић, В. (2007, fq. 199). Увод у грађанско право. Београд.

<sup>75</sup> Alishani, A. (1990, fq. 308). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>76</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 79 paragrafi 4.

<sup>77</sup> Dauti, N. (2001, fq. 353). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

### 2.3. Autorizimi i pakufizuar

Autorizimi i pakufizuar dallon nga autorizimet tjera dhe kontratën e përfaqësimit me këtë lloj të autorizimit e bën më karakteristike se llojet tjera. Me autorizim të pakufizuar nënkuptojmë kur i përfaqësuari e autorizon përfaqësuesin, që t'i kryejë punët juridike duke mos i dhënë udhëzime mbi mënyrën, formën dhe vëllimin e ndërmarrjes së veprimeve juridike për t'i realizuar punët e besuara. Duke e marrë parasysh se punët juridike kryhen pa udhëzim të përfaqësuarit, përfaqësuesi duhet t'i kryejë punët e besuara me kontratë si njeri i kujdesshëm, ekspert i mirë dhe i ndërgjegjshëm duke i respektuar rregullat profesionale.<sup>78</sup> Në asnjë kohë punët e besuara nuk duhet të anashkalojnë, por përfaqësuesi duhet të përkushtohet për ato punë, sikur të ishin punët e veta dhe të mbrojtë interesin e të përfaqësuarit gjatë ndërmarrjes të veprimeve.

### 2.4. Autorizimi i kufizuar

Me autorizimin e kufizuar, i përfaqësuari e kufizon përfaqësuesin në ndërmarrjen e veprimeve dhe kryerjen e punës së caktuar apo punëve të caktuara. Me autorizim të kufizuar, i përfaqësuari i jep udhëzime të caktuara përfaqësuesit se si t'i kryejë punët e besuara. Udhëzimet e të përfaqësuarit mund të jenë imperative, fakultative dhe indikative. Udhëzimet imperative janë udhëzimet të cilat përfaqësuesi është i detyruar t'i ndjek dhe nuk mund të ju shmanget. Udhëzimet fakultative janë udhëzimet të cilat nuk janë detyruese për përfaqësuesin, por i lejohet që në rrethana të caktuara, nëse ai vlerëson se është e nevojshme, të veprojë ndryshe nga udhëzimi i dhënë. Udhëzimet indikative janë ato udhëzime të cilat, përfaqësuesi mund të ju shmanget nëse është në interes të përfaqësuarit dhe po ashtu për shkak të rrethanave të caktuar nuk ka mundur të kërkojë pëlqimin paraprak të përfaqësuarit.<sup>79</sup>

### 2.5. Autorizimi shprehimor

Me autorizim shprehimor nënkuptojmë kur me shprehjen e plotë të vullnetit të palëve kontraktuese, që në këtë rast janë i përfaqësuari dhe përfaqësuesi, caktohet që përfaqësuesi të ndërmarrë veprime juridike dhe t'i kryejë punët e caktuara, në emër dhe llogari të

---

<sup>78</sup> Dauti, N. (2001, fq. 354). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>79</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 223). *Опыт дел на гражданското право*. Shkup.

përfaqësuarit.<sup>80</sup> Edhe në këtë lloj të autorizimit, përfaqësuesi duhet të veprojë si një ekspert i mirë dhe në mënyrë të ndërgjegjshme me respektimin e rregullave profesionale dhe duke pasur gjithmonë në mendje interesin e të përfaqësuarit.

## 2.6. Autorizimi i heshtur

Me këtë lloj të autorizimit, kontrata e përfaqësimit lidhet me heshtjen e palëve kontraktuese. Autorizimi i heshtur ndodh kur përfaqësuesi dhe i përfaqësuarit merren vesh që heshtja e caktuar të ketë domethënie e autorizimit dhe lidhjes së kontratës. Ky lloj i autorizimit shfaqet më së shumti te kontratat e përziera, sepse te këto kontrata duhet të kryhen shumë veprime, dhe përfaqësuesi heshtazi ndërmerr disa veprime për kryerjen e punëve të caktuara. Autorizimi i heshtur mund të lind nga pozita e njëres nga palët, si p.sh. në rastet kur në shitore, shitësit që në këtë rast janë përfaqësues, mund të shesin mallin që gjendet në shitore, ndihmëset shtëpiake përmes këtij autorizimi bëjnë blerjen e gjërave ushqimore ose edhe pagimin e faturave të ndryshme siç është pagesa e energjisë elektrike, etj.<sup>81</sup>

## 2.7. Autorizimi i njëfishtë

Autorizimi i njëfishtë është i pranishëm kur si përfaqësues paraqitet një person që është i autorizuar të ndërmarrë veprime juridike dhe të kryejë punë të caktuara juridike, në emër dhe llogari të përfaqësuarit.<sup>82</sup> Ky lloj i autorizimit quhet i njëfishtë për arsye se si palë kontraktuese kemi një përfaqësues dhe një të përfaqësuar, ku një përfaqësues i kryen punët e caktuara juridike në emër dhe llogari të një të përfaqësuarit. Kështu që në të dy anët e palëve kontraktuese na paraqitet nga një person ku njëri është në cilësinë e përfaqësuesit dhe tjetri në cilësinë e të përfaqësuarit.

## 2.8. Autorizimi i shumëfishtë

Autorizim të shumëfishtë apo ndryshe të quajtur autorizim kolektiv kemi kur autorizohen më shumë vetë për ndërmarrjen e veprimeve juridike dhe kryerjen e punëve juridike në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Me këtë lloj të autorizimit, si përfaqësues na paraqiten më shumë

---

<sup>80</sup> Dauti, N. (2001, fq. 355). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>81</sup> Alishani, A. (1990, fq. 312). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>82</sup> Dauti, N. (2001, fq. 355). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

se një person dhe të gjitha personat në cilësinë e përfaqësuesit e kanë për detyrë t'i kryejnë punët e besuara. Kështu që çdo përfaqësues është i autorizuar të kryejë veprimin e caktuar apo të gjithë përfaqësuesit janë të autorizuar të kryejnë punët e caktuara juridike. Duhet të dihet saktësisht se çka përfshin autorizimi i shumëfishtë, për arsye se në rast të cënimit të kësaj kontrate duhet të vërtetohet përgjegjësia e çdonjërit. Në rast se nga rrethanat është e pamundur të vërtetohet pjesa e përgjegjësise për çdonjërin, atëherë të gjithë përgjigjen në mënyrë solidare për cënimin e kontratës.<sup>83</sup>

### 3. Krahasimi i kontratës së përfaqësimit

Kontrata e përfaqësimit ka ngjashmëri dhe dallime me disa institute apo kontrata tjera. Në vijim do të shtjellohen ngjashmëritë dhe dallimet që kontrata e përfaqësimit ka me institutet dhe kontratat në vijim.

#### 3.1. Kontrata e përfaqësimit dhe përfaqësimi ligjor

Ngjashmëria thelbësore mes kontratës së përfaqësimit dhe përfaqësimit ligjor është që përfaqësuesi është i autorizuar që të ndërmerr veprime juridike dhe të kryejë punë juridike në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Nga kjo kuptojmë që përfaqësimi ligjor dhe ai kontraktual përbëhen nga katër elementet konstitutive të përfaqësimit (“ndërmarrja e veprimeve juridike”, “me autorizim”, “në emër të huaj”, dhe “për llogari të huaj”).<sup>84</sup> Kështu që në këto dy marrëdhënie juridike, palët janë të njëjta si dhe qëllimi është i njëjtë. Ngjashmëri tjetër ekziston në atë që në të dy marrëdhëniet juridike, përfaqësuesi është i detyruar t'i mbrojë interesat e të përfaqësuarit.

Për sa i përket dallimeve mes këtyre dy marrëdhënieve juridike, mund të thuhet që dallimi thelbësor është baza juridike e këtyre marrëdhënieve. Kontrata e përfaqësimit si marrëdhënie juridike krijohet me vetë vullnetin e palëve, ndërsa marrëdhënia e krijuar nga përfaqësimi ligjor lind në bazë të ligjit, ose më saktësisht me paraqitjen e rasteve të caktuara në ligj marrëdhënia juridike krijohet si p.sh. në rast kur prindërit janë përfaqësues të fëmijëve të mitur. Dallim tjetër është se vëllimi i autorizimit të kontratës së përfaqësimit është i përcaktuar nga i përfaqësuarit, ndërsa vëllimi i autorizimit të përfaqësimit ligjor është i caktuar

---

<sup>83</sup> Alishani, A. (1990, fq. 312-313). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>84</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 210). *Опыт дел на гражданското право*. Shkup.

me ligj. Dallim tjetër ekziston te palët. Në kontratën e përfaqësimit si palë mund të jetë çdo person që posedon zotësi të veprimit ndërsa te përfaqësimi ligjor si palë mund të jenë vetëm personat e caktuar si p.sh. fëmija i mitur pa zotësi të veprimit paraqitet si i përfaqësuar ndërsa prindërit e tij paraqiten si përfaqësues; apo në rastin e kujdestarisë, ku personi nën kujdestari është i përfaqësuar, dhe si përfaqësues paraqitet kujdestari. Kështu te përfaqësimi ligjor, janë të përcaktuara me ligj, se cilat persona janë të përfaqësuar dhe përfaqësues, ndërsa te kontrata e përfaqësimit vetë palët me vullnetin e tyre vendosen të shndërrohen në të përfaqësuar dhe përfaqësues.

### 3.2. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata e ndërmjetësimit

Kontrata e ndërmjetësimit është kontratë për shërbime tregtare ku ndërmjetësuesi mundohet që të gjejë dhe të vejë në lidhje urdhërdhënësin e tij me ndonjë person të tretë, me të cilin do të lidhte një kontratë të caktuar. Domethënë te kjo kontratë kemi dy palë, në mes të cilëve lind marrëdhënia juridike, e ato janë ndërmjetësuesi dhe urdhërdhënësi. Mirëpo, në këtë kontratë për dallim nga kontrata e përfaqësimit, ndërmjetësuesi ka vetëm për detyrë që të gjejë persona të tretë të cilët mund të jenë të interesuar të bisedojnë me urdhërdhënësin dhe eventualisht të lidhin kontratën. Me çka ndërmjetësuesi nuk është i autorizuar të lidhë kontrata në emër dhe llogari të urdhërdhënësit, as nuk është i autorizuar të përçojë vullnetin e tij, por vetëm të ndërmerr veprime faktike me të cilat do të mundësojë që urdhërdhënësi i tij të bie në kontakt me personat e tretë.<sup>85</sup>

Fillimisht duhet të cekem ngjashmërinë që ekzistojnë në mes kontratës së ndërmjetësimit dhe kontratës së përfaqësimit me shpërblim. Këto dy kontrata janë kontrata të dyanshme detyruese. Ngjashmëria kryesore qëndron te disa detyrime të caktuara të palëve kontraktuese. Në kontratën e përfaqësimit, përfaqësuesi ka për detyrë të kryejë punën e besuar juridike, ndërsa në kontratën e ndërmjetësimit ka për detyrë të kërkimit të rastit. Ky detyrim paraqet si ngjashmëri me faktin që përfaqësuesi ka për detyrë të kryejë punën e besuar juridike në kontratën e përfaqësimit, ndërsa ndërmjetësuesi ka për detyrë që të kërkojë rastin e përshtatshëm dhe të hulumtojë në gjetjen e personave të tretë që mund të jenë të interesuar për lidhje të kontratës. Në të dy rastet kemi kryerje të punës por përfaqësuesi kryen punën e caktuar juridike ndërsa ndërmjetësuesi merr veprimet e caktuara

---

<sup>85</sup> Живковска, Р. (2011, fq. 206). *Опит дел на граѓанското право*. Шкуп.

në gjetjen e personit të interesuar. Përfaqësuesi dhe ndërmjetësuesi janë po ashtu të detyruar të njoftojnë të përfaqësuarin dhe urdhërdhënësin për ecurinë e punëve dhe të informojnë për veprimet e ndërmarra.<sup>86</sup> Ngjashmëri tjetër te detyrimet e palëve e kemi edhe te detyrimet e të përfaqësuarit dhe urdhërdhënësit. I përfaqësuari dhe urdhërdhënësi janë të detyruar të paguajnë shpërblimin e caktuar. Kuptohet që i përfaqësuari është i detyruar për këtë, në rast se është lidhur kontrata për shpërblim, dhe urdhërdhënësi është i detyruar për këtë, nëse arrihet lidhja e kontratës me personin e tretë.<sup>87</sup>

Në legjislacione të ndryshme ndodh që nuk bëjnë dallim mes kontratës së përfaqësimit dhe ndërmjetësimit, por është me rëndësi të vërehen dallimet mes këtyre kontratave. Dallimi kryesor që i dallon këto dy kontrata dhe i karakterizon si kontrata të ndryshme e jo të njëjta, është me atë se përfaqësuesi ka për detyrë të ndërmarrë veprimet e caktuara juridike dhe të kryejë punët e besuara juridike në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Në këtë rast veprimet e ndërmarra të përfaqësuesit konsiderohen sikur t'i kishte marrë vetë i përfaqësuari. Mirëpo te kontrata e ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi i merr veprimet e caktuara në emër të tij dhe në llogari të vetë. Në këtë rast veprimet e ndërmarra të ndërmjetësuesit nuk konsiderohet sikur t'i kishte marrë urdhërdhënësi. Kështu që në kontratën e ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi punon në llogari të urdhërdhënësi por jo në emër dhe llogari të tij, dhe ai nuk e bënë lidhjen e kontratave sikur përfaqësuesi por vetëm i gjen personat e interesuar për bisedime me urdhërdhënësin, dhe më pas urdhërdhënësi është ai që e lidh kontratën me personin e tretë të interesuar. Kështu që gjatë lidhjes së kontratave me personat e tretë, përfaqësuesi paraqitet në cilësinë e palës kontraktuese dhe si i tillë gjithmonë i mbron interesat e të përfaqësuarit, kurse ndërmjetësuesi luan një rol neutral dhe në çdo rast i mbron interesat e të dy palëve. Shpesh në mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit themelohet marrëdhënia kontraktuese e karakterit të vazhdueshëm, kurse ndërmjetësuesi sipas rregullës vetëm kohë pas kohe ndërmjetëson, te lidhja e punëve në mes të urdhërdhënësve të ndryshëm dhe personave të tretë.<sup>88</sup> Gjithashtu duhet të ceket që kontrata e përfaqësimit mund të jetë formale dhe joformale varësisht prej rastit ndërsa kontrata e ndërmjetësimit është kontratë jo formale, por përveç në qarkullimin e tregtisë së jashtme që është formale. Kontrata e ndërmjetësimit është kontratë e dyanshme detyruese,

---

<sup>86</sup> Jashari, A. (2016, fq. 158-159). *E drejta afariste (kontraktore)*. Tetovë.

<sup>87</sup> Po aty, fq. 162.

<sup>88</sup> Po aty, fq. 137.



ndërsa nëse kontrata e përfaqësimit është pa shpërblim, atëherë është kontratë e njëanshme detyruese.<sup>89</sup>

### 3.3. Kontrata e përfaqësimit dhe prokura

Prokura është autorizim të cilën i përfaqësuari me anë të punës juridike ia jep përfaqësuesit me prokurë. Prokura domethënë paraqitet si dokument që përmban vëllimin e autorizimeve të dhënë nga i përfaqësuari, dhe përfaqësuesi e përdor si dëshmi. Prokura themelohet me deklaratë të njëanshme të përfaqësuarit përmes së cilës e autorizon përfaqësuesin me prokurë që ta përfaqësojë në punët e ndryshme juridike e po ashtu edhe në procedurë gjyqësore. Prokura ka natyrë juridiko-procedurale kur manifestohet kundrejt gjykatës dhe kundrejt palës kundërshtare. Në procedurë gjyqësore, është me rëndësi të dallohet prokura si institut juridiko-procedural nga marrëdhënia e brendshme në mes të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit me prokurë, e cila çdoherë është me natyrë juridiko-materiale, ku përmes së cilës rregullohet të drejtat dhe detyrimet e të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit me prokurë. I përfaqësuari mund ta jep prokurën me shkrim ose në procesverbal para gjykatës.<sup>90</sup> Vëllimi i prokurës e përcakton pala, më saktësisht i përfaqësuari. Pala ka mundësi që të autorizojë përfaqësuesin me prokurë të ndërmerr vetëm disa veprime të caktuara apo t'i ndërmerr të gjitha veprimet juridike, duke përfshirë edhe veprimet në procedurë gjyqësore. Në fakt, përmbajtjen e autorizimeve të përfaqësuesit me prokurë e përcakton ligji, ndërsa i përfaqësuari e përcakton vëllimin konkret të prokurës brenda kornizave ligjore.<sup>91</sup>

Vëllimet e autorizimeve që dalin nga kontrata e përfaqësimit, shprehen brenda kontratës, por edhe janë të përfshira në prokurë. Rrjedhimisht arrijmë të kuptojmë se prokura paraqitet pjesë e kontratës së përfaqësimit, gjegjësisht është element i kësaj kontrate me të cilën përfaqësuesi e ka prokurën që përmban autorizimet e dhëna nga i përfaqësuari, dhe shërben si dëshmi.

Kontrata e përfaqësimit dhe prokura kanë dallimet e ndryshme në mes tyre. Fillimisht si dallim kryesor qëndron në natyrën juridike që e kanë. Kontrata e përfaqësimit paraqitet si kontratë e së drejtës së detyrimeve dhe të së drejtës tregtare, ndërsa prokura është

<sup>89</sup> Jashari, A. (2016, fq. 158). *E drejta afariste (kontraktore)*. Tetovë.

<sup>90</sup> Janevski, A. dhe Zoroska-Kamilovska, T. (2011, fq. 210). *E drejta procedurale civile, e drejta kontestimore* (përkthyer nga Zendeli, E. dhe Zendeli, N.). Tetovë: Universiteti i Evropës Juglindore

<sup>91</sup> Po aty, fq. 211.

dokument që përmban autorizimet gjegjësisht vëllimin e autorizimeve. Kontrata e përfaqësimit është kontratë që në vete përfshin elemente të shumta, ku një nga këto elemente është autorizimi gjegjësisht prokurën që përmban autorizimet. Ndërsa prokura është vetëm një element që është i përfshirë në përfaqësimin vullnetar gjegjësisht përfaqësimin me prokurë. Dallim tjetër qëndron në atë se fusha e zbatimit të kontratës së përfaqësimit është gjithëpërfshirëse, dhe zbatohet në sfera të ndryshme juridike, me theks të veçantë në sferën e së drejtës së detyrimeve dhe tregtare. Ndërsa prokura si element i përfaqësimit me prokurë zbatohet vetëm në rastet e përfaqësimit të palës në punë juridike, si dhe në veprimet e ndryshme në procedura gjyqësore. Si element tjetër i rëndësishëm që i dallon është përmbajtja dhe vëllimi i autorizimit në kontratën e përfaqësimit dhe përmbajtja dhe vëllimi i prokurës në përfaqësimin me prokurë. Ashtu siç u cek më lartë, përmbajtja dhe vëllimi i autorizimit në kontratën e përfaqësimit vendoset nga vetë vullneti i palës kontraktuese, ndërsa përmbajtja e prokurës është e caktuar me ligj dhe pala e cakton vetëm vëllimin e prokurës brenda kornizave ligjore.

### 3.4. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata në dobi të personit të tretë

Parimisht kontratat e detyrimeve nuk kanë efekt ndaj personave të tretë. Ky parim ka ekzistuar që në kohët e lashta ku është cekur *inter alios res gesta, alis neque nocere neque potesse*, që domethënë se nuk mund të kontraktohet asgjë që do të paraqiste barrë apo dobi për një person të tretë. Me këtë është kuptuar që të drejtat dhe detyrimet që lindin prej çdo kontrate, kanë efekt dhe vlejné vetëm për palët kontraktuese. Në parim nuk është e mundur që një kontratë e detyrimeve të shtrijë efektin e saj edhe ndaj palëve jo kontraktuese. Për shkak të nevojave të qarkullimit juridik dhe lehtësimit të veprimeve juridike të përditshme, përjashtim nga ky parim është kontrata në dobi të personit të tretë.

Kontrata në dobi të personit të tretë është kontratë e detyrimeve në të cilën një kontraktues që quhet promitenti, obligohet ndaj kontraktuesit tjetër që quhet stipulent, se do të ekzekutojë prestimin e caktuar në dobi të personit të tretë që quhet beneficiar. Në këtë kontratë promitenti është premtuesi që duhet të japë diçka në dobi të personit të tretë dhe në këtë kontratë është në pozitën e debitorit. Stipulenti është kontraktuesi në kontratën në dobi të personit të tretë. Stipulenti është subjekt që kontrakton ndonjë dobi për personin e tretë dhe e ka rolin e kreditorit në këtë kontratë. Beneficiari është subjekti që nuk merr pjesë në lidhjen e kësaj kontrate, por vetëm fiton dobi nga kjo kontratë. Diçka e rëndësishme për

tu cekur është se çdo kontratë e detyrimeve mund të lidhet si kontratë në dobi të personit të tretë. Në çdo kontratë mund të përfshihet klauzola në dobi të personit të tretë, sipas së cilës të drejtën e përmbushjes ose të ekzekutimit të veprimit të caktuar nga njëra palë kontraktuese mund ta ketë personi i tretë ose ndryshe i quajtur beneficiari.<sup>92</sup>

Ngjashmëri që duhet të ceket për kontratën e përfaqësimit dhe kontratën në dobi të personit të tretë është fakti që këto dy kontrata ishin kontratat e para që e e thyen parimin kryesor në të drejtën romake që ishte *alteri stipulari nemo potest*. Përmes përfshirjes së këtyre dy kontratave ky parim që në të drejtën romake ka qenë i mbrojtur që nga ligji i XII tabelave, filloj të humb vlefshmërinë e tij dhe të jep një kahje krejtësisht të re së drejtës në krahasim me kahjen dhe frymën që mbizotëron në të drejtën romake me prezencën e këtij parimi. Përmes këtyre dy kontratave, krijohen tri marrëdhënie juridike. Në kontratën e përfaqësimit krijohet marrëdhënia juridike në mes të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit, marrëdhënia juridike në mes përfaqësuesit dhe personit të tretë dhe marrëdhënia juridike në mes të përfaqësuarit dhe personit të tretë. Ndërsa në kontratën në dobi të personit të tretë, krijohet marrëdhënia juridike në mes promitentit dhe stipulentit, marrëdhënia juridike në mes promitentit dhe benficiarit dhe marrëdhënia juridike në mes stipulentit dhe benficiarit. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata në dobi të personit të tretë janë kontrata me emër, komutative, si dhe kontrata kauzale. Të dy kontratat janë kontrata përmes së cilave lehtësohet qarkullimi juridik dhe lehtësohet kryerja e punëve të caktuara.

Për sa i përket dallimeve mes këto dy kontratave, fillimisht duhet të ceket se për lidhjen e kontratës së përfaqësimit merret parasysh vullneti i palëve kontraktuese, ndërsa për lidhjen e kontratës në dobi të personit të tretë anashkalohet vullneti i benficiarit. Dallim tjetër qëndron në fushën e zbatimit të tyre. Fusha e zbatimit të kontratave të përfaqësimit është e gjerë dhe zbatohet në çdo punë juridike e veçanërisht në sferën e së drejtës së detyrimeve dhe tregtare. Ndërsa kontrata në dobi të personit të tretë zbatohet më së shumti në fushën e sigurimit si p.sh. në kontratën mbi sigurinë e jetës në dobi të personit të tretë, si dhe fushë të zbatimit ka edhe në kontratën e shitjes, kontratën mbi dhuratën me urdhër, kontratën për depozitën, dhe në pagimin e rentës së përjetshme.<sup>93</sup> Dallim tjetër qëndron në atë se në

---

<sup>92</sup> Dauti, N. (2001, fq. 118). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>93</sup> Po aty, fq. 120-121.

kontratën e përfaqësimit përfaqësuesi vepron në emër dhe llogari të përfaqësuarit, ndërsa në kontratën në dobi të personit të tretë stipulenti vepron në emër të vet.<sup>94</sup>

### 3.5. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata për veprën

Kontrata mbi veprën është marrëdhënie juridike midis kryerësit të punës dhe porositësit, në të cilën kryerësi i punës detyrohet që ta kryejë punën e caktuar, siç është prodhimi ose riparimi i ndonjë sendi, kryerja e ndonjë pune fizike ose intelektuale kurse porositësi në shkëmbim duhet të paguajë shpërblimin e caktuar. Në kontratën mbi veprën kemi dy palë kontraktuese që janë porositësi dhe kryesi i punës.<sup>95</sup>

Ngjashmëritë në mes këtyre dy kontratave, qëndrojnë në atë se kontrata e përfaqësimit dhe kontrata e veprës lidhen duke marrë parasysh cilësinë e palëve. Të dy kontratat janë të rregulluara përmes ligjit të detyrimeve. Gjithashtu si ngjashmëri tjetër është se në të dy kontratat duhet të kryhet një punë e caktuar. Këto kontrata janë kontrata me prestime të përhershme, komutative, me shpërblim, të pavarura, me emër, të thjeshta, etj.<sup>96</sup>

Për sa i përket dallimeve mes këtyre dy kontratave, këto dallime fillimisht janë në atë se kontrata e përfaqësimit është kontratë formale ndërsa kontrata për veprën është kontratë konsensuale. Dallim tjetër kemi te puna që duhet të kryhet. Te kontrata e përfaqësimit puna që duhet të kryhet është juridike, ndërsa te kontrata e veprës puna që duhet të kryhet është faktike. Te kontrata për veprën kryesi i punës si palë kontraktues kryejnë punët e caktuara ose arrijnë rezultatet e dëshiruara për porositësin, ndërsa në anën tjetër e kemi përfaqësuesin që në kontratën e përfaqësimit i kryen punët e caktuara në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Një dallim i vogël mund të vërehet në shpërblimin, në kontratën për veprën, gjithmonë ekziston shpërblimi ndërsa nëse kontrata e përfaqësimit është pa shpërblim, nuk ekziston shpërblimi për përfaqësuesin. Dallim tjetër i rëndësishëm për këto dy kontrata qëndron në detyrueshmërinë e palëve. Kontrata për përfaqësim kur është pa shpërblim është kontratë e njëanshme detyruese, ndërsa kontrata për veprën është kontratë e dyanshme detyruese.<sup>97</sup>

---

<sup>94</sup> Dauti, N. (2001, fq. 119). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>95</sup> Po aty, fq. 341.

<sup>96</sup> Alishani, A. (1990, fq. 319). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>97</sup> Po aty.

### 3.6. Kontrata e përfaqësimit dhe kontrata e shitjes me dekret

Kontrata e shitjes me dekret është një lloj i kontratës së shitjes, ku dekretmarrësi detyrohet që në afatin e caktuar ta shesë me çmim të caktuar sendin që ia ka dhënë dekretdhënësi, ose t'ia kthejë në të njëjtin afat, dhe në qoftë se nuk e kthen sendin do të konsiderohet se sendin e ka blerë për vete. Palët kontraktuese të kësaj kontrate duhet të merren vesh mbi çmimin me të cilin do të shitet sendi dhe afatin brenda të cilit duhet të shitet, dhe nëse sendi nuk shitet brenda afatit të caktuar, atëherë duhet të kthehet.<sup>98</sup>

Si ngjashmëri mes këtyre kontratave paraqitet fakti që të dy kontratat janë të vjetra dhe janë pjesë e legjislacionit pozitiv. Ngjashmëri kryesore është ekzistimi i autorizimit në të dy kontratat për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara dhe kryerjen e punëve. Ngjashmëri tjetër që paraqitet në kontratën e përfaqësimit dhe kontratën e shitjes me dekret është që në shumë aspekte shprehet vullneti i njëanshëm. Të dy kontratat janë kontrata me prestime të përhershme, komutative, të pavarura, etj.<sup>99</sup>

Këto dy kontrata dallojnë në faktin që kontrata e përfaqësimit është kontratë e veçantë e të drejtës së detyrimeve, ndërsa kontrata e shitjes me dekret është kontratë e veçantë e shitjes. Si dallim tjetër ekziston në atë që kontrata e përfaqësimit mund të jetë kontratë me shpërblim ose pa shpërblim, ndërsa te kontrata e shitjes me dekret, dekretmarrësi e merr sendin e luajtshëm nga dekretdhënësi që ky brenda afatit të caktuar të shes sendin dhe çmimin e realizuar t'ia dorëzohet dekretdhënësit. Po ashtu duhet të ceket se në kontratën e përfaqësimit kryhet një punë apo disa punë juridike, ndërsa te kontrata e shitjes me dekret kryhet një apo disa punë të caktuara faktike. Është për tu cekur që te kontrata për përfaqësim, përfaqësuesi kryen punët juridike, në emër dhe në llogari të përfaqësuarit. Ndërsa te kontrata e shitjes me dekret, nëse dekretmarrësi nuk e shet sendin e dhënë në afatin e caktuar dhe në të njëjtën kohë nuk e bën kthimin e sendit, atëherë llogaritet që dekretmarrësi e ka ndalur sendin për veti. Një dallim tepër i rëndësishëm qëndron te revokimi, ku i përfaqësuarit në kontratën e përfaqësimit e ka të drejtën e revokimit të autorizimit, ndërsa në kontratën e shitjes me dekret, nuk mund të revokohet dekreti i shitjes.<sup>100</sup>

---

<sup>98</sup> Dauti, N. (2001, fq. 321). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>99</sup> Alishani, A. (1990, fq. 320). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>100</sup> Po aty.

# KAPITULLI III

---

## *Kontrata e përfaqësimit në Republikën e Kosovës*

---

### 1. Kontrata e përfaqësimit në Kosovë

Rregullimi i kontratës së përfaqësimit në Kosovë bëhet me ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve nr. 04/77, ligj i cili ka hy në fuqi në vitin 2012. Kjo kontratë dhe përfaqësimi në përgjithësi trajtohet prej nenit 72 deri në nenin 84. Kontrata e përfaqësimit tregtar e cila paraqet një lloj të kontratës së përfaqësimit, trajtohet me të njëjtin ligj prej nenit 804 deri në nenin 825.

#### 2.1. Kuptimi i kontratës të përfaqësimit

Në legjislacionin pozitiv të Kosovës, me kontratë të përfaqësimit kuptojmë kontratën që lidhet mes të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit ku i përfaqësuarit e autorizon përfaqësuesin që në emër dhe llogari të tij të kryej ndonjë veprim juridik, kurse nga ana tjetër përfaqësuesi obligohet që ta kryej punën me shpërblim ose pa shpërblim të caktuar.<sup>101</sup> Ky nocion është i njëjtë me nocionin të cilin ja kanë dhënë edhe legjislacionet e shteteve të ndryshme, për të cilën do të flitet më tepër në kapitullin e fundit. Në këtë kontratë, përfaqësuesi i ndërmerr veprimet e caktuara juridike që t'i kryejë punët e besuara juridike. Me punë të besuara kuptojmë punët për të cilat i përfaqësuarit e ka autorizuar përfaqësuesin t'i kryejë.

Një nga punët juridike të besuara mund të jetë edhe lidhja e ndonjë kontrate. Në qoftë se paraqitet rasti i tillë, atëherë kontrata të cilën e lidhë përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar dhe në kuadrin e autorizimeve të veta, e obligon drejtpërdrejt të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese.<sup>102</sup> Me anë të kësaj kuptojmë që i përfaqësuarit obligohet për çdo veprim dhe punë të ndërmarrë nga përfaqësuesi. Kështu që përderisa një kontratë lidhet nga përfaqësuesi dhe ky veprim i lidhjes së një kontrate të caktuar është përbrenda përmbajtjes dhe vëllimit të autorizimit, atëherë kjo kontratë në mënyrë të drejtpërdrejtë e obligon si palën e tretë që e ka nënshkruar kontratën me përfaqësuesin, po ashtu edhe të përfaqësuarin, pasi përfaqësuesi e ka lidhur atë kontratë në emër dhe llogari të tij.

---

<sup>101</sup> Dauti, N. (2001, fq. 349). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>102</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 73, paragrafi 1.

Përfaqësuesi ka për detyrë ta njoftojë palën tjetër se paraqitet në emër të personit të përfaqësuar, por edhe kur nuk e bënë këtë gjë kontrata ka efekt juridik për të përfaqësuarin dhe për palën tjetër, në qoftë se kjo ka ditur, ose nga rrethanat, ka mundur të vijë në përfundim se ai paraqitet si përfaqësues.<sup>103</sup> Nëse përfaqësuesi nuk e ka njoftuar palën tjetër kontraktuese se paraqitet në emër të personit të përfaqësuar, e as pala tjetër kontraktuese nga rrethanat nuk ka mundur të vijë në përfundim se ai paraqitet si përfaqësues, kontrata nuk e obligon palën tjetër kontraktuese gjegjësisht personin e tretë. Dispozitat mbi detyrën e përfaqësuesit që të njoftojë palën tjetër se paraqitet në emër të personit të përfaqësuar vlejnë edhe në rastin kur të njëjtat njoftime i jepen përfaqësuesit të palës tjetër, me të cilën përfaqësuesi i palës së parë lidh kontratën. Kështu që pala tjetër kontraktuese është e autorizuar që nga përfaqësuesi të kërkojë provën për autorizimet e përfaqësuesit.<sup>104</sup>

## 2.4. Autorizimi

Autorizimi është dokumenti me shkrim me të cilin konstatohet dhënia e autorizimit përfaqësuesit nga i përfaqësuari.<sup>105</sup> Me autorizim kuptojmë dokumentin me të cilin dëshmohet që përfaqësuesi ka autorizimin nga i përfaqësuari për veprimet e ndërmarra dhe punët e kryera. Autorizimi shërben si mjet dëshmues për personat e tretë që përfaqësuesi nuk është duke vepruar në emër dhe llogari të tij, por në emër dhe llogari të përfaqësuarit.

### 2.4.1. Bartja e autorizimeve

Përfaqësimi në kontratën e përfaqësimit ka kuptim personal dhe lidhet për cilësitë personale të përfaqësuesit (*intuitu personae*). Marrëdhënia e krijuar në kontratën e përfaqësimit mbështetet në zotësinë e përfaqësuesit, ndjeshmërinë e tij, dhe besimin e personit të përfaqësuar. Për këtë arsye përfaqësuesi nuk mund të bëjë bartjen e autorizimeve ta veta në tjetrin, përveç nëse kjo i është lejuar me ligj ose me kontratë. Përgjithësisht, ai mund ta bëjë këtë, në qoftë se është i penguar nga rrethanat që punën ta kryejë vetë, kurse interesat e të përfaqësuarit kërkojnë ndërmarrjen pa vonesë të veprimit juridik.<sup>106</sup> Nga kjo vërehet që

---

<sup>103</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 73, paragrafi 3.

<sup>104</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 82-83). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>105</sup> Dauti, N. (2001, fq. 349). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

<sup>106</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 74.

ligjvënësi ka lënë hapësirën për të përjashtuar parimin mbi mos bartjen e autorizimeve te tjetri në rastet në vijim:

- Përfaqësuesi mund të jetë i autorizuar me ligj të veçantë që të caktojë personin tjetër për përfaqësim, si p.sh. avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti i avokatisë, ku është duke punuar ai, por vetëm në gjykatën e shkallës së parë.<sup>107</sup>
- Me anën e kontratës për përfaqësim, palët kontraktuese kanë mundësi që shprehimisht të saktësojnë që në situata të caktuara, përfaqësuesi ka të drejtë t'i bartë autorizimet e veta te personi tjetër.
- Në situatat kur përfaqësuesi është i penguar që të kryejë punën personalisht dhe interesat e përfaqësuarit kërkojnë ndërmarrjen e veprimit pa vonesë, atëherë përfaqësuesi mund t'i bartë autorizimet e veta te personi tjetër.<sup>108</sup>

Efekti ligjor i bartjes së autorizimit qëndron në atë se, nga momenti i bartjes së autorizimit, të përfaqësuarin e përfaqëson personi tjetër e jo përfaqësuesi i parë. Për këtë arsye, përfaqësuesi tek i cili është bartur autorizimi për përfaqësim që quhet substituti, në raport me të tretin nuk e përfaqëson përfaqësuesin, por drejtpërdrejt të përfaqësuarin. Vetë substituti, sikurse edhe përfaqësuesi i parë ngelin jashtë punës juridike, të cilën e ka lidhur për të përfaqësuarin. Duke marrë parasysh se përfaqësuesi i ri kryen punën e zëvendësimit të përfaqësuesit paraprak, vëllimi i autorizimeve të tij mund të përfshijë vetëm ato punë juridike për të cilat ka qenë i autorizuar edhe paraardhësi i tij, duke marrë parasysh se askush nuk mund të bartë te tjetri më shumë të drejta, sesa ato që i posedon vetë.<sup>109</sup>

#### 2.4.2. Tejkalimi i kufirit të autorizimit

Me tejkalim të kufirit të autorizimit nënkuptojmë ndërmarrjen e veprimeve dhe kryerjen e punëve juridike për të cilat i përfaqësuarin nuk e ka autorizuar përfaqësuesin. Kur përfaqësuesi e tejkalon kufirin e autorizimit, detyrimet krijohen për të përfaqësuar vetëm nëse ai e miraton tejkalimin. Ky miratim ka veprim prapaveprues ashtu që efektet e prodhuara konsiderohen sikur përfaqësuesi nga fillimi ka vepruar në bazë të autorizimit.<sup>110</sup>

<sup>107</sup> Ligji për procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 03/L-006). Neni 90 paragrafi 4.

<sup>108</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 83). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>109</sup> По ату, fq. 84.

<sup>110</sup> Станковић, О. dhe Водинелић, В. (2007, fq. 203). *Увод у грађанско право*. Београд.



Në rastet kur përfaqësuesi i tejkalon kufijtë e autorizimit, i përfaqësuari është në obligim vetëm në qoftë se e miraton tejkalimin. Por në qoftë se i përfaqësuari nuk e aprovon kontratën brenda afatit që nevojitet rregullisht që kontrata e llojit të tillë të shqyrtohet e të vlerësohet, do të konsiderohet se aprovimi nuk është dhënë fare.<sup>111</sup> Pasi që përfaqësuesi gjatë kryerjes së punëve juridike nuk bën çka dëshiron ai, por duhet të veproj në përputhje me vullnetin, udhëzimet e marra nga i përfaqësuari, dhe në bazë të autorizimit të dhënë. Prandaj, në rastet kur përfaqësuesi i tejkalon autorizimet e dhëna përgjatë lidhjes së kontratës, atëherë parimisht kontrata e lidhur në mes përfaqësuesit dhe personit të tretë nuk e detyron të përfaqësuarin. Në qoftë se i përfaqësuari tejkalimin e autorizimit e miraton, atëherë veprimi i ndërmarrë apo kontrata e lidhur e obligon të përfaqësuarin. Ky miratim nga ana e të përfaqësuarit duhet të jepet brenda kohës që kontrata në fjalë të mund të shqyrtohet dhe të miratohet.<sup>112</sup>

Në qoftë se pala tjetër nuk ka ditur dhe as që është dashur ta dinte për tejkalimin e autorizimit, menjëherë posa ta ketë mësuar për tejkalimin e bërë, mundet të deklarojë se nuk e quan veten të obliguar nga kontrata, duke mos pritur që i përfaqësuari të deklarohet rreth kontratës. Në qoftë se i përfaqësuari e refuzon lejimin, përfaqësuesi dhe i përfaqësuari janë përgjegjës në mënyrë solidare për dëmin që e ka pësuar pala tjetër, po që se kjo nuk ka ditur dhe as që është dashur të ishte në dijeni për tejkalimin e autorizimit.<sup>113</sup> Përderisa i përfaqësuari nuk është deklaruar mbi tejkalimin e kufirit të autorizimit, kontrata është në pozitën në pritje. Në këtë rast rrethana është e ngjashme sikur në rastin e kontratave të lidhura nga personat me zotësi të kufizuar të veprimit, pa lejen e përfaqësuesit ligjor. Personi i tretë nuk ka të drejtë që nga përfaqësuesi që ka tejkalluar kufirin e autorizimit të kërkojë që ai në vend të përfaqësuarit, ta marrë obligimin e përmbushjes së detyrimit nga tejkalimi i autorizimit, edhe përkundër asaj se me rastin e lidhjes së kontratës, pala tjetër ka qenë me mirëbesim dhe nuk ka ditur e as që është dashur të ishte në dijeni për tejkalimin e autorizimit, por vetëm ka të drejtë që të kërkojë nga përfaqësuesi dhe i përfaqësuari kompensimin e dëmit, të cilin e ka pësuar dhe këta janë përgjegjës për këtë dëm në mënyrë solidare.<sup>114</sup>

---

<sup>111</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 75.

<sup>112</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 84-85). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>113</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 75, paragrafi 4 dhe 5.

<sup>114</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 85). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

### 2.4.3. Lidhja e kontratës nga personi i paautorizuar

Përfaqësues i paautorizuar është personi i cili palës tjetër i prezantohet si përfaqësues i ndonjë personi, edhe se ai nuk është i autorizuar nga i përfaqësuari, dhe në emrin dhe llogarinë e tij kryen punë juridike apo lidh kontratë detyruese. Me përfaqësues të paautorizuar nënkuptojmë personin i cili nuk posedon asnjë lloj të autorizimit nga i përfaqësuari, për të cilin është duke e kryer punën juridike apo duke lidhur ndonjë kontratë. Në kuptim më të gjerë nënkuptojmë edhe përfaqësuesin që e tejkalon apo keqpërdor autorizimin, por ligji për marrëdhënie të detyrimeve e ka bërë këtë ndarje në mes tejkalimit të kufirit të autorizimit dhe veprimit të personit të paautorizuar. Parimisht nëse përfaqësuesi i paautorizuar e lidh kontratën detyruese në emër dhe llogari të përfaqësuarit pa autorizimin e tij, kjo kontratë nuk e obligon të përfaqësuarin. Mirëpo sipas ligjit për marrëdhënie të detyrimeve, thuhet se kontrata që lidhet prej ndonjë personi si i autorizuar në emër të tjetrit pa autorizimin e këtij, e obligon personin e përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar vetëm nëse ky e miraton kontratën më vonë.<sup>115</sup> Nga kjo nënkuptojmë se në qoftë se i përfaqësuari e jep miratimin pas lidhjes së kontratës atëherë kjo kontratë e obligon të përfaqësuarin. Miratimi mund të jepet nga i përfaqësuari dhe personi i tretë, me të cilin përfaqësuesi i paautorizuar e ka lidhur kontratën. Miratimi mund të jetë shprehimor ose edhe përmes veprimeve konkludente, si p.sh. pagesa e çmimit të kontraktuar. Duhet të merret parasysh se përderisa miratimi nuk jepet apo refuzohet, kontrata e cila është lidhur nga përfaqësuesi i paautorizuar është në pritje.<sup>116</sup>

Në rastin kur personi i tretë njoftohet se kontrata e lidhur është lidhur nga përfaqësuesi i paautorizuar, ai ka të drejtë të kërkojë nga personi i përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar, që në afatin e caktuar të deklarohet për kontratën ashtu siç është cekur në ligjin për marrëdhënie të detyrimeve ku thuhet se pala me të cilën është lidhur kontrata mund të kërkojë nga personi i përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar që në afatin e caktuar të deklarohet nëse e lejon kontratën ose jo.<sup>117</sup> Nëse brenda këtij afati kontrata nuk lejohet, ekziston supozimi ligjor se kontrata nuk është lidhur fare.

---

<sup>115</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 76, paragrafi 1.

<sup>116</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 86). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>117</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 76, paragrafi 2.

Në qoftë se personi që ka qenë i përfaqësuar në mënyrë të paautorizuar nuk e lejon kontratën dhe rrjedhimisht konsiderohet se kontrata nuk është lidhur fare, atëherë në këtë rast pala me të cilin është lidhur kontrata, mund të kërkojë nga personi i cili si përfaqësues e ka lidhur kontratën pa autorizim kompensimin e dëmit, në qoftë se në kohën e lidhjes se kontratës nuk e ka ditur e as që është dashur ta dijë se ky person nuk ka pasur autorizim për lidhjen e kontratës.<sup>118</sup> Atëherë raporti në mes personit të tretë dhe të përfaqësuarit nuk krijohet, por lind raporti në mes personit të tretë dhe personit të paautorizuar. Ky raport ka të bëjë me kompensimit e dëmit të pësuar, dhe personi i tretë mund të kërkojë shpërblimin e dëmit ndaj personit të paautorizuar, nëse nuk e ka ditur e as që është dashur të dijë se ky person i paautorizuar nuk ka autorizim për lidhjen e kontratës. Ligjvënësi në këtë nen nuk e ka përcaktuar se për çfarë dëmi personi i tretë ka të drejtë në shpërblim, por duke e marrë parasysh nenin 137 të po të njëjtit ligj që e trajton dëmin, ku është përkufizuar si zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengim i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi i dhimbjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës tjetrit (dëmi jo material), duhet të konsiderohet se personit të tretë gjegjësisht të dëmtuarit, duhet t'i njihet e drejta në këto aspekte të dëmit. Mirëpo, nëse personi i paautorizuar dëshiron të lirohet nga përgjegjësia e cila krijohet me këtë raport të cekur, atëherë këtë mund ta bëjë përmes dy mënyrave në vijim: edhe atë përmes kontestimit të vlefshmërisë së kontratës për shkak të mungesës së vullnetit (lajthimit, mashtrimit, kërcënimit, etj.) ose përmes argumentimit se personi i tretë me të cilin e ka lidhur kontratën, e ka ditur ose është dashur të dijë për mungesat ose mosekzistimin e autorizimit.<sup>119</sup>

## 2. Prokura

Prokura e përbën elementin kyç në institutin e përfaqësimit vullnetar. Prokura përmban autorizimin për përfaqësim që i jepet me punë juridike të autorizuarit nga ana e autorizuesit.<sup>120</sup> Kodi civil i Kosovës prokurën e ka definuar si akt juridik përmes të cilit një person i jep personit tjetër autorizimin për përfaqësim në lidhjen e kontratave ose për veprime tjera.<sup>121</sup> Prokura e shtjellon ose e mbulon raportin intern mes përfaqësuesit dhe të

---

<sup>118</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 76, paragrafi 4.

<sup>119</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 87). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>120</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 77, paragrafi 1.

<sup>121</sup> Kodi civil i RKS-së, Libri 2: Detyrimet. Neni 61.

përfaqësuarit. Gjatë shqyrtimit të raportit intern, palët kontraktuese quhen edhe si autorizues dhe i autorizuar.

### 3.1. Dhënia e prokurës

Autorizimi apo prokura mund të jepet apo merret në bazë të:

- Dhënies së njëanshme të vullnetit
- Me kontratë

Dhënia e njëanshme e vullnetit paraqitet si punë e njëanshme juridike që dallon nga dhënia e autorizimit me kontratë që paraqitet si punë e dyanshme juridike. Dallimi mes këto dyja qëndron në atë që te puna e njëanshme juridike, autorizimi ka kuptimin e autorizimit të autorizuesit, që në emër dhe për llogari të tij të mund të ndërmarrë veprime juridike, kurse tek autorizimi, si punë e dyanshme juridike, i autorizuari ka obligim që të veprojë në atë mënyrë.<sup>122</sup>

Autorizimi i dhënë e ka kuptimin e raportit të brendshëm në mes përfaqësuesit ose të autorizuarit dhe të përfaqësuarit ose autorizuesit. Me këtë i autorizuari nuk fiton ndonjë të drejtë subjektive, por vetëm mundësinë juridike të lidhjes së punëve juridike në emër dhe për llogari të autorizuesit. Pavarësisht se në cilën mënyrë është marrë autorizimi, autorizimi gjithmonë përfaqëson një punë të pavarur juridike dhe nuk e ka kuptimin e pjesës përbërëse të ndonjë pune tjetër themelore, siç është rasti te përfaqësuesi ligjor, ai statusor apo te përfaqësuesit në bazë të aktit të organit shtetëror, tek të cilët ekziston lidhja mes kompetencave për përfaqësim dhe punës juridike me të cilën ka të bëjë autorizimi. Kështu, p.sh. kompetenca e përfaqësimit të të miturit nga ana e prindërve të tij, varet edhe nga ekzistimi i raportit juridik të prindërve dhe fëmijëve.<sup>123</sup>

Në legjislacionin e Kosovës si dhe në të drejtë komparative bashkëkohore bëhet dallimi i rreptë mes autorizimit dhe punës juridike në bazë të së cilës i autorizuari është i autorizuar t'i kryejë punët e të autorizuarit. Kështu që prokura e ka fatin juridik të pavarur nga raporti juridik, mbi bazën e së cilës është dhënë prokura. Prandaj, anulimi i punës juridike në parim nuk reflekton në rregullsinë e vetë prokurës për lidhjen e asaj pune juridike. Puna themelore juridike është vetëm baza juridike në të cilën mbështetet prokura, dhe lidhur me

---

<sup>122</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 88). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>123</sup> Po aty.

këtë ajo është abstrakte kundrejt vetë punës juridike. Është me rëndësi të kuptohet se nuk do të thotë se dallimi mes prokurës dhe punës themelore duhet trajtuar me rreptësi dhe në mënyrë formale sepse në përditshmëri ky dallim nuk vërehet aspak. Diçka me rëndësi për të mbajtur mend është që nuk është e domosdoshme që së pari të lidhet kontrata për përfaqësimin, e pastaj të jepet prokura, por në të shumtën e rasteve kjo procedurë zhvillohet në të njëjtën kohë.<sup>124</sup>

### 3.2. Forma e veçantë e prokurës

Forma e parashikuar me ligj për ndonjë kontratë ose për ndonjë punë tjetër juridike vlen edhe për prokurën që jepet për lidhjen e kësaj kontrate, përkatësisht për ndërmarrjen e kësaj pune juridike.<sup>125</sup> Nga kjo arrijmë të kuptojmë se prokura duhet të jetë në formën e caktuar, varësisht nga kontrata ose puna juridike. Forma e veçantë e prokurës kërkohet vetëm atëherë kur me ligj është parashikuar forma për rregullsinë e asaj kontrate, përkatësisht punës tjetër juridike, për lidhjen e së cilës është parashikuar forma me ligj. Vetëm në rastet e këtilla kërkohet prokura formale në atë formë ligjore, që nënkupton se kontrata për përfaqësim është joformale me atë që në legjislacionin e Kosovës, është pranuar forma e konsenzualitetit dhe jo forma e formalitetit.<sup>126</sup>

### 3.3. Vëllimi i prokurës

Vëllimi i prokurës po ashtu varet nga vetë vullneti i të përfaqësuarit. I përfaqësuarit i cakton llojet e autorizimeve që do t'ia jep përfaqësuesit me prokurë. Kështu që përfaqësuesi mund të ndërmerr vetëm ato punë juridike, për ndërmarrjen e të cilave i është dhënë prokura. Varësisht prej vëllimit të prokurës, legjislacioni ynë dallon dy lloje të prokurës:

- Prokura e përgjithshme ose ndryshe e quajtur gjenerale; dhe
- Prokura e veçantë ose ndryshe e quajtur speciale.

Përfaqësuesit që i është dhënë prokura e përgjithshme mund të ndërmerr vetëm ato veprime juridike dhe t'i kryejë ato punë juridike që i takojnë ushtrimin të veprimtarisë së rregullt. Për arsye se termi veprimtari e rregullt është shumë i gjerë dhe abstrakt, ligjvënësi në po të njëjtin

---

<sup>124</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 89). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>125</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 78.

<sup>126</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 89). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

nen e ka cekur se cilat punë juridike nuk i takojnë veprimtarisë së rregullt, dhe rrjedhimisht përfaqësuesi për ato punë juridike duhet të posedojë prokurë të veçantë. Kështu që përfaqësuesi nuk mundet, pa autorizim të veçantë për secilin rast të veçantë, të ndërmerr detyrimin kambialor, të lidhë kontratë për dorëzanimin, për pajtimin, për gjykatën e zgjedhur ose arbitrazhin, për tjetërsimin apo ngarkimin e paluajtshmërive, që të përfshihet në një kontest, e as të heqë dorë nga ndonjë e drejtë pa shpërblim.<sup>127</sup>

I përfaqësuari gjegjësisht autorizuesi, me rastin e dhënies së prokurës, qoftë kur bëhet fjalë për autorizim të përgjithshëm apo të veçantë, mund të parashtrojë kufizime të caktuara për ndërmarrjen e punëve në emër dhe llogari të tij, p.sh. për personin me të cilin do të lidhet kontrata, ose për kohëzgjatjen e kontratës. Në këto raste, prokura e tillë quhet prokurë e kufizuar.<sup>128</sup>

### 3.4. Revokimi dhe kufizimi i prokurës

I përfaqësuari ka të drejtë gjithashtu që të revokojë dhe po ashtu të kufizojë vëllimin e prokurës së dhënë. Kjo e drejtë për të përfaqësuarin shfaqet si e drejtë absolute, dhe mund që ta përdor çdoherë. Dhënësi i prokurës ose i përfaqësuari mund ta kufizojë ose ta revokojë prokurën, edhe nëse me kontratë ka hequr dorë nga kjo e drejtë. Kjo e drejtë i mundëson dhënësit të prokurës gjegjësisht të përfaqësuarit që në çdo kohë të eliminojë rrezikun e keqpërdorimit nga ana e përfaqësuesit. Revokimi ose kufizimi i prokurës mund të bëhet pa ndonjë formë të veçantë, edhe atëherë kur për kontratën apo për punën juridike për të cilën është dhënë prokura është parashikuar forma e detyrueshme. Me revokimin e prokurës, përfaqësuesit nuk mund t'i shkaktohet dëm dhe në rastet kur me revokimin apo kufizimin e prokurës është cenuar puna juridike për të cilën përfaqësuesit i është dhënë prokura si p.sh. në rastet kur është cenuar kontrata mbi dekretin, kontrata mbi veprën, apo ndonjë kontratë tjetër, atëherë përfaqësuesi ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar.<sup>129</sup>

### 3.5. Shuarja dhe kufizimi i prokurës ndaj personave të tretë

Revokimi i prokurës dhe kufizimi i saj, nuk ka efekt ndaj personit të tretë që ka lidhur kontratën me të autorizuarin, apo që ka kryer ndonjë punë tjetër juridike, e nuk ka qenë në

---

<sup>127</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 79.

<sup>128</sup> Aliu, A. (2013, fq. 348). *E drejta civile, pjesa e përgjithshme*. Prishtinë.

<sup>129</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 80.

dijeni dhe as që ka qenë i obliguar të dinte se prokura është revokuar, përkatësisht se është kufizuar prokura.<sup>130</sup> Kjo do të thotë se me supozimin e ndërgjeshmërisë së palës së tretë, me gjithë revokimin ose kufizimin e prokurës, puna e lidhur juridike me të autorizuarin prodhon të gjitha pasojat juridike sikur veprimi i të autorizuarit të ishte bërë në situatën e ekzistimit të prokurës fillestare.<sup>131</sup>

Nëse autorizuesi nuk e ka njoftuar palën e tretë, se ia ka revokuar ose kufizuar prokurën, e as i autorizuari s'e ka njoftuar palën e tretë për ndërrimin e raportit të brendshëm me autorizuesin, atëherë autorizuesi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit nga i autorizuari për shkak të lidhjes së punës juridike pas kufizimit ose revokimit të prokurës. Përrjashtimisht në situatën kur i autorizuari nuk ka qenë në dijeni e as që ka qenë i obliguar të dinte se prokura është revokuar ose kufizuar, atëherë ekziston supozimi ligjor se i autorizuari është i ndërgjegjshëm dhe nuk është përgjegjës për dëmin të cilin ja ka shkaktuar dhënësit fillestar të prokurës.<sup>132</sup>

### 3.6. Rastet e tjera të shuarjes së prokurës

Përveç revokimit e cila është cekur më lartë si mënyrë e shuarjes së prokurës, ligjvënësi i ka paraparë edhe disa raste të tjera përmes të së cilave prokura shuhet. Rastet e tjera të shuarjes së prokurës ndërlidhen me vdekjen gjegjësisht shuarjen e autorizuesit dhe të autorizuarit.<sup>133</sup> Këtu përfshihen edhe rastet e shuarjes së prokurës me heqjen e zotësisë për të vepruar të prokurdhënësit gjegjësisht autorizuesit.<sup>134</sup> Me atë që përfaqësimi ndërlidhet për cilësitë e palëve kontraktuese, parimisht prokura shuhet në rast të vdekjes gjegjësisht shuarjes të njëjës nga palëve kontraktuese. Prokura nuk do të shuhet në qoftë se palët janë marrë vesh që pas vdekjes së njëjës nga palët, prokura të vazhdojë përmes trashëgimtarëve ligjor ose trashëgimtarëve të përcaktuar në prokurë.

Si shkaqe tjera nga ato të cekura më lartë të shuarjes së prokurës janë:

- Revokimi i njëanshëm i prokurës nga ana e të autorizuarit;
- Skadimi i kohës kur prokura është dhënë për një afat të caktuar;

<sup>130</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 81, paragrafi 1.

<sup>131</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 92). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>132</sup> Po aty, fq. 93.

<sup>133</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 82.

<sup>134</sup> Aliu, A. (2013, fq. 350). *E drejta civile, pjesa e përgjithshme*. Prishtinë.

- Përbushja e punës së caktuar juridike kur ka ekzistuar prokura e veçantë;
- Pamundësia e përbushjes së punës së synuar juridike;
- Humbja e zotësisë së veprimit e të autorizuarit, etj.<sup>135</sup>

### 3. Autorizimi afarist

Autorizimi afarist ka për bazë autorizimin i cili në suaza të ligjit mund të jepet nga ana e një kompanie apo tregtari të pavarur me të cilën një person autorizohet të kryejë punën, duke lidhur ose përbushur kontrata specifike. Secili person me zotësi veprimi mund të jetë i autorizuar i kompanisë apo tregtarit të pavarur. Ky autorizim e ka marrë emërtimin autorizim afarist për arsye se autorizimet kanë të bëjnë vetëm me lidhjen e kontratës dhe punëve të tjera të cilat përfshihen në veprimtarinë e regjistruar të kompanisë apo tregtarit të pavarur. Por ky lloj i autorizimit mund të kuptohet vetëm si një autorizim më i ngushtë në kuadër të autorizimit të përgjithshëm, të ndonjë rregulle apo tradite e cila është lejuar, që rrjedhimisht nënkupton një autorizim anësor lidhur me kryerjen e punës kryesore, e cila është e lidhur me vetë veprimtarinë për të cilën është regjistruar kompania ose tregtari i pavarur.<sup>136</sup>

#### 4.1. Autorizimi i punonjësit

Me autorizim të punonjësit nënkuptojmë autorizimin e punonjësit që punon në kompani apo te tregtari i pavarur, i cili ka për detyrë t'i kryej punët juridike të caktuara apo të lidhë kontratat specifike në lidhje me veprimtarinë e kompanisë apo tregtarit të pavarur. I autorizuari afarist është kompania apo tregtari i pavarur, si dhe mund të jetë edhe punëtor i kompanisë apo tregtarit të pavarur, i cili i merr autorizimet nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë apo tregtarit të pavarur, në mënyrën e përcaktuar me aktin e përgjithshëm të kompanisë. Si autorizues afarist mund të jetë punëtori i kompanisë apo tregtari i pavarur që jashtë rrethit të veprimtarisë së vet të kryejë ndonjë punë të caktuar juridike. Personat e punësuar në kompani apo te tregtari i pavarur, të cilët në bazë të kontratës kryejnë punë që kërkon lidhjen ose përbushjen e kontratave specifike janë: shitësit në dyqane, furnizuesit me ushqime dhe në sektorin spitalor, sportelistët në zyrat e postës apo bankave dhe të

---

<sup>135</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 94). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>136</sup> Po aty, fq. 95.



ngjashëm, që kanë të drejtë jo vetëm t'i lidhin kontratat me palët, por edhe janë të obliguar ato kontrata t'i përmbushin.<sup>137</sup>

#### 4.2. Përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve

Me përfaqësues të shitjeve të udhëtimeve nënkuptojmë personin i cili si përfaqësues i autorizuar i kompanisë ose tregtarit të pavarur që merret me veprimtari ekonomike, viziton kompanitë apo tregtarët e tjerë të pavarur dhe u ofron ose më saktësisht u jep atyre ofertën e punëdhënësit të vet në mënyrë që në bazë të prospektit ose mostrës së ndonjë malli që e prodhon apo e shet punëdhënësi, këta persona ta porosisin ose ta blejnë këtë mall, ose të pranojnë ndonjë shërbim të punëdhënësit të tij. Përfaqësuesi i shitjeve të udhëtimeve autorizohet vetëm për veprimet juridike që lidhen me shitjen e mallrave dhe të përmendura në autorizim. Raporti juridik i përfaqësuesit të shitjeve mund të jetë i rregulluar me kontratë të punës ose me kontratën për veprën.<sup>138</sup>

Përveç të drejtave dhe detyrimeve që parashihen në kontratë, duhet të parashihen edhe veprimet juridike që mund t'i ndërmerr përfaqësuesi i shitjeve të udhëtimeve. Por në rast se me kontratë nuk është e sigurt se cilat veprime ka të drejtë t'i ndërmarrë, atëherë përfaqësuesi i shitjeve të udhëtimeve konsiderohet se nuk ka të drejtë të lidhë kontratë, por thjeshtë të marrë urdhra. Në qoftë se përkundër kësaj, përfaqësuesi i shitjeve të udhëtimeve e lidh kontratën, atëherë kjo kontratë ka fuqi juridike nëse punëdhënësi e miraton. Përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve të autorizuar për lidhjen e kontratave, nuk autorizohen për lidhjen e kontratave me kredi ose për pranimin e të ardhurave të shitjeve, përveç nëse posedojnë një autorizim të veçantë për shitje të kredisë ose për pranimin e të ardhurave të shitjeve.<sup>139</sup> Pavarësisht nga përmbajtja e autorizimeve, përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve kanë të drejtë që në emër të punëdhënësit, të marrin deklaratat në lidhje me të metat e mallrave dhe deklaratat tjera në lidhje me përmbushjen e kontratave. Përfaqësuesi i shitjeve të udhëtimit, po ashtu ka të drejtë të marrë masat e nevojshme në emër të autorizuesit, për të ruajtur të drejtat kontraktuale.<sup>140</sup>

---

<sup>137</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 95). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

<sup>138</sup> Po aty, fq. 96.

<sup>139</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 84.

<sup>140</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A. dhe Aliu, A. (2013, fq. 97). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.

Edhe përkundër faktit që ligjvënësi këtë lloj të përfaqësimit e ka quajtur si përfaqësim të shitjeve dhe udhëtimeve, mund të konkludojmë që ky lloj i përfaqësimit përfshin më shumë se sa shitjen e udhëtimeve si punë juridike e besuar. Duke e marrë parasysh llojin e autorizimeve që ky lloj i përfaqësuesit i ka, duhet të ceket se emërtimi është i gabuar dhe aspak i përshtatshëm me këtë lloj të përfaqësimit.

#### 4. Kontrata e përfaqësimit tregtar

Kjo kontratë është një lloj i kontratës së përfaqësimit, por me karakter plotësisht tregtar. Kontrata për përfaqësimin tregtar është një kontratë e cila lidhet ndërmjet dy subjekteve, përfaqësuesit tregtar dhe urdhërdhënësit, në bazë të së cilës përfaqësuesi tregtar autorizohet ta përfaqësojë urdhërdhënësin gjegjësisht i përfaqësuarit që në emër dhe llogari të urdhërdhënësit të mund të lidh kontrata të ndryshme, ndërsa si kundërvlerë për këtë shërbim urdhërdhënësi i detyrohet përfaqësuesit tregtar t'ia paguajë shpërblimin e caktuar. Me lidhjen e kontratës për përfaqësim tregtar themelohen dy lloje të marrëdhënieve juridike, edhe atë:

- Marrëdhënia juridike në mes përfaqësuesit dhe urdhërdhënësit gjegjësisht të përfaqësuarit; dhe
- Marrëdhënia juridike në mes përfaqësuesit dhe personave të tretë me të cilët përfaqësuesi ka lidhur kontratë në emër dhe llogari të urdhërdhënësit gjegjësisht të përfaqësuarit.<sup>141</sup>

Për dallim nga kontrata e përfaqësimit, ku si përfaqësues mund të paraqitet çdo person fizik apo juridik, në kontratën e përfaqësimit tregtar si përfaqësues tregtar mund të jetë vetëm një entitet ligjor apo person fizik i cili në mënyrë të pavarur dhe me qëllim të realizimit të fitimit kryen aktivitete të përfaqësimit si një aktivitet i regjistruar.<sup>142</sup>

Ligjvënësi e ka cekur në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve nocionin e kësaj kontrate ku ceket që me kontratën mbi përfaqësimin tregtar, përfaqësuesi obligohet të kujdeset vazhdimisht që persona të tretë të lidhin kontrata me urdhërdhënësin e tij, dhe që për këtë të ndërmjetësojë midis tyre dhe urdhërdhënësit, si dhe që pas marrjes së autorizimit të lidhë kontrata me persona të tretë në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit, ndërsa ky obligohet

---

<sup>141</sup> Jashari, A. (2016, fq. 136). *E drejta afariste (kontraktore)*. Tetovë.

<sup>142</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 804.

që për çdo kontratë të lidhur t'i paguajë shpërblim të caktuar.<sup>143</sup> Në qoftë se e vërejmë me kujdes nocionin e kontratës të dhënë, arrijmë në konkludim që në këtë pjesë ligjvënësi nuk bënë dallim të qartë ndërmjet përfaqësimit tregtar dhe ndërmjetësimit tregtar. Mund të nënkuptohet, që ligjvënësi e ka cekur në këtë mënyrë për shkak të ngjashmërive që ekzistojnë ndërmjet këtyre dy llojeve të kontratave, veçanërisht për faktin që shpeshherë përfaqësuesi tregtar gjegjësisht agjenti tregtar paraqitet edhe si ndërmjetësues për lidhjen e kontratave ndërmjet urdhërdhënësit dhe personave të tretë. Por është me rëndësi të kuptohet që te përfaqësimi tregtar, përfaqësuesi tregtar vepron në emër dhe llogari të urdhërdhënësit ndërsa te ndërmjetësimi tregtar, ndërmjetësuesi vetëm i vë palët në lidhje të cilat më pas vetë e lidhin kontratën.<sup>144</sup>

### 5.1. Forma dhe lidhja e kontratës të përfaqësimit tregtar

Për sa i përket formës të kësaj kontrate, secila palë mund të kërkojë që të hartohet një dokument mbi përmbajtjen e kontratës, duke përfshirë të gjitha ndryshimet më të fundit, dhe që të nënshkruhet nga pala tjetër.<sup>145</sup> Nga kjo kuptojmë se nuk vërehet qartësisht se a kemi të bëjmë me kontratën e përfaqësimit si kontratë formale apo jo, por është lënë mundësia që secila palë të kërkojë hartimin e kontratës. Kjo nënkupton që kontrata do të jetë e vlefshme, edhe nëse nuk është ekzekutuar në një formë të caktuar. Është gjithashtu për tu cekur, që ligjvënësi e favorizon formën shkresore në bazë të këtij ligji, për arsye se ky lloj i formës u sjell palëve siguri, pasi që në rast të kontestit mes palëve, ata mundet që t'i referohen kontratës në formë shkresore, si dhe të përdoret para gjykatës. Palët kontraktuese gjithashtu mund të merren vesh që forma e shkruar të jetë kusht për vlefshmërinë e kontratës dhe ndryshimeve në të.<sup>146</sup> Në këtë mënyrë palët vetë mund të vendosin formën e shkruar për lidhjen e kontratës si kusht për vlefshmërinë e kontratës, në mënyrë që nëse forma e shkruar mungon, do të çojë në pavlefshmërinë e kontratës së përfaqësimit tregtar.

---

<sup>143</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 804, paragrafi 1.

<sup>144</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 431). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>145</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 805, paragrafi 1.

<sup>146</sup> Po aty, neni 805, paragrafi 2.

### 5.1.1. Lidhja e kontratës në emër të urdhërdhënësit

Në mënyrë që përfaqësuesi tregtar të lidh kontratën me personat e tretë në emër të urdhërdhënësit, ai duhet të ketë marrë autorizimin për këtë.<sup>147</sup> Autorizimi në këtë kontratë mund të jetë i përgjithshëm apo i veçantë duke e marrë parasysh llojin e punëve juridike që përfaqësuesi tregtar duhet t'i kryejë në emër dhe llogari të urdhërdhënësit. Siç dihet, qëllimi i kësaj kontrate është lidhja e kontratave në emër dhe llogari të urdhërdhënësit, rrjedhimisht kuptojmë se për të qenë të vlefshme këto kontrata të lidhura në mes përfaqësuesit tregtar gjegjësisht agjentit tregtar me personin e tretë, përfaqësuesi duhet të ketë marrë autorizimin e përgjithshëm ose të veçantë nga urdhërdhënësi gjegjësisht i përfaqësuar.

### 5.2. Lloji i përfaqësimit tregtar

Ekzistojnë disa lloje të ndryshme të përfaqësimit tregtar, por ndarja tradicionale dhe më e rëndësishme nga ndarjet tjera, është si në vijim:

- Përfaqësimi në qarkullim e brendshëm; dhe
- Përfaqësimi në qarkullimin e jashtëm.

Në bazë të kriterit për ndarjen e llojeve të përfaqësimit, kemi edhe ndarje të ndryshme të llojit të përfaqësimit tregtar. Në bazë të territorit ku përfaqësuesi e ushtron veprimtarinë, dallojmë llojet në vijim:

- Përfaqësimin lokal, që nënkuptojmë rastin ku përfaqësuesi është i autorizuar vetëm për një njësi gjeografike dhe rrethinën e saj; dhe
- Përfaqësimin gjeneral, që nënkuptojmë rastin ku përfaqësuesi është i autorizuar nga një ose më tepër kompani për të përfaqësuar në një territor, një shtet apo kontinent.<sup>148</sup>

Në bazë të autorizimeve që përfaqësuesi tregtar ka përmes kontratës së përfaqësimit, dallojmë:

- Përfaqësimin e veçantë apo special, ku përfaqësuesi është i autorizuar në emër dhe llogari të urdhërdhënësit të lidh apo të realizojë një ose disa punë juridike; dhe
- Përfaqësimin gjeneral apo të përgjithshëm, ku përfaqësuesi është i autorizuar të kryej ose të realizojë të gjitha punët juridike.

---

<sup>147</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 806.

<sup>148</sup> Jashari, A. (2016, fq. 138). *E drejta afariste (kontraktore)*. Tetovë.

Në bazë të vëllimit të përgjegjësive së përfaqësuesit tregtar në lidhje me atë se personi i tretë me vetëdije do të realizojë punën juridike të lidhur në emër dhe llogari të urdhërdhënësit, dallojmë:

- Përfaqësimin e thjeshtë, ku përfaqësuesi tregtar përgjigjet vetëm për pandërgjegjshmërinë eventuale në pikëpamje të zgjedhjes së personit të tretë me të cilin ka lidhur kontratë; dhe
- Përfaqësimin *del credere*, ku përfaqësuesi tregtar garanton se personi i tretë me ndershmëri do të realizojë obligimet e tij nga kontrata e lidhur.<sup>149</sup>

### 5.3. Pranimi i përmbushjes

Kontrata për përfaqësimin tregtar nuk nënkupton që përfaqësuesi tregtar si përfaqësues i urdhërdhënësit, të mund të kërkojë ose të pranojë përmbushjen e kërkesave për urdhërdhënësin. Ai përmes kontratës për përfaqësimin tregtar, i kryen një rreth të gjerë ose të ngushtë të punëve në emër dhe llogari të urdhërdhënësit. Për përmbushjen e kërkesave për urdhërdhënësin, ligjvënësi e ka paraparë që për këtë përfaqësuesi tregtar të ketë autorizim të posaçëm.<sup>150</sup> Në mënyrë që të mbrohet interesi i urdhërdhënësit dhe gjithashtu i personit të tretë me të cilin lidh kontratë përfaqësuesi tregtar, ligjvënësi kategorikisht e ka cekur që për këtë nevojitet autorizim i posaçëm. Përfaqësuesi tregtar është i lidhur ngushtë me autorizimin që ia ka dhënë urdhërdhënësi. Kështu që pa aprovim të veçantë nuk mundet që në vend të një përmbushje të pranojë një përmbushje tjetër me të cilën do ta zëvendësonte të parën, ose me të cilën do ta këmbente përmbushjen e autorizuar me një lëndë tjetër të dorëzuar. Si dhe pa miratim paraprak të urdhërdhënësit, përfaqësuesi tregtar, nuk mund të shtyjë pranimin e përmbushjes.<sup>151</sup>

### 5.4. Pranimi dhe ekzekutimi i deklaratave

Përfaqësuesit tregtar i nevojitet të posedojë autorizim të posaçëm gjegjësisht të veçantë për adresimin e disa situatave që janë të ndjeshme për urdhërdhënësin. Por me qëllim të mbrojtjes së interesit të personit të tretë, neni 808 i LMD-së e lejon që përfaqësuesi tregtar, të pranojë deklarata të caktuara të cilat kanë të bëjnë me çështjet rreth të metave të

<sup>149</sup> Jashari, A. (2016, fq. 139). *E drejta afariste (kontraktore)*. Tetovë.

<sup>150</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 807.

<sup>151</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 434). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

objektit të kontratës ose deklarata të tjera, lidhur me këtë kontratë me qëllim të ushtrimit ose të ruajtjes të drejtave nga kontrata.<sup>152</sup> Domethënë për pranimin e deklarata të tilla, nuk nevojitet autorizim i veçantë nga urdhërdhënësi dhe ky pranim i deklaratave nga ana e përfaqësuesit tregtar shihet si thelbësore për sigurimin e një shkalle të sigurisë, në marrëdhënien kontraktuale me personin e tretë. Si deklarata të këtij lloji të cilat pala e tretë mund t'ia drejtojë në mënyrë të drejtpërdrejtë përfaqësuesit tregtar dhe që ato menjëherë të prodhojnë efekt juridik për urdhërdhënësin, pa pasur nevojë që urdhërdhënësi të jap miratim të veçantë janë si p.sh. njoftimi për të metat materiale të sendit, njoftimi për të metat juridike të sendit, njoftimi ose kundërshtimi i sasisë ose cilësisë së mallit të dorëzuar, protestat rreth paketimit dhe transportimit të mallit, njoftimi në lidhje me ushtrimin e të drejtës së mbajtjes, deklarata për kundërshtimin për mos përmbushje të kontratës ose deklarata për përmbushje të padrejtë të kontratës, si dhe të tjera.<sup>153</sup>

Përfaqësuesi tregtar është po ashtu i autorizuar që me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të urdhërdhënësit, të bëjë deklarata të nevojshme bashkëkontraktuesit të tij.<sup>154</sup> Përfaqësuesi tregtar pa pëlqim të veçantë të urdhërdhënësit, mund të ekzekutojë deklarata ose të përdorë kundërshtime ndaj palës së tretë me të cilën është lidhur kontrata, me qëllim të mbrojtjes dhe realizimit të drejtave të urdhërdhënësit. Përderisa më lartë është trajtuar mundësia që deklaratat ose kundërshtimet nga pala e tretë, dhe të drejtuara përfaqësuesit tregtar të prodhojnë efekt të drejtpërdrejtë për urdhërdhënësin, në LMD është paraparë po ashtu që përfaqësuesi tregtar, pa pasur nevojë sigurimin e pëlqimit të veçantë, të mund të ekzekutojë deklarata apo kundërshtime për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të urdhërdhënësit.<sup>155</sup>

## 5.5. Masat e sigurimit

Sikur të kontrata e përfaqësimit, ashtu edhe përfaqësuesi tregtar të kontrata e përfaqësimi tregtar duhet të veprojë me kujdesin e ekonomistit dhe profesionistit të mirë. Kështu që me qëllim të mbrojtjes së interesave të urdhërdhënësit, përfaqësuesi tregtar mund

---

<sup>152</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 808.

<sup>153</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 434-435). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>154</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 809.

<sup>155</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 435). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

të kërkojë marrjen e masave të nevojshme të sigurimit.<sup>156</sup> Përmes kësaj, i lejohej përfaqësuesit tregtar ndërmarrja e masave të nevojshme të sigurimit, në mënyrë që më së miri të mbrojë interesat e urdhërdhënësit. Ligjvënësi nuk kërkon ndonjë autorizim të veçantë për përfaqësuesin tregtar që të mund t'i ndërmarrë masat e nevojshme të sigurimit. Kur flitet për masat e nevojshme të sigurimit që përfaqësuesi tregtar mund t'i ndërmarrë, mendohet për masa të veçanta të sigurimit, të cilat nuk janë dakorduar në mes palëve gjatë lidhjes së kontratës, por të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e interesit të urdhërdhënësit. Një nga masat e nevojshme të sigurimit që përfaqësuesi tregtar mund të ndërmarrë është ushtrimi i të drejtës së mbajtjes për interesin e urdhërdhënësit në raport me palën e tretë, sepse përndryshe mosndërmarrja e tyre do t'i dëmtonte interesat e urdhërdhënësit. Një masë tjetër është edhe ushtrimi i të drejtës ligjore të pengut për mbrojtjen e interesave të urdhërdhënësit në kontratën e përfaqësimit tregtar. Pavarësisht që ky nen ia jep përfaqësuesit tregtar të drejtën të ndërmarrë masat e nevojshme të sigurimit për ekzekutimin e kontratave që ai i lidh me personat e tretë, në disa raste kërkohet pëlqimi gjegjësisht miratimi i veçantë nga urdhërdhënësi. Masat e tilla të veçanta për të cilat kërkohet pëlqimi i urdhërdhënësit mund të jenë si kontraktimi i kaparit, paradhënies, kushtit penal dhe masat e tjera të ngjashme.<sup>157</sup>

## 5.6. Efektet juridike të kontratës të përfaqësimit tregtar

Kontrata për përfaqësimin tregtar është kontratë e dyanshme ngarkuese, në bazë të së cilës lindin të drejta dhe detyrime reciproke për palët kontraktuese, gjegjësisht për përfaqësuesin tregtar dhe urdhërdhënësin.

### 5.6.1. Detyrimet e përfaqësuesit tregtar

Përfaqësuesi tregtar ka disa detyrime të caktuara ndaj urdhërdhënësit. Detyrimet themelore të përfaqësuesit tregtar janë:

- Përkujdesja për interesat e urdhërdhënësit;
- Të informoj dhe raportoj urdhërdhënësin;
- Pjesëmarrja në kontraktimin e punëve;

---

<sup>156</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 810.

<sup>157</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 436). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

- Ruajtja e sekreteve të punës; dhe
- Kthimi i sendeve të dhëna në përdorim.

Përfaqësuesi tregtar ka për detyrë të kujdeset për interesat e urdhërdhënësit dhe në të gjitha punët që ndërmerr ka për detyrë të veprojë me kujdesin e ekonomistit të mirë.<sup>158</sup> Përfaqësuesi tregtar gjatë kryerjes së punëve, pikë së pari ka për qëllim dhe detyrim të ekzekutojë punët dhe veprimet e dhëna nga udhëzimet e urdhërdhënësit. Përfaqësuesi tregtar që gjatë çdo aktiviteti të përfaqësimit, duhet të mbrojë interesin më të mirë të urdhërdhënësit. Ai duhet të ekzekutojë edhe disa veprime përkatëse, që janë përtej miratimit përkatës nga urdhërdhënësi, nëse ndërmarrja e tyre është në funksion të mbrojtjes të interesit të urdhërdhënësit. Me ekonomist të mirë nënkuptojmë sjelljen e një ndërmarrësi gjegjësisht një profesionisti veçanërisht të kujdesshëm. Ky standard i ekonomistit të mirë mund të konstitujë përgjegjësinë e agentit edhe për lëshimet më të vogla në zbatimin e urdhrave ose të mbrojtjes së interesave të urdhërdhënësit, lëshime këto që parimisht një ekonomist i mirë nuk do të duhet t'i lejonte.<sup>159</sup> Përfaqësuesi tregtar gjatë përfaqësimit, duhet të ju përmbahet udhëzimeve të dhëna nga urdhërdhënësi.<sup>160</sup> Varësisht nga karakteri detyrues i urdhrit gjegjësisht udhëzimeve të dhëna nga urdhërdhënësi, pushteti që i ka kaluar përfaqësuesit tregtar dhe mundësia e veprimit ndryshon si p.sh. në rastin e urdhrit imperativ, është detyrë e përfaqësuesit tregtar vetëm t'i përmbahet përmbajtjes së urdhrit. Mirëpo, nëse përfaqësuesi tregtar gjegjësisht agjenti vepron jashtë përmbajtjes së urdhrit, do të konsiderohet që përfaqësuesi tregtar ka tejkalar autorizimin. Por siç është diskutuar te tejkalimi i autorizimit, urdhërdhënësi mund të lejojë konvalidimin e kontratës në rastet kur e jep pëlqimin e tij dhe e pranon tejkalimin e autorizimit. Pëlqimi në lidhje me tejkalimin e autorizimit duhet të jetë specifik dhe t'i referohet saktësisht situatës përkatëse.<sup>161</sup> Nga përkujdesja për interesat e urdhërdhënësit, si detyrim mund të nxirret që përfaqësuesi tregtar duhet ta pajisë me njoftime të nevojshme për situatën në treg, ose t'i sigurojë informata që janë me rëndësi për kryerjen e punëve që lidhen me autorizimin e dhënë, përndryshe urdhërdhënësi nuk do ta kishte të mundur të çmonte situatën përkatëse në të

<sup>158</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 811, paragrafi 1.

<sup>159</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 437-438). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>160</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 811, paragrafi 2.

<sup>161</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 438). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.



cilën ndodhet përfaqësuesi tregtar. Kuptohet që gjatë kryerjes së punëve të besuara nga urdhërdhënësi dhe të përfshira në autorizimin e dhënë, përfaqësuesi tregtar duhet tu përmbahet urdhrit dhe udhëzimeve, por ai megjithatë përkuqdeset edhe për interesin e urdhërdhënësit. Kështu që i lejohet përfaqësuesit tregtar, që nëse një veprim përkatës nuk është në interesin më të mirë të urdhërdhënësit, edhe përkundrazi faktit që urdhërdhënësi ka kërkuar ndërmarrjen e atij veprimit, përfaqësuesi tregtar duhet të njoftojë urdhërdhënësit dhe të kërkojë udhëzime shtesë. Nëse edhe pas njoftimit, urdhërdhënësi kërkon përmbushjen e veprimit, atëherë përfaqësuesi tregtar duhet t'i përmbahet urdhrit gjegjësisht udhëzimit të dhënë nga urdhërdhënësi.<sup>162</sup>

Si detyrim tjetër të cilin e ka përfaqësuesi tregtar është informimi dhe raportimi. Përfaqësuesi tregtar përgjatë kryerjes së punëve të caktuara juridike duhet t'i ofrojë urdhërdhënësit të gjitha informatat e nevojshme mbi situatën e tregut, veçanërisht informatat për secilën punë juridike të kryer.<sup>163</sup> Ky detyrim është i rëndësishëm për arsye se përfaqësuesi tregtar gjegjësisht agjenti vepron shpeshherë në tregje ose situata që janë të panjohura për urdhërdhënësin ose vepron me persona të cilët urdhërdhënësi nuk i njeh mirë ose nuk i njeh aspak, kështu që përmes informimit nga ana e përfaqësuesit tregtar, urdhërdhënësit i mundësohet të japë ose të ndryshojë udhëzimet që i drejtohen përfaqësuesit tregtar në lidhje me përfaqësimin. Përveç njoftimit për situatat dhe kushtet e tregut, si dhe personat me të cilët hynë në marrëdhënie përfaqësuesi tregtar, ai e ka për detyrë të njoftojë urdhërdhënësin edhe për rezultatet dhe gjendjen e punëve juridike.<sup>164</sup> Përfaqësuesi tregtar duhet t'i japë llogari gjegjësisht t'i paraqes raport për punët juridike të kryera, punët juridike në procedim, si dhe të raportojë mbi personat e tretë, që kanë shprehur vullnetin për negociim dhe lidhje të kontratës me urdhërdhënësin.<sup>165</sup> Ky raportim mund të jetë i kohëpaskohshëm, periodik, ose të bëhet sipas fazave paraprakisht të përcaktuara nga përfaqësuesi tregtar dhe urdhërdhënësi në kontratën e përfaqësimit tregtar. Raportimi dhe informimi paraqet një detyrim imperativ me atë që çfarëdo marrëveshje apo

---

<sup>162</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 439). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>163</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 812, paragrafi 1.

<sup>164</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 439). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>165</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 812, paragrafi 2.

kusht të veçantë në marrëveshje që do të ishte në kundërshtim me detyrimin e informimit dhe raportimit, do të jetë të pavlefshme dhe nuk do të prodhojnë efekte juridike.<sup>166</sup>

Detyrimi i tretë që e ka përfaqësuesi tregtar ndaj urdhërdhënësit është pjesëmarrja në kontraktimin e punëve.<sup>167</sup> Përfaqësuesi tregtar ka për detyrë t'i kryejë punët e caktuar dhe t'i ndërmarrë veprimet juridike në emër dhe llogari të urdhërdhënësit. Këto punë duhet të kryhen në mënyrën që palët kontraktuese janë marrë vesh në kontratën e përfaqësimit tregtar, ose në mënyrën e paraparë në udhëzimet e urdhërdhënësit. Përfaqësuesi tregtar duhet të kujdeset gjatë kryerjes së veprimeve juridike, lidhjes së kontratës, përkujdesjen për përmbylljen e efekteve kontraktuese dhe deri kur puna juridike të përmbillet dhe rezultatet e punës t'i kalojnë urdhërdhënësit. Është e kuptueshme se nga momenti i parë kur lidhet kontrata për përfaqësim tregtar e deri në përmbylljen e detyrimeve të përfaqësuesit gjegjësisht agentit tregtar, përfaqësuesi tregtar vazhdon të pranojë udhëzime të reja nga urdhërdhënësi.<sup>168</sup>

Përfaqësuesi tregtar ka edhe për detyrë t'i ruajë sekretet e punës të urdhërdhënësit për të cilat ka mësuar lidhur me punën që i është besuar, si dhe ai përgjigjet po që se i shfrytëzon ose ia zbulon tjetrit edhe pas pushimit të kontratës.<sup>169</sup> Kontrata për përfaqësim tregtar lidhet me agjentë gjegjësisht përfaqësues tregtar që kanë reputacion dhe e fitojnë besimin e urdhërdhënësit, për arsye se përfaqësuesit gjatë kryerjes së veprimeve të caktuara mësojnë informata konfidenciale. Prandaj, është detyrim thelbësor i agentit që të ruajë sekretet afariste dhe informatat konfidenciale, të cilat i ka mësuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së përfaqësimit. Gjatë ofrimit të shërbimeve të përfaqësimit, përfaqësuesi tregtar ka edhe një klientelë tjetër për të cilën paraqitet si përfaqësues tregtar. Duke e marrë parasysh këtë, përfaqësuesi tregtar duhet të përmbahet nga situatat e përdorimit, në interesin e tij ose personit të tretë, të informatave të mësuara nga urdhërdhënësi gjatë kryerjes së veprimeve juridike në emër dhe llogari të tij. Është më se e rëndësishme të merret parasysh që ruajtja e sekretit të punës, vlen edhe pas përfundimit të marrëdhënies së përfaqësimit. Edhe pse ligjvënësi nuk e ka përcaktuar një afat të zgjatjes së këtij detyrimi, një numër i madh i autorëve

---

<sup>166</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 440). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>167</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 813.

<sup>168</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 441). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>169</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 814.

mendojnë se ky detyrim për të ruajtur informatat konfidenciale vazhdon të jetë i detyrueshëm për aq kohë sa këto informata kanë në përmbajtjen e tyre rëndësinë e ruajtjes së tyre si fshehtësi afariste.<sup>170</sup>

Detyrimi i fundit themelor i përfaqësuesit tregtar është kthimi i sendeve të dhëna në përdorim. Është e kuptueshme që pas pushimit të kontratës së përfaqësimit tregtar, përfaqësuesi tregtar është i detyruar t'i kthejë urdhërdhënësit të gjitha sendet që ia ka dorëzuar ky për përdorim gjatë afatit të kontratës.<sup>171</sup> Sapo të përmbillet marrëdhënia e krijuar me kontratën e përfaqësimit në mes përfaqësuesit tregtar dhe urdhërdhënësit, përfaqësuesi tregtar është i detyruar që urdhërdhënësit t'ia kthejë të gjitha sendet, të cilat i ka marrë në posedim ose përdorim gjatë kryerjes së punëve juridike në emër dhe llogari të urdhërdhënësit. Këto sende mund të jetë mostrat, materialet reklamuese, mjetet ose pajisjet teknike të përdorura në lidhje me përfaqësimin si dhe sende të tjera që ndërlidhen me marrëdhënien e përfaqësimit.<sup>172</sup>

#### 5.6.2. Detyrimet e urdhërdhënësit

Në bazë të ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, urdhërdhënësi ka disa detyrime të caktuara ndaj përfaqësuesit tregtar. Detyrimet themelore të përfaqësuesit tregtar janë:

- Veprimi me sinqeritet dhe mirëbesim;
- Dhënia e dokumentacionit të nevojshëm;
- Njoftimi i përfaqësuesit tregtar;
- Pagesa e shpërblimit; dhe
- Pagesa e shpenzimeve.

Një nga detyrimet e rëndësishme që urdhërdhënësi e ka ndaj përfaqësuesit tregtar, është që të veproj me sinqeritet dhe mirëbesim.<sup>173</sup> Kjo nënkupton që urdhërdhënësi duhet të përmbahet nga veprimet ose mosveprimet, të cilat do ta vendosin përfaqësuesin tregtar gjegjësisht agentin në një pozitë të papërshtatshme, që mund të kuptohet si veprim me keqbesim i urdhërdhënësit. Gjithashtu urdhërdhënësi në bazë të këtij detyrimi, duhet të

---

<sup>170</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 441-442). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>171</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 815.

<sup>172</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 442). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>173</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 817, paragrafi 1.

pajisë përfaqësuesin tregtar me të gjitha informatat relevante, të cilat do t'i mundësonte një vlerësim më të përshtatshëm për kryerjen e veprimeve të përfaqësimit, në interesin e urdhërdhënësit me më pak shpenzime ose ngarkesa.<sup>174</sup>

Detyrimi tjetër i urdhërdhënësit ka të bëjë me dhënien e dokumentacionit ose materialit të nevojshëm, që përfaqësuesit tregtar i nevojiten që të kryejë veprimtarinë e përfaqësimit me sukses. Urdhërdhënësi duhet t'i ofrojë përfaqësuesit tregtar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, shembujt, planet, listat e çmimeve, materialet reklamuese, rregullat dhe kushtet e përgjithshme të biznesit, si dhe dokumentacion tjetër të ngjashëm, që është i nevojshëm për kryerjen me sukses të veprimtarisë së përfaqësimit.<sup>175</sup> Nga e gjithë kjo lind pyetja, çka do të ndodh nëse urdhërdhënësi nuk e përmbush këtë detyrim? Kuptohet që nëse mos përmbushja e këtij obligimit të urdhërdhënësit është esenciale në ekzekutimin me sukses të punëve të përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit tregtar, kjo do të paraqiste shkelje të detyrimeve kontraktuale të urdhërdhënësit, duke i mundësuar përfaqësuesit tregtar të kërkojë zgjidhjen e kontratës, dhe në qoftë se përfaqësuesi tregtar ka pësuar dëm si pasojë e mos përmbushjes së këtij detyrimi, atëherë do të duhet që urdhërdhënësi të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Ky dokumentacion ose material i nevojshëm edhe pas dorëzimit të përfaqësuesit tregtar, do të vazhdojë të ngelë në pronësinë e urdhërdhënësit, megjithatë përfaqësuesi tregtar i mban dhe përdorë ato me mirëbesim përgjatë kohës së përfaqësimit. Pasi që detyrë e përfaqësuesit tregtar është t'i kryejë punët juridike në emër dhe llogari të urdhërdhënësit, urdhërdhënësi duhet të pajisë përfaqësuesin tregtar me informata të nevojshme dhe relevante për kryerjen e punëve. Duhet të ceket që përfaqësuesi gjegjësisht agjenti tregtar nuk mban përgjegjësi nëse lëshimet ose dëmet e shkaktuara gjatë përfaqësimit rrjedhin si pasojë e keqinformimit ose për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm.<sup>176</sup>

Detyrim tjetër themelor për urdhërdhënësin është informimi i përfaqësuesit tregtar. Urdhërdhënësi mundet sipas dëshirës së vet të pranojë ose të refuzojë lidhjen e kontratës së përgatitur nga ana e përfaqësuesit tregtar, por ka për detyrë të njoftojë pa vonesë përfaqësuesin tregtar mbi vendimin e vet. Kuptohet që urdhërdhënësi duhet të njoftojë

---

<sup>174</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 444). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>175</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 817, paragrafi 2.

<sup>176</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 445). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

përfaqësuesin në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e punëve të kontraktuara me personat e tretë.<sup>177</sup> E drejta diskrecionale e urdhërdhënësit shfaqet në këtë detyrim, ku ai mund që të pranojë ose mos pranojë lidhjen e kontratave të përgatitura nga agjenti tregtar, por me kusht që agjentin ta njoftojë në kohë. Urdhërdhënësi është përgjegjës në rastin kur e neglizhon detyrimin ose nëse dështon të informojë agjentin në lidhje me vendimin e vet. Në qoftë se urdhërdhënësi e neglizhon këtë detyrim, dhe si pasojë e kësaj përfaqësuesi tregtar pëson shpenzime shtesë ose ndonjë dëm, atëherë përfaqësuesi tregtar mund të kërkojë shpërblimin e dëmit nga ana e urdhërdhënësit.<sup>178</sup>

Pagesa e shpërblimit është detyrim po ashtu i urdhërdhënësit, i cili duhet t'i paguajë përfaqësuesit tregtar një shpërblim të caktuar për punën e kryer.<sup>179</sup> Duke e marrë parasysh se kontrata e përfaqësimit tregtar është kontratë me shpërblim, urdhërdhënësi është i obliguar që përfaqësuesit tregtar t'ia paguajë shpërblimin përkatës. Ky shpërblim paguhet si kompensim për punën e kryer nga ana e përfaqësuesit tregtar. Ky detyrim vlen sikur në rastet që përfaqësuesi tregtar e ka lidhur kontratën tregtare në emër dhe llogari të urdhërdhënësi, por gjithashtu edhe në rastet kur përfaqësuesi tregtar ka bërë vetëm ndërmjetësimin në mes personit të tretë që ka shpreh interesim për të lidh kontratën dhe urdhërdhënësit. Duhet të merret parasysh se ky detyrim vlen edhe në rastet kur ndërmjetësimi për lidhjen e kontratës ose vetë lidhja e kontratës nga ana e përfaqësuesit tregtar ka dështuar për rrethanat për të cilat përgjegjës është urdhërdhënësi dhe jo përfaqësuesi tregtar. Në rastet kur urdhërdhënësi dhe përfaqësuesi tregtar janë marrë vesh që përfaqësimi në kuadër të një fushe të caktuar të punëve të bëhet vetëm përmes agjentit tregtar, atëherë edhe në rastet kur agjenti tregtar nuk ka ndërmjetësuar ose nuk e ka lidhur vetë kontratën me personin e tretë, ai ka të drejtën e pagesës së shpërblimit për shkak përfaqësimit ekskluziv.<sup>180</sup> Me rëndësi është të kuptohet edhe si përcaktohet shuma e shpërblimit që i takon përfaqësuesit tregtar. Shuma e shpërblimit parimisht përcaktohet me kontratën për përfaqësimin tregtar ose përmes tarifës së punës të përfaqësuesit tregtar. Në qoftë se nuk është cekur kjo shumë në kontratë, atëherë duhet të merren në konsideratë doket tregtare të vendit.<sup>181</sup> Nëse paraqiten raste ku shuma

---

<sup>177</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 818, paragrafi 1.

<sup>178</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 446). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>179</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 820, paragrafi 1.

<sup>180</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 448). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>181</sup> Po aty, fq. 449.

është e pamundur të përcaktohet sipas mënyrës të cekur më lartë, atëherë ligjvënësi e ka paraparë që përfaqësuesi tregtar ka të drejtë provizioni në një shumë që i merr parasysht të gjitha rrethanat e punës së kryer, veçanërisht numrin dhe vlerën e punëve juridike të kryera ndërmjet urdhërdhënësit dhe personit të tretë, si dhe natyrën dhe vështirësinë e përpjekjeve të përfaqësuesit tregtar.<sup>182</sup>

Përveç pagesës së shpenzimeve, është i paraparë edhe shpërblimi i veçantë për përfaqësuesin tregtar. Përfaqësuesi tregtar i cili me autorizimin e urdhërdhënësit, ka bërë arkëtimin e ndonjë kërkesë të tij, ka të drejtë në provizion të veçantë nga shuma e arkëtuar.<sup>183</sup> Me shpërblim të veçantë që ndryshe quhet edhe tarifa për arkëtim, kuptojmë formën shtesë të provizionit e cila i do t'i takojë përfaqësuesit tregtar si pjesë e rritur e shpërblimit bazë në rastet kur ai arkëton ndonjë kërkesë të urdhërdhënësit. Kuptohet se ky shpërblim i veçantë do t'i takojë përfaqësuesit tregtar, nëse arkëtimi i kërkesave të urdhërdhënësit është përtej asaj që ka qenë objekt i marrëveshjes fillestare të përfaqësimit, që është paraparë në kontratën e përfaqësimit tregtar. Mbi atë se kur i takon përfaqësuesit ky shpërblim, disa nga këto autorë mendojnë se rast tipik është rasti kur agjenti ka shërbyer vetëm si ndërmjetësues ndërmjet urdhërdhënësit dhe personit të tretë, pa pasur të drejtë të lidhë kontratën në emër dhe llogari të urdhërdhënësit. Ashtu që nëse agjenti, me një autorizim të posaçëm të dhënë nga urdhërdhënësi, fiton lejen të arkëtojë diçka për llogarinë e urdhërdhënësit, atëherë atij do t'i takojë ky shpërblim shtesë apo i veçantë. Në këtë rast mendohet se kur agjenti që në fillim ka qenë i autorizuar të ndërmarrë të gjitha veprimet e përfaqësimit, duke e përfshirë edhe lidhjen e kontratave në emër të urdhërdhënësit, në raste të tilla konsiderohet se agjenti nuk do të kishte të drejtë në provizion shtesë, gjegjësisht nuk do të kishte të drejtë në shpërblimin e veçantë. Sipas tyre, kjo e drejtë nuk i takon përfaqësuesit tregtar në këto raste, për arsye se arkëtimi në emër dhe llogari të urdhërdhënësit konsiderohet që hyn në kuptimin e rregullt të marrëdhënies së përfaqësimit, që ka lindur me lidhjen e kontratës së përfaqësimit në mes palëve kontraktuese.<sup>184</sup>

Si detyrim i fundit themelor për urdhërdhënësin është pagesa e shpenzimeve. Përfaqësuesi tregtar ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të veçanta që ka bërë në

---

<sup>182</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 821, paragrafi 2.

<sup>183</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 824.

<sup>184</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 454). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

dobi të urdhërdhënësit, ose me urdhër të tij, por nuk ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve që rezultojnë nga ushtrimi i zakonshëm i punëve të ndërmjetësimit, përveç nëse është kontraktuar ndryshe.<sup>185</sup> Ligjvënësi nuk ka dhënë definicionin ose çka mund të përfshihet në shpenzimet e zakonshme, që shihet se kjo barrë i ka ngelur praktikës gjyqësore. Në këtë drejtim si shpenzime të zakonshme mund të konsideroheshin shpenzimet që ndërlidhen me organizimin e zyrës, ofrimin e përditshëm të shërbimeve profesionale, shpenzimet postare, shpenzimet e telekomunikacionit, telegramet, shpenzimet për përdorimin e internetit dhe shpenzimet e tilla të ngjashme, të cilat përfshihen në kuptimin e rregullt të ushtrimit të profesionit të përfaqësimit. Megjithatë, nuk duhet harruar se gjatë kryerjes së urdhrave të urdhërdhënësit, agjenti ndonjëherë mund të veprojë edhe përtej përshkrimit ose kërkesave të urdhrit të urdhërdhënësit, kështu që përfaqësuesi tregtar mund t'i ekspozohet edhe shkaktimeve të shpenzimeve të jashtëzakonshme. Një rast i tillë mund të jetë kur përfaqësuesi tregtar vepron si punë drejtues pa porosi për urdhërdhënësin, ashtu që kryen veprime të caktuara në interes të urdhërdhënësit. Kuptohet që në raste të tilla kur dobitë pranohen nga urdhërdhënësi, ai ka për obligim mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara nga agjenti gjegjësisht përfaqësuesi tregtar. Po ashtu, në disa raste të tjera, përfaqësuesi tregtar gjatë kryerjes së urdhrave të urdhërdhënësi mund të has në shpenzime të paparashikuara si p.sh. në lidhje me ngarkesat doganore, sigurimin e licencave të ndryshme për kryerjes e urdhrave, si dhe shpenzime të tjera të ngjashme.<sup>186</sup> Këto shpenzime të paparashikuara duhet po ashtu të kompensohen nga urdhërdhënësi gjegjësisht i përfaqësuarit.

### 5.7. E drejta e pengut e përfaqësuesit tregtar

E drejta e pengut paraqitet një nga të drejtat që përfaqësuesi tregtar e posedon në kontratën e përfaqësimit tregtar. Me qëllim të sigurimit të kërkesave të përfaqësuesit tregtar, të cilat kanë arritur për pagesë, përfaqësuesi tregtar gëzon të drejtën e pengut mbi shumat që përfaqësuesi tregtar i ka arkëtuar nga personat e tretë, në emër dhe llogari të urdhërdhënësit, sipas autorizimit përkatës, përkatësisht ai gëzon të drejtën e pengut mbi të gjitha sendet e urdhërdhënësit të cilat lidhur me kontratën i ka marrë nga urdhërdhënësi ose nga ndonjë person tjetër, deri sa këto sende gjenden tek ai ose te ndonjë person tjetër, i cili i

---

<sup>185</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 825.

<sup>186</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 455). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

mban për përfaqësuesin tregtar, ose përderisa ai ka dokumentin me të cilin dëshmon që ai mund të disponojë me këto sende.<sup>187</sup>

Ky lloj i pengut i cili krijohet, njihet si i ashtuquajtur i peng posedimor, ashtu që agjenti e gëzon të drejtën e përparësisë së arkëtimit të kërkesave të tija të arritura para cilitdo kreditor të urdhërdhënësit. Për realizimin e të drejtës së pengut në këtë rast, zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtës së pengut.<sup>188</sup>

### 5.8. Shuarja e kontratës të përfaqësimit tregtar

Mënyra e shuarjes së kontratës është e ndryshme, varësisht a kemi të bëjmë me kontratë të lidhur për një kohë të pacaktuar apo për një kohë të caktuar. Nëse palët nuk merren vesh ndryshe, parimisht konsiderohet se kontrata e përfaqësimit tregtar është lidhur për një periudhë të pacaktuar.

Në rastet kur kontrata e përfaqësimit tregtar është e lidhur për një periudhë të pacaktuar, atëherë secila palë kontraktuese mund ta shkëpus kontratën duke dhënë njoftim paraprak. Afati për njoftim të cilët palët duhet ta respektojnë për shkëputjen e kontratës, ndryshon varësisht nga kohëzgjatja e kontratës dhe llogaritet nga një muaj për secilin fillim viti gjatë kontratës. Nëse kontrata e përfaqësimit tregtar zgjatë më shumë se pesë vite, atëherë koha e dhënies së njoftimit për shkëputje është gjashtë muaj. Gjithashtu duhet të merret parasysh se palët kontraktuese këtë afat të njoftimit nuk kanë të drejtë ta shkurtojnë, por ata kanë mundësi që të dakordohen në kontratë për një afat më të gjatë se sa ai i paraparë me ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.<sup>189</sup> Në qoftë se kontrata shuhet përmes dhënies së njoftimit për shkëputje, atëherë kontrata do të shuhet pasi të ketë kaluar me sukses afati i njoftimit.

Për sa i përket kontratës së përfaqësimit të lidhur për një kohë të caktuar, atëherë kjo kontratë do të shuhet me skadimin e kohës së caktuar në kontratë nga palët kontraktuese. Në këtë lloj të kontratës, nuk nevojitet të jepet njoftimi nga njëra palë për shkëputje, por do të shuhet në mënyrë automatike me vetë skadimin e kohës së përcaktuar. Në rastet kur edhe me skadimin e afatit të përcaktuar me kontratë, palët kontraktuese vazhdojnë akoma të përmbushin kontratën, atëherë konsiderohet si kontratë që është lidhur për një kohë të

<sup>187</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 826.

<sup>188</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 456). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>189</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 827.



pacaktuar.<sup>190</sup> Me këtë nënkuptojnë, se nëse përfaqësuesi tregtar edhe pas skadimit të kohës të përcaktuar me kontratë vazhdon të kryejë veprimtarinë e përfaqësimit në emër dhe llogari të urdhërdhënësit dhe kryen punët juridike të besuara, ndërsa po ashtu edhe urdhërdhënësi i pranon këto punë dhe e përmbush detyrimin e tij ndaj përfaqësuesit tregtar të pagesës së shpërblimit, atëherë siç e ka paraparë edhe ligjvënësi, kjo kontratë do të llogaritet sikur të kishte qenë e lidhur për një periudhë kohore të pacaktuar.

Si një mënyrë tjetër e shuarjes së kontratës së përfaqësimit, pa marrë parasysh a është lidhur kontrata për një periudhë të pacaktuar apo për një kohë të caktuar, është zgjidhja e kontratës pa afat denoncimi. Me këtë nënkuptojmë, se secila palë kontraktuese ka të drejtën të shkëpusë kontratën e përfaqësimit tregtar pa afat denoncimi në qoftë se paraqiten shkaqe serioze për shkëputje.<sup>191</sup> Ligjvënësi nuk e ka shtjelluar se çka nënkuptohet me shkaqe serioze, kështu që praktikës gjyqësore i ka ngelur që të definojë se çka mund të quhet si shkak serioz që do të shtyjë palën të shkëpusë kontratën pa afat denoncimi. Praktika gjyqësore i vlerëson rrethanat e rastit të dhënë, duke i pasur në konsideratë edhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktuese, si p.sh. një rast i shkeljes serioze të detyrimeve kontraktuese do të ishte kur njëra palë nuk i përmbush detyrimet e saja kontraktuese brenda afatit të dhënë ose në mënyrën e duhur, rrethana të cilat do t'i mundësonin palës tjetër deklarin e zgjidhjes së kontratës pa afat denoncimi.<sup>192</sup> Në qoftë se deklarata mbi denoncimin është bërë në mungesë të shkaqeve serioze, atëherë kjo deklaratë do të konsiderohet si denoncim me afat të rregullt. Me këtë nënkuptojmë, se kontrata do të shkëputet pas kalimit të afatit të njoftimit, gjegjësisht të dhënies së deklaratës për shkëputje, në mënyrën që parashihet për shuarjen e kontratës që është lidhur për një periudhë të pacaktuar. Në rastet kur përfaqësuesi tregtar për shkak të denoncimit të pabazuar nga ana e urdhërdhënësit e ka ndërprerë veprimtarinë e vet, atëherë ai ka të drejtë në shpërblimin e dëmit për shkak të provizionit të humbur. Gjithashtu edhe në rastet kur përfaqësuesi tregtar e ka denoncuar kontratën në mënyrë të pabazuar, atëherë urdhërdhënësit i takon e drejta e shpërblimit të dëmit. Është me rëndësi të ceket që denoncimi i pabazuar, i jep të drejtën palës tjetër që të zgjidh kontratën pa afat denoncimi.<sup>193</sup>

---

<sup>190</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 828.

<sup>191</sup> Po aty, neni 829, paragrafi 1.

<sup>192</sup> Dauti, N.; Berisha, R.; Vokshi, A.; Aliu, A. dhe Blakaj, S. (2013, fq. 459). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.

<sup>193</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077). Neni 829.

### 5.9. Harmonizimi i kontratës së përfaqësimit tregtar me direktivën evropiane mbi agentët tregtar

Direktiva Evropiane e nxjerrë më datë 18 dhjetor 1986 me qëllim të harmonizimit të legjislacionit të shteteve anëtare mbi agentët tregtar të vetëpunësuar ka për qëllim që të arrijë përputhshmërinë e legjislacioneve dhe të harmonizojë rregullimin e kontratës së përfaqësimit tregtar në shtetet anëtare. Kjo direktivë evropiane përqendrohet në agentët tregtar të vetëpunësuar, gjegjësisht mbi kontratën e përfaqësimit tregtar. Kjo direktivë evropiane përmban gjithsej 23 nene dhe në mënyrë të përgjithshme i udhëzon shtetet anëtare mbi kontratën e përfaqësimit tregtar.

Në nenin 3 të kësaj direktive parashihet, se përfaqësuesi tregtar duhet të mbrojë interesat e urdhërdhënësit dhe të veprojë me mirëbesim dhe sinqeritet. Si detyrime për përfaqësuesin tregtar paraqiten si në vijim:

- Të mundohet të negociojë në mënyrë të duhur, dhe ku është e përshtatshme të kryejë punët për të cilat urdhërdhënësi e ka urdhëruar;
- Të informoj urdhërdhënësin të gjitha informatat mbi veprimtarinë e përfaqësimit që ai i posedon; si dhe
- Të ekzekutojë urdhrat, gjegjësisht udhëzimet e dhëna nga urdhërdhënësi.<sup>194</sup>

Duke e marrë parasysh atë që është trajtuar më sipër te detyrimet e përfaqësuesit tregtar, ligjvënësi gjatë përpilimit e ka marrë për bazë këtë direktivë duke e cekur se përfaqësuesi tregtar duhet të veprojë në interes të urdhërdhënësit dhe duke shndërruar detyrimin e tij që të veprojë me mirëbesim dhe sinqeritet si një detyrim kryesor të përfaqësuesit tregtar.

Në nenin 4 të kësaj direktive parashihen detyrimet që urdhërdhënësi i ka ndaj përfaqësuesit tregtar, të cilat janë:

- Të jap dokumentacionin e nevojshëm përfaqësuesit tregtar;
- Të japë informatat e nevojshme përfaqësuesit tregtar të cilat janë relevante për kryerjen e veprimtarisë të përfaqësimit, dhe veçanërisht të njoftoj përfaqësuesin tregtar në qoftë se e ndryshon gjegjësisht korrigjon vëllimin e autorizimeve të përfaqësuesit tregtar; si dhe

---

<sup>194</sup> Council directive on the coordination of the laws of the Member States relating to self-employed commercial agents (Office Journal of the European Communities, No. L 382/17). Neni 3.

- Të informojë përfaqësuesin tregtar brenda një kohe të arsyeshme në qoftë se pranon ose refuzon lidhjen e kontratës.<sup>195</sup>

Duke e marrë për bazë atë që është trajtuar më lartë, arrijmë në konkludim që ligjvënësi i ka paraparë të gjitha detyrimet e urdhërdhënësit në këtë direktivë në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve. Është me rëndësi të ceket që këto detyrime që i ka paraparë janë themelore dhe ligjvënësi përveç këtyre detyrimeve si për urdhërdhënësin ashtu edhe për përfaqësuesin tregtar, ai ka paraparë edhe detyrime shtesë të cilat janë të trajtuara më lartë te efektet juridike të kontratës së përfaqësimit tregtar.

Në nenin 6 të direktivës është trajtuar shpërblimi që i takon përfaqësuesit tregtar, ku ceket se shpërblimi përcaktohet në kontratë, si dhe në rast nëse nuk është përcaktuar shpërblimi në kontratë, atëherë merren parasysh tarifatat e agjentit, ose praktikatat e ndryshme mbi përfaqësimin. Gjithashtu është cekur që në rastet kur është e pamundur të definohet shumica e shpërblimit, atëherë merren parasysh të gjitha aspektet e përfaqësimit të kryer nga agjenti tregtar, që përfshinë llojin e punës dhe vëllimin.<sup>196</sup> Në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve është cekur në mënyrë të njëjtë shpërblimi që i takon agjentit. Në nenin 7 të direktivës flitet për rastet kur përfaqësuesi tregtar i takon shpërblimi për punën e kryer, si dhe është cekur rasti i përjashtimit ekskluziv.<sup>197</sup> Në mënyrë të plotë neni 6 dhe 7 janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës, me atë që ligjvënësi e ka paraparë edhe rastin e shpërblimit të agjentit edhe në rastet kur ai lidh kontratë vetë me ndonjë person të tretë, por ai person i tretë gjendet në zonën në të cilën agjenti tregtar ka përfaqësim ekskluziv. Prej nenit 8 deri në nenin 12 të direktivës janë paraparë rastet e pagesës së shpërblimit të përfaqësuesit tregtar edhe në rastet kur përfaqësimi ka skaduar. Përveç kësaj është paraparë koha e pagesës, rastet kur e drejta e shpërblimit shuhet apo nuk vlen për përfaqësuesin tregtar, si dhe të ngjashme që ndërlidhen me pagesën e shpërblimit. Për sa i përket pagesës së shpërblimit gjegjësisht provizionit, ligji për marrëdhëniet e detyrimeve e trajton në mënyrë të hollësishme duke qenë në përputhje me nenet e cekura më lartë të direktivës.

Prej nenit 12 deri në nenin 16 të direktivës janë paraparë mënyrat e shuarjes së kontratës të përfaqësimit tregtar. Në këto nene janë shqyrtuar mënyrat e shuarjes gjegjësisht

---

<sup>195</sup> Council directive on the coordination of the laws of the Member States relating to self-employed commercial agents (Office Journal of the European Communities, No. L 382/17). Neni 4.

<sup>196</sup> Po aty, neni 6.

<sup>197</sup> Po aty, neni 7.

shkëputjes së kontratës për kontratat për një periudhë të pacaktuar kohore, si dhe për kontratat për një kohë të caktuar. Kompensimi i dëmit është trajtuar prej nenit 17 deri në nenin 20. Në këto nene përfshihet shpërblimi i dëmit, rastet kur pala ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, si dhe rastet kur shpërblimi i dëmit nuk vlen. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës i shqyrton mënyrat e ndryshme të shuarjes së kontratës të përfaqësimit tregtar, për një periudhë të caktuar kohore apo për një kohë të caktuar. Si dhe trajtohet edhe kompensimi gjegjësisht shpërblimi i dëmit dhe gjithçka që ndërlidhet me shpërblimit e dëmit, që nënkupton se edhe këto dispozita ligjore të ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve janë në përputhje të plotë me direktivën.

Pas hulumtimit të hollësishëm të neneve të paraparë me këtë konventë që paraqiten si udhëzime të dhëna për shtetet anëtare në mënyrë që të harmonizohet kontrata e përfaqësimit tregtar. Mund të konkludojmë që ligjvënësi, gjatë përpilimit të ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës, është bazuar në këtë direktivë evropiane dhe ka arritur harmonizimin e dispozitave ligjore që trajtojnë këtë kontratë.

# KAPITULLI IV

---

## *Kontrata e përfaqësimit në të drejtën komparative*

---

### 1. Kontrata e përfaqësimit në regjion

Në këtë pjesë do të trajtohet instituti i përfaqësimit gjegjësisht kontrata e përfaqësimit në të drejtën komparative. Fillimisht, do të trajtohet rregullimi ligjor i përfaqësimit në regjion gjegjësisht se si kontrata e përfaqësimit është e rregulluar në Maqedoninë e Veriut dhe në Shqipëri. Përmes këtij krahasimi, do të mund të shihen ngjashmëritë dhe dallimet në të drejtën komparative, dhe si legjislacioni i Kosovës mund të përmirësojë këtë institut duke e marrë për bazë rregullimin ligjor të legjislacioneve të shteteve tjera. Duke e pasur parasysh vëllimin e kësaj teze, në këtë kapitull do të tentohet që të paraqiten ngjashmëritë dhe dallimet më kryesore në mes të drejtës komparative dhe legjislacionit të Kosovës.

#### 1.1. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Maqedoninë e Veriut

Përfaqësimi gjegjësisht kontrata e përfaqësimit në Maqedoninë e Veriut është e rregulluar përmes ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve. Trajtimi i kontratës së përfaqësimit në këtë ligj fillon prej nenit 76 deri në nenin 90. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve e lejon ndërmarrjen apo kryerjen e punëve juridike përmes përfaqësuesit gjegjësisht e një kontratën e përfaqësimit si një kontratë shërbimi. Autorizimi për përfaqësim, njejtë si në Republikën e Kosovës, bazohet në ligj, statut ose me akt tjetër të përgjithshëm, në akt të ndonjë organi kompetent ose në bazë të deklaramit të vullnetit nga i përfaqësuar (autorizimi për përfaqësim).<sup>198</sup>

Kontratën të cilën e lidhë përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar, dhe në kufijtë e autorizimeve të tij i detyron në mënyrë të drejtpërdrejtë të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese.<sup>199</sup> Për të kryer punët juridike të besuara, përfaqësuesit i nevojitet autorizimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit, autorizim i cili jepet në të njëjtën mënyrë si në Republikën e Kosovës. Pasi që ka gjasa që të keqpërdoret ky autorizim, ligjvënësi e ka cekur edhe institutit e tejkalimit të autorizimit, rastet e tejkalimit të autorizimit, veprimet e

---

<sup>198</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 18/2001). Neni 76.

<sup>199</sup> Po aty, neni 77, paragrafi 1.

mëvonshme që ndërmerren pas tejkalimit, dhe rastet e përfaqësimit nga personi i paautorizuar. Prej nenit 76 deri në nenin 80 të ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve të Maqedonisë së Veriut, trajtohet përfaqësimi, burimet e përfaqësimit, efektet që i sjell përfaqësimi, bartjen e autorizimeve, si dhe tejkalimin e autorizimit, që janë identike me nenet e parapara me ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve të Kosovës.

Për sa i përket prokurës, ligjvënësi i Maqedonisë së Veriut nuk e ka definuar prokurën por vetëm është përqendruar në elementet dhe përmbajtjen e prokurës. Këtë është munduar ta përmirësojë ligjvënësi në Kosovë, përmes përfshirjes së definicionit të prokurës në kodin civil. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Maqedonisë së Veriut, prokurën e ka trajtuar prej nenit 81 deri në nenin 88, ku është cekur dhënia e prokurës, forma e veçantë e prokurës, vëllimi i autorizimeve që burojnë nga prokura, revokimin dhe kufizimin e prokurës, si dhe shuarjen e prokurës duke përfshirë edhe rastet e veçanta të shuarjes.

Nga e gjithë kjo mund të konkludojmë se dispozitat e parapara në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve në Maqedoninë e Veriut mbi përfaqësimin, janë identike me nenet përkatëse në legjislacionin e Kosovës. Për shkak të kësaj, në këtë pjesë është trajtuar shkurtimisht rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Maqedoninë e Veriut, për arsye që mos të përsëriten edhe njëherë.

## 1.2. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Shqipëri

Përfaqësimi gjegjësisht kontrata e përfaqësimit në Shqipëri është e rregulluar me kodin civil që është nxjerrë në vitin 2014. Ky institut gjegjësisht kontratë rregullohet me dispozitat ligjore prej nenit 64 deri në nenin 78. Në legjislacionin e Shqipërisë, përfaqësimi është i përkufizuar si në vijim: *“me përfaqësimin e një personi, përfaqësuesi kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar).”*<sup>200</sup> Ligjvënësi me fjalën tagre nënkupton autorizimin gjegjësisht autorizimet që i përfaqësuarit ia jep përfaqësuesit. Është me rëndësi të ceket neni 67 i kodit civil, ku parashihet se përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij.<sup>201</sup> Rëndësia këtu qëndron, pasi që në këtë nen përmendet konflikti

---

<sup>200</sup> Kodi civil i Republikës së Shqipërisë (Qendra e botimeve zyrtare, dhjetor 2014). Neni 64.

<sup>201</sup> Po aty, neni 67.

i interesit mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit. Është për tu vërejtur që ligjvënësi në legjislacionin e Kosovë e ka shtuar konfliktin e interesit gjatë përpilimit të kodit civil të Kosovës.

Kodi civil i Shqipërisë, prokurën e definon si dokument në të cilin i përfaqësuarit, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit.<sup>202</sup> Llojet e prokurës në Shqipëri ashtu si në Kosovë janë të njëjta, ku kemi prokurën e përgjithshme përmes së cilës kryhen veprime juridike të shumëllojshme, si dhe prokurën e posaçme përmes së cilës kryhen një ose disa veprime të caktuara. Një dallim tejet i rëndësishëm është forma e pranuar ligjore e prokurës për të lidhur një kontratë. Në bazë të kodit civil të Shqipërisë, prokura bëhet gjithmonë me shkresë si dhe mund të bëhet vetëm me akt noterial që paraqet formën e pranuar nga ligjvënësi, përndryshe është e pavlefshme. Mirëpo prokura në emër të personave juridik mund të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur me ligj kërkohet që prokura të bëhet me akt noterial. Kjo formë e prokurës është detyrueshme gjithmonë, përveç në rastet kur legjislacioni i Shqipërisë lejon ndonjë formë tjetër për ndonjë punë të caktuar juridike si p.sh. në rastet kur prokura të bëhet vetëm me shkresë të thjeshtë.<sup>203</sup> Këtë formë të detyrueshme të prokurës pa të cilën prokura do të quhet e pavlefshme nuk e kemi të paraparë aspak në ligjin për marrëdhëniet e detyrime të Kosovës, dhe po ashtu nuk është paraparë as në kodin civil të ardhshëm të Kosovës.

Siç shihet përfaqësimi gjegjësisht kontrata e përfaqësimit në kodin civil të Shqipërisë është identime me rregullimin ligjor të ofruar në Kosovë. Në mënyrë të njëjtë është trajtuar përfaqësimi, efektet që i sjell përfaqësimi, dhënia e prokurës, llojet e prokurës, e drejta për revokimin e prokurës dhe shuarjen e prokurës, si dhe rastet e përfaqësimit pa tagre gjegjësisht përfaqësimi nga personi i paautorizuar. Mund të themi për sa i përket përpilimit të kodit civil të Kosovës, është e mundur që ligjvënësi është bazuar në kodin civil të Shqipërisë ose të dy kodet kanë marrë për bazë të njëjtin legjislacion të një shteti të caktuar. Kjo vërehet nga vetë fakti që në kodin civil të Kosovës është përfshirë neni i konfliktit të interesit, nen i cili ekziston në kodin civil të Shqipërisë, si dhe është definuar prokura.

---

<sup>202</sup> Kodi civil i Republikës së Shqipërisë (Qendra e botimeve zyrtare, dhjetor 2014). Neni 70.

<sup>203</sup> Po aty, neni 72.

## 2. Kontrata e përfaqësimit në shtetet e tjera

Në vijim, do të trajtohet rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në disa shtete të tjera, përmes së cilave mund të kuptojmë se sa të përafërta janë dispozitat ligjore përkatëse të legjislacionit të Kosovës me dispozitat ligjore të shteteve tjera mbi institutin e përfaqësimit dhe kontratën e përfaqësimit.

### 2.1. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Itali

Kontrata e përfaqësimit në Itali është rregulluar me kodin civil. Për dallim nga emërtimi i dhënë në legjislacionin tonë, në Itali e ka emërtimin kontrata e mandatit ose vetëm mandati (*në gjuhën italiane, contratto del mandato ose il mandato*). Ky emërtim është bazuar nga raporti i brendshëm i marrëdhënies së krijuar mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit. Rregullim i ligjor i kontratës së përfaqësimit në kodin civil Italian fillon prej nenit 1703 deri në nenin 1730.

Në Itali, Kontrata e mandatit nënkupton kontratën në të cilën një palë detyrohet të kryejë një apo më shumë punë juridike në llogari të palës tjetër.<sup>204</sup> Arsyeja pse kontrata e përfaqësimit në legjislacionin Italian nuk është e përcaktuar që një palë duhet të kryejë punët juridike në emër dhe llogari të palës tjetër, por vetëm në llogari të palës tjetër është për arsye se kontrata e përfaqësimit gjegjësisht kontrata e mandatit në Itali ndahet në kontratën e mandatit me përfaqësim dhe pa përfaqësim. Në qoftë se urdhërmarrësi gjegjësisht përfaqësuesi e ka të drejtën për përfaqësim, atëherë ai punët juridike i kryen në emër dhe llogari të përfaqësuarit. Në këtë rast kemi të bëjmë me kontratën e mandatit me përfaqësim. Por në qoftë se urdhërmarrësit nuk i është dhënë e drejta për përfaqësim, ai atëherë vepron në emër të vet por në llogari të përfaqësuarit. Në këtë rast urdhërmarrësi i fiton të drejtat dhe i pranon detyrimet e lindura nga punët juridike gjegjësisht nga lidhja e kontratave, dhe më pas urdhërmarrësi duhet t'i transferojë te i përfaqësuarit të drejtat dhe detyrimet, sendet e blera apo shumat e fituara nga punët juridike gjegjësisht lidhja e kontratave, ndërsa i përfaqësuarit gjegjësisht urdhërdhënësi duhet të kompensojë shpenzimet, dhe t'i jap mjetet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ndaj personave të tretë me të cilët ka kryer punën juridike të besuar gjegjësisht lidhjen e kontratës.<sup>205</sup>

---

<sup>204</sup> Kodi civil i Republikës Italiane (Gazeta Zyrtare e RI-së, nr. 79/1942). Neni 1703.

<sup>205</sup> Trimarchi, P. (2009, fq. 436). *Istituzioni di diritto privato*. Vëllimi 18. Itali: Giuffrè.



Ky lloj i kontratës së mandatit përdoret nga personat të cilët nuk kanë dëshirë të njihen nga personi i tretë me të cilin urdhërmarrësi lidh kontratën. Arsyeja e kësaj është se i përfaqësuari ka frikë se në qoftë se personi i tretë është në dijeni se kush është i përfaqësuari, atëherë ky person nuk do të shpreh dëshirë të lidh kontratën, respektivisht mund ta vështirësoj kryerjen e punëve juridike. Një arsye tjetër është në rastet kur të përfaqësuarit nuk i lejohet të lidh kontratën me personin e tretë. Mirëpo, kjo kontratë nuk është që preferohet vetëm nga ana e të përfaqësuarit në rastet e cekura më sipër, por ka raste kur ky lloj i kontratës është në dobi edhe të personit të tretë. Personi i tretë e zgjedh këtë lloj të kontratës në rastet kur nuk e njeh të përfaqësuarin dhe nuk ka besim te ai. Gjithashtu ky lloj i kontratës së mandatit shmang çdo kontest gjegjësisht pengesat që mund të dalin nga interpretimi i vëllimit të autorizimeve gjegjësisht prokurës që përfaqësuesi e posedon. Në këtë lloj të kontratës poashtu nuk paraqitet tejkalimi i autorizimit dhe jo miratimi i tejkalimit, duke e lënë personin e tretë në një pozitë të pa lakmueshme. Anët negative të llojit të tillë të kontratës janë veprimi juridik i dyfishtë gjegjësisht transaksioni i dyfishtë dhe shpenzimet e larta.<sup>206</sup>

Me transaksion të dyfishtë nënkuptojmë se kemi dy veprime juridike, në vend që të kemi një veprim të vetëm ashtu siç ndodh në kontratën e përfaqësimit që legjislacioni ynë e njeh. Fillimisht të drejtat dhe detyrimet, sendet e blera apo shumët e fituara i transferohen urdhërmarrësit nga personi i tretë, dhe më pas urdhërmarrësi gjegjësisht përfaqësuesi duhet t'ia transferoj të përfaqësuarit. Në këtë lloj të kontratës të mandatit parashihen shpenzime të larta për arsye se frytet e dalura nga lidhja e një kontrata gjegjësisht nga puna juridike në mes të urdhërmarrësit dhe personit të tretë nuk kalojnë drejtpërdrejtë tek i përfaqësuari, por ngelin te përfaqësuesi deri sa ai t'i transferojë tek i përfaqësuari. Këtë lloj të kontratës të mandatit nuk e njeh legjislacioni i Kosovës.

Për sa i përket formës në të cilën kontrata e mandatit gjegjësisht kontrata e përfaqësimit, legjislacioni italian nuk e ka paraparë asnjë formë të veçantë për të pasur efekt juridik. Kështu që paraqitet një konfuzion nëse kontrata e mandatit është një kontratë gjithmonë joformale ose nëse në disa raste të caktuara duhet të ketë formën formale. Pas paraqitjes së këtij konfuzioni, më datë 19 tetor 1954 ka hyrë në fuqi vendimi i gjykatës të ashtuquajtur në të cilin vendim është vendosur si në vijim "*Për sa i përket formës të mandatit,*

---

<sup>206</sup> Trimarchi, P. (2009, fq. 436). *Istituzioni di diritto privato*. Vëllimi 18. Itali: Giuffrè.

*vlen parimi i konfirmuar nga kjo gjykatë supreme, në bazë të së cilës kontrata e mandatit me përfaqësim dhe pa përfaqësim, për blerjen apo shitjen e sendeve të paluajtshme kërkohet të jetë në formën e shkruar.*” Në kundërshtim me atë që është cekur më sipër, është konsideruar përsëri fakti që kur kemi të bëjmë me kontratën e mandatit me përfaqësim mbi shitjen ose blerjen e sendeve të paluajtshme, për të cilën i është dhënë prokura në formë të shkruar, nuk nevojitet që kontrata e mandatit të jetë e shkruar gjegjësisht kontrata do të jetë e vlefshme edhe në qoftë se nuk është lidhur në formën e shkruar.<sup>207</sup>

Për sa i përket formës së kontratës së mandatit me përfaqësim që është cekur në nenin 1704 të kodit civil, parashihet se në rast kur mandati është me përfaqësim, duhet t’i referohemi nenin 1392 të kodit ku e parasheh që prokura nuk ka efekt juridik nëse nuk është dhënë në formën e njëjtë, me formën që është parashikuar kontrata që përfaqësuesi duhet të lidh me personin e tretë në emër dhe llogari të përfaqësuarit.<sup>208</sup>

Në vijim do të shqyrtohen detyrimet e përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit të parapara në legjislacionin italian. Detyrimet e përfaqësuesit të parapara në kodin civil janë:

- Detyrimi për ekzekutimin e autorizimit sikur një prind i mirë i familjes, por në qoftë se kontrata është pa shpërblim përgjegjësia për faj është më e ulët;
- Të njoftojë të përfaqësuarin mbi rrethanat që mund të determinojnë revokimin apo ndryshimin e autorizimit;<sup>209</sup>
- Njoftimi i menjëhershëm për ekzekutimin e autorizimit të dhënë.<sup>210</sup> Përfaqësuesi e ka për detyrë të informojë të përfaqësuarin mbi gjendjen e veprimeve të tija,
- Të dorëzoj sendet që ka pranuar për shkak të autorizimit të dhënë.<sup>211</sup>

Këto janë disa nga detyrimet e përfaqësuesit që i ka paraparë kodi civil, të cilat janë të ngjashme me detyrimet që përfaqësuesi i ka në legjislacionin e Kosovës. Për sa i përket detyrimeve të përfaqësuarit, kodi civil i ka paraparë detyrimet në vijim:

- Dhënia e mjeteve të nevojshme për ekzekutimin e autorizimit gjegjësisht autorizimeve, si dhe për përmbushjen e detyrimeve që përfaqësuesi i ka kontraktuar

---

<sup>207</sup> Caputo, L. (2013, fq. 24-25). *Gli effetti del contratto di mandato*. Italia: Università degli studi di Pisa.

<sup>208</sup> Po aty, fq. 25.

<sup>209</sup> Kodi civil i Republikës Italiane (Gazeta Zyrtare e RI-së, nr. 79/1942). Neni 1710.

<sup>210</sup> Po aty, neni 1712.

<sup>211</sup> Po aty, neni 1713.

në emër të vetë.<sup>212</sup> Për sa i përket pjesës ku ligjvënësi e ka cekur për dhënien e mjeteve të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që përfaqësuesi i ka kontraktuar në emër të vetë, i referohet kontratës së mandatit pa përfaqësim për arsye se në këtë kontratë përfaqësuesi vepron në llogari të përfaqësuarit por në emër të vetë;

- Kompensimi i shpenzimeve me kamatën ligjore prej ditës kur kanë ndodhur këto shpenzime; dhe
- Detyrimi për të paguar provizionin gjegjësisht pagesën e shpërblimit që i takon përfaqësuesit për punën e kryer.<sup>213</sup>

Detyrimet e të përfaqësuarit që parashihnin dhënien e mjeteve të nevojshme për kryerjen gjegjësisht ekzekutimin e autorizimeve të dhëna, si dhe kompensimin e shpenzimeve dhe pagesën e shpërblimit janë po të njëjta detyrime që i përfaqësuarit i ka në bazë të legjislacionit të Kosovës.

Kodi civil përveç asaj që është trajtuar më sipër, e trajton edhe shuarjen e kontratës, revokimin e mandatit gjegjësisht autorizimit, zëvendësimin e përfaqësuesit, mundësinë për të pasur më shumë përfaqësues, si dhe përmbajtjen e mandatit. Këto janë të ngjashme me rregullimin e kontratës së përfaqësimit në legjislacionin e Kosovës. Dallimi kryesor qëndron në atë se kodi civil italian e ka paraparë edhe llojin e kontratës së mandatit pa përfaqësim, kontratë e cila nuk njihet në legjislacionin tonë.

## 2.2. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Zvicër

Kontrata e përfaqësimit është e rregulluar në Zvicër me amendamentin mbi librin e pestë të detyrimeve të kodit civil. Dispozitat ligjore të cilët e rregullojnë këtë kontratë janë, në kapitullin e trembëdhjetë të aktit federal mbi amendamentin e kodit civil për pjesën e pestë që përfshinë kodin e detyrimeve, prej nenit 394 deri në nenin 406.

Legjislacioni i Zvicrës e ka definuar kontratën e përfaqësimit si një kontratë ku përfaqësuesi gjegjësisht agjenti kryen punë të caktuara ose jep shërbime të caktuara në përputhje me nenet e kontratës.<sup>214</sup> Për dallim nga legjislacionet tjera, legjislacioni i Zvicrës këtë kontratë e ka definuar më ndryshe. Kjo kontratë përfshin autorizimin përmes së cilit të kryhen të gjitha punët juridike që janë të nevojshme për ekzekutimin e kësaj kontrate.<sup>215</sup>

<sup>212</sup> Kodi civil i Republikës Italiane (Gazeta Zyrtare e RI-së, nr. 79/1942). Neni 1719.

<sup>213</sup> Po aty, neni 1720.

<sup>214</sup> Akti federal mbi amendamentin e kodit civil Zviceran (Pjesa 5: Kodi mbi detyrimet). Neni 394.

<sup>215</sup> Po aty, neni 396.

Përmes së cilës arrijmë të kuptojmë që ligjvënësi këtu flet për autorizimin e përgjithshëm, ndërsa për disa punë të caktuara juridike kërkohet autorizim i veçantë.

Në legjislacionin e Zvicrës, përfaqësuesi i ka po të njëjta detyrime që i ka punëtori në një marrëdhënie pune. Përveç detyrimeve të njëjta me detyrimet e punëtorit në një marrëdhënie të punës, në kodin e detyrimeve janë të parapara edhe detyrimet në vijim:

- Është i detyruar që punën e besuar ta kryejë me mirëbesim dhe profesionalitet. Pasi që kontrata e përfaqësimit është kontratë *intuitu personae* dhe lidhet për cilësitë e përfaqësuesit, ai duhet t'i kryejë personalisht punët e besuara. Përfaqësuesi mund t'i delegojë punët juridike vetëm nëse ka qenë i autorizuar për këtë ose për shkak rrethanave është dashur t'i delegoj punët e besuara;<sup>216</sup>
- Është i detyruar për dhënien e raportit, gjegjësisht të informojë të përfaqësuarin çdoherë kur ai e kërkon këtë;
- Është i detyruar të kthejë çdo gjë që ka pranuar si rezultat i kësaj veprimtarie, të lindur nga kontrata e përfaqësimit;
- Është i detyruar të paguajë kamatë në çdo shumë që është vonuar t'ia dërgojë të përfaqësuarit.<sup>217</sup>
- Në mënyrë që të mbrojtë interesin e të përfaqësuarit, përfaqësuesi po ashtu është i detyruar të njoftojë autoritetet për mbrojtjen e të rriturve në vendbanimin e të përfaqësuarit, nëse ai humb në mënyrë të përhershme zotësinë për veprim.<sup>218</sup> Me këtë i jepet një detyrim shtesë përfaqësuesit se sa detyrimet që përfaqësuesi i ka në legjislacionin tonë.

Këto janë disa nga detyrimet që legjislacioni Zviceran i ka përfshirë në kodin e detyrimeve.

Për sa i përket të përfaqësuarit, ai është i detyruar:

- Të kompensojë shpenzimet me kamatë që kanë ndodhur gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përfaqësimit;
- Të lirojë përfaqësuesin nga detyrimet që ka marrë ai në bazë të kontratës së përfaqësimit;
- Të kompensojë për çdo humbje apo dëm që mund të ketë pësuar përfaqësuesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përfaqësimit. I përfaqësuarit nga ky detyrim ka mundësi të

---

<sup>216</sup> Akti federal mbi amendamentin e kodit civil Zviceran (Pjesa 5: Kodi mbi detyrimet). Neni 398.

<sup>217</sup> Po aty, neni 400.

<sup>218</sup> Po aty, neni 397a.

lirohet nëse mund të dëshmojë që dëmi është shkaktuar me vetë fajin e përfaqësuesit;<sup>219</sup>

Në bazë të kësaj që është trajtuar më lartë, fillimisht hasim në atë që si detyrime të përfaqësuesit, përveç detyrimeve të tij të cekura janë edhe detyrimet që lindin për punëtorin në një marrëdhënie pune. Ky lloj i nenit nuk është paraparë në asnjë legjislacion tjetër të trajtuar në këtë tezë, dhe në një mënyrë e dallon rregullimin ligjor të kontratës së përfaqësimit në Zvicër.

Në kodin e detyrimeve, janë të paraparë edhe nenet mbi revokimin dhe shuarjen e kontratës. Palët kontraktuese kanë të drejtë që në çdo kohë të revokojnë ose të shuajnë kontratën e përfaqësimit, mirëpo në qoftë se njëra nga palët e bën revokimin apo shuarjen e kontratës në një kohë të papërshtatshme për palën tjetër, atëherë pala e cila ka bërë revokimin gjegjësisht shuarjen është e detyruar të bëjë kompensimin e dëmit, në qoftë se pala tjetër ka pësuar dëm me revokimin gjegjësisht shuarjen.<sup>220</sup> Shkaqet e tjera të shuarjes së kontratës së përfaqësimit në qoftë se palët nuk janë marrë vesh ndryshe ose nuk varen nga natyra e punës juridike janë humbja e zotësisë së veprimit, vdekja ose shpallja e personit të zhdukur për të vdekur, si dhe falimentimi i njërit nga palët kontraktuese. Sidoqoftë, në rastet kur shuarja e kontratës për shkak të shkaqeve të cekura më sipër e rrezikon interesin e të përfaqësuarit, përfaqësuesi gjegjësisht trashëgimtari i tij ligjor apo përfaqësuesi i tij është i detyruar të vazhdojë veprimtarinë e përfaqësimit deri në kohën kur i përfaqësuarit gjegjësisht trashëgimtari i tij ligjor apo përfaqësuesi i tij mund që këto veprimtari t'i kryej personalisht.<sup>221</sup>

Nga e gjithë kjo, mund të konkludojmë se edhe pse kontrata e përfaqësimit është definuar më ndryshe në Zvicër dhe po ashtu janë paraparë disa detyrime shtesë për palët kontraktuese, duhet të merret parasysh që pjesa e tjetër e rregullimit ligjor është e ngjashme me mënyrën se si ligji për marrëdhëniet e detyrime të Kosovës e ka paraparë.

### 2.3. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Gjermani

Kontrata e përfaqësimit në Gjermani rregullohet me kodin civil Gjerman. Ashtu sikur në legjislacionin Italian, po ashtu edhe në legjislacionin Gjerman, kontrata e përfaqësimit

---

<sup>219</sup> Akti federal mbi amendamentin e kodit civil Zviceran (Pjesa 5: Kodi mbi detyrimet). Neni 402.

<sup>220</sup> Po aty, neni 404.

<sup>221</sup> Po aty, neni 405.

emërtohet si mandat (në gjuhën angleze, *mandate*). Përfaqësimi gjegjësisht kontrata e përfaqësimi është rregulluar me dispozitat ligjore prej nenit 662 deri në nenin 674.

Kodi civil Gjerman e ka cekur, se me pranimin e mandatit gjegjësisht autorizimit, përfaqësuesi pajtohet që të kryejë punën juridike të besuar nga i përfaqësuarit, për të përfaqësuarin, pa shpërblim.<sup>222</sup> Në këtë definicion nuk ceket që puna kryhet në emër dhe llogari të përfaqësuarit, por ceket që kryhet për të përfaqësuarin. Nëse një person është përzgjedhur për të kryer punë të caktuara juridike ose që ka ofruar në mënyrë publike kryerjen e disa punëve të caktuara juridike, dhe në rast se ai nuk e pranon mandatin gjegjësisht autorizimin për t'i kryer këto punë të tilla, atëherë ai duhet të informoj të përfaqësuarin në kohë për refuzimin e mandatit.<sup>223</sup> Në legjislacionin Gjerman, përfaqësuesit i lejohet t'i devijojë ose të ju shmanget udhëzimeve të përfaqësuarit në qoftë se ai supozon se i përfaqësuarit në rrethanat e rastit do t'i aprovonte devijimet e tilla po të ishte në dijeni për gjendjen përkatëse. Por në të njëjtën kohë ai obligohet që të njoftojë të përfaqësuarin para se t'i marrë këto devijime dhe të pres për përgjigjen e përfaqësuarit. Mirëpo, nëse vonesa e kryerjes së veprimit shkakton rrezik, atëherë atij i lejohet t'i ndërmarrë ato devijime.<sup>224</sup>

Në bazë të kontratës së përfaqësimit, përfaqësuesi e ka për detyrim:

- T'i jep të përfaqësuarit raportet e kërkuara, si dhe të informojë në çdo kohë që kërkon i përfaqësuarit, për gjendjen e punëve juridike, si dhe t'i jap llogari pas ekzekutimit të veprimeve juridike.<sup>225</sup>
- Kthimin e sendeve që i ka pranuar nga i përfaqësuarit për të kryer veprimtarinë e përfaqësimit, si dhe sendet të cilat i ka fituar përgjatë kryerjes së punëve të besuara.<sup>226</sup>

Po ashtu parashihen edhe detyrimet për të përfaqësuarin. I përfaqësuarit është i detyruar:

- Të paguajë paraprakisht shpenzimet e nevojshme për ekzekutimin e autorizimeve, gjegjësisht kryerjen e veprimtarisë së përfaqësimit, në qoftë se këtë e kërkon përfaqësuesi.<sup>227</sup>

---

<sup>222</sup> Kodi civil i Republikës Federale Gjermane (Gazeta Federale Zyrtare e Gjermanisë). Neni 662.

<sup>223</sup> Po aty, neni 663.

<sup>224</sup> Po aty, neni 665.

<sup>225</sup> Po aty, neni 666.

<sup>226</sup> Po aty, neni 667.

<sup>227</sup> Po aty, neni 669.

- Të kompensojë shpenzimet që përfaqësuesi i ka bërë të cilat janë konsideruar të nevojshme në rrethanat e rastit gjatë kryerjes së punëve juridike të besuara.<sup>228</sup>

Detyrimet e cekura më lartë të palëve kontraktuese, janë disa nga detyrimet që njihet përgjithësisht në të drejtën komparative dhe po ashtu edhe në legjislacionin tonë. Kuptohet që palët kontraktuese edhe në legjislacionin Gjerman, kanë edhe detyrime tjera, por këto detyrime të cekura më lartë janë detyrime imperative dhe të mbrojtura me dispozita ligjore.

Mandati gjegjësisht autorizimi mund të revokohet nga i përfaqësuari dhe të shuhet nga përfaqësuesi në çdo kohë. Përfaqësuesi mund të njoftojë të përfaqësuarin në mënyrë që i përfaqësuari të planifikoj mënyra tjera për ekzekutimin e punës juridike. Në qoftë se ai jep njoftim për shuarje të parakohshme, por nuk ka arsye serioze për shuarje dhe i përfaqësuari pëson dëm nga kjo, atëherë përfaqësuesi është detyruar të kompensojë për dëmin e shkaktuar nga shuarja.<sup>229</sup> Në rastet kur nuk është e qartë se me rastin e vdekjes të përfaqësuarit ose humbjen e zotësisë për kontraktim, shuhet kontrata apo jo, atëherë supozohet që kontrata nuk shuhet. Por në rastet që shuhet mandati gjegjësisht kontrata e përfaqësimit nga rasti i cekur më sipër, si dhe vonesa e kryerjes së veprimeve shkakton rrezik, atëherë përfaqësuesi duhet të vazhdojë kryerjen e veprimeve juridike përderisa trashëgimtari i tij ligjor ose përfaqësuesi i tij të planifikoj mënyra tjera për kryerjen e punës juridike.<sup>230</sup> Rasti është i kundërt për sa i përket shuarjes së mandatit gjegjësisht kontratës së përfaqësimit me rastin e vdekjes së përfaqësuesit. Kjo nënkupton që në rast të paqartësisë, kontrata shuhet me vdekjen e përfaqësuesit. Me rastin e vdekjes së përfaqësuesit, trashëgimtari ligjor detyrohet të informoj të përfaqësuarin me kohë, si dhe të vazhdojë kryerjen e veprimeve juridike të besuara përderisa i përfaqësuari të planifikojë mënyra tjera për kryerjen e punëve juridike.<sup>231</sup> Në kodin civil Gjerman ashtu siç shihet më lartë, ligjvënësi vetëm i ka paraparë mënyrat e shuarjes së kontratës së përfaqësimit gjegjësisht mandatit vetëm me rastin e revokimit apo shuarjes, si dhe me vdekjen e palëve kontraktuese.

Një pjesë e madhe e elementeve kryesore të kontratës së përfaqësimit nuk janë të parapara me këtë kod, por vetëm janë të përfshira elementet esenciale për funksionin e kësaj kontrate duke ia lënë në dorë palëve kontraktuese shtimin e detyrimeve shtesë për një

<sup>228</sup> Kodi civil i Republikës Federale Gjermane (Gazeta Federale Zyrtare e Gjermanisë). Neni 670.

<sup>229</sup> Po aty, neni 671.

<sup>230</sup> Po aty, neni 672.

<sup>231</sup> Po aty, neni 673.

funksionim më efikas të kësaj kontrate.. Për sa i përket elementeve esenciale të kësaj kontrata të parapara me këtë, janë të njëjta me rregullimin e paraparë në legjislacionin e Kosovës me disa ndryshime të vogla, siç edhe u trajtuan më lartë.

#### 2.4. Rregullimi ligjor i kontratës së përfaqësimit në Francë

Kontrata e përfaqësimit në legjislacionin Francez është e paraparë me kodin civil Francez. Dispozitat ligjore që e trajtojnë këtë kontratë fillojnë prej nenit 1984 deri në nenin 2010.

Kodi civil Francez e ka definuar kontratën e përfaqësimit si një veprim gjegjësisht kontratë përmes së cilës një person (i përfaqësuari) ia jep autorizimin personit tjetër (përfaqësuesit gjegjësisht agentit) të bëjë diçka për të përfaqësuarin dhe në emër të tij.<sup>232</sup>. Duhet të ceket se parimisht kjo kontratë është pa shpërblim, përderisa palët nuk janë marrë vesh ndryshe<sup>233</sup> Nga kjo nënkuptojnë, se në rastet kur nuk është cekur shpërblimi për veprimtarinë e përfaqësimit gjegjësisht kryerjen e punëve juridike për të përfaqësuarin, atëherë supozohet se kontrata është e lidhur pa shpërblim. Legjislacioni Francez i ka paraparë llojet e autorizimit, gjegjësisht autorizimin e përgjithshëm në të cilin përfshihen vetëm kryerja e akteve administrative dhe autorizimin e posaçëm apo të veçantë që është i nevojshëm për rastet kur si punë juridike paraqitet një transaksion ligjor, hipotekë, ose veprime juridike të tjera në lidhje mbi pronësinë.<sup>234</sup>

Përfaqësuesi si palë kontraktuese i ka detyrimet në vijim:

- Të kryejë veprimtarinë e përfaqësimit përderisa i është besuar kjo veprimtari;
- Është përgjegjës për dëmin që shkaktohet për shkak të fajit të tij,<sup>235</sup>
- Është përgjegjës jo për vetëm shkeljet e shaktuar me qëllim, por edhe gabimet që kanë ndodhur përgjatë menaxhimit të tij. Kuptohet që në rastet kur kontrata e përfaqësimit është pa shpërblim, përgjegjësia e përfaqësuesit është më e ulët.<sup>236</sup>
- Është i detyruar të japë llogari për menaxhimin e tij të përfaqësimit, si dhe t'i kthej të gjitha sendet që i ka pranuar për shkak autorizimit.<sup>237</sup>

<sup>232</sup> Kodi Civil i Republikës Franceze (Gazeta Zyrtare e Francës). Neni 1984.

<sup>233</sup> Po aty, neni 1986.

<sup>234</sup> Po aty, neni 1988.

<sup>235</sup> Po aty, neni 1991.

<sup>236</sup> Po aty, neni 1992.

<sup>237</sup> Po aty, neni 1993.



- Është përgjegjës për personin i cili ka zgjedhur të kryejë punët juridike të besuara në rastet kur nuk ka marrë autorizim për zëvendësim, si dhe në rastet kur i është dhënë një autorizim të tillë por personi i zgjedhur nga përfaqësuesi ka qenë jo kompetent.<sup>238</sup>

Përderisa në legjislacionet e shteteve të trajtuara më lartë, përgjegjësia mes përfaqësuesve ishte e cekur si dhe e paraparë në të gjitha rastet kur ka më shumë përfaqësues, në legjislacionin Francez gjithmonë supozohet se përgjegjësia e përbashkët e përfaqësuesve nuk ekziston, përderisa nuk është e shprehur se ekziston.<sup>239</sup>

I përfaqësuari është i detyruar:

- Për realizimin gjegjësisht përmbushjen e detyrimeve të kontraktuara nga përfaqësuesi në bazë të autorizimit të dhënë;<sup>240</sup>
- Të kompenzoj shpenzimet e kryera nga përfaqësuesi, përgjatë veprimtarisë së përfaqësimit;
- Të paguajë shpërblimin gjegjësisht provizionin për veprimet e kryera, nëse kjo ka qenë e premtuar dhe e paraparë në kontratë. Ky obligim për kompensimin e shpenzimeve të bëra si dhe pagesa e shpërblimit janë të detyrueshme për të përfaqësuarin edhe në rastin kur puna juridike nuk ka pasur sukses, por që sukcesi i punës juridike nuk ka qenë si pasojë e fajit të përfaqësuesit. Ai gjithashtu nuk mund t'i shmanget pagesës së shpenzimeve të bëra me pretekstin që shpenzimet kanë mundur të kenë kushtuar më pak.<sup>241</sup> Për kryerjen e punëve juridike të besuara, përfaqësuesi shpenzon të holla dhe pret që shuma e shpenzuar t'i kompensohet nga ana e të përfaqësuarit si dhe t'i paguhet shpërblimi që i takon. Në këtë rast ligjvënësi përmes këtij neni, e mbron përfaqësuesin dhe interesin e tij duke e detyruar të përfaqësuarin t'i paguajë shpenzimet e bëra dhe shpërblimin që i takon përfaqësuesit edhe në rastet kur puna juridike mund të mos ketë pasur sukses;
- Të kompensoj për humbjen që mund ta ketë pësuar përfaqësuesi përgjatë veprimtarisë së përfaqësimit, por që këto humbje mos të jenë shkaktuar me fajin e përfaqësuesit;<sup>242</sup>

---

<sup>238</sup> Kodi Civil i Republikës Franceze (Gazeta Zyrtare e Francës). Neni 1994.

<sup>239</sup> Po aty, neni 1995.

<sup>240</sup> Po aty, neni 1998.

<sup>241</sup> Po aty, neni 1999.

<sup>242</sup> Po aty, neni 2000.

Përkundrazi mungesës së përgjegjësisë së përbashkët të agjentëve gjegjësisht përfaqësuesve ndaj të përfaqësuarit që është cekur më lartë, ligjvënësi ka paraparë se në rastet kur një agjent është përzgjedhur nga disa persona gjegjësisht të përfaqësuar, për kryerjen e një pune juridike të përbashkët, atëherë çdonjëri prej tyre kanë përgjegjësi të përbashkët gjegjësisht solidare ndaj agjentit për të gjitha efektet e përfaqësimit.<sup>243</sup>

Përveç asaj që është cekur më lartë mbi rregullim ligjor të kontratës së përfaqësimit në kodin civil Francez, që përfshinte definimin dhe elementet e kontratës së përfaqësimit, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë për palët kontraktuese, janë po ashtu të parapara edhe mënyrat e shuarjes të kontratës së përfaqësimit, mënyra të cilat janë të njëjta me mënyrat e shuarjes në legjislacionin tonë dhe në të drejtën komparative. Kuptohet se rregullimi ligjor i Francës mbi këtë kontratë, po ashtu sikur edhe rregullimet ligjore e shteteve të trajtuara më lartë, në vete përmbajnë disa dallime të vogla të detyrimeve të palëve kontraktuese dhe kontratës së përfaqësimit në përgjithësi. Por me rëndësi është se elementet thelbësore të kontratës së përfaqësimit dhe detyrimet themelore të palëve janë të harmonizuara mes legjislacioneve të shteteve të ndryshme, duke e bërë kontratën e përfaqësimit, një kontratë që gëzon rregullim ligjor të njëjtë gjegjësisht të ngjashëm në legjislacionet e shteteve të sistemit euro kontinental apo të së drejtës së shkruar.

---

<sup>243</sup> Kodi Civil i Republikës Franceze (Gazeta Zyrtare e Francës). Neni 2002.

## Përfundim dhe rekomandime

Prezenca e institutit të përfaqësimit në qarkullimin juridik është i pashmangshëm. Ky institut zbatohet në pothuajse çdo degë të së drejtës dhe ka zbatim në gjitha punët juridike. Edhe pse e drejta romake nuk e njihnte institutin e përfaqësimit, për shkak të parimit *alteri stipulari nemo potest*, përfaqësimi ka qenë prezent në marrëdhëniet juridike që krijoheshin nga institutet tjera juridike. Këto marrëdhënie juridike në një mënyrë e plotësonin zbrazëtirën juridike që ekzistonte në atë kohë për shkak të mungesës të institutit të përfaqësimit. Elementet e para të përfaqësimit që kanë ekzistuar në të drejtën romake i kanë dhënë kahje krejtësisht tjetër qarkullimit juridik, duke e shtyer formësimin e institutit të përfaqësimit që sot është pjesë e çdo marrëdhënie juridike, duke filluar nga përfaqësimi i të miturve nga prindërit deri në përfaqësimin e shtetit nga presidenti.

Me paraqitjen e përfaqësimit vullnetar gjegjësisht paraqitjes të kontratës së përfaqësimit, në qarkullimin juridik filloj kryerja e punëve juridike të shumta në të njëjtën kohë përmes përfaqësuesve, si dhe u mundësua kryerja e punëve juridike përmes përfaqësuesve të profesionalizuar. Është i pamohueshëm fakti që kontrata e përfaqësimit e ka lehtësuar dhe thjeshtuar kryerjen e punëve juridike në qarkullim juridik. My hyrjen në fuqi të kodit civil të Republikës së Kosovës që është në fazën e përpilimit, instituti i përfaqësimit dhe kontrata e përfaqësimit do të parashihen me këtë kod. Rregullimi ligjor i përfaqësimit në këtë kod është i njejtë me disa ndryshime të vogla.

### **Përfundime:**

- Rregullimi ligjor përputhet me rregullimin ligjor në të drejtën komparative dhe me direktivën evropiane;
- Nenet përkatëse për përfaqësim në procedura civile në ligjin për procedurën kontestimore dhe ligjet e veçanta nuk përputhen, që rezulton në mos përputhjen e vendimeve të marra nga ana e gjyqtarëve mbi atë se kush ka të drejtën për përfaqësim në procedura civile.
- Mungon definimi i prokurës në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve;
- Emërtimi i përfaqësuesit të shitjeve të udhëttimeve është i gabuar në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe krijon konfuzion në qarkullimin juridik;

- Jo detyrueshmëria e përpilimit të kontratës të përfaqësimit në formë të shkruar, ka krijuar një praktikë të dhënies vetëm të prokurës, duke e rritur rrezikun e keqpërdorimit të përfaqësimit.
- Mungon mbrojtja e duhur e të përfaqësuarit, me atë se me ligjin për marrëdhëniet e detyrime nuk parashihet asnjë masë mbrojtëse në rastet e keqpërdorimit të përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit për interes të tij;

#### **Rekomandime:**

- Rregullimi ligjor aktual në Kosovë mbi përfaqësimin dhe kontratën e përfaqësimit përputhet me rregullimin ligjor të shteteve tjera në masë të madhe, veçanërisht me rregullimet ligjore të shteteve të hulumtuara në këtë tezë. Po ashtu, rregullimi ligjor i kontratës të përfaqësimit është i harmonizuar plotësisht me direktivën evropiane të cekur më lartë. Megjithatë, rekomandojmë që të parashihen detyrime shtesë të palëve të kontratës të përfaqësimit duke u bazuar në detyrimet e parapara në të drejtën komparative, në mënyrë që mbrojtja e palëve kontraktuese të rritet.
- Për sa i përket përfaqësimit në procedura civile, ligji për procedurën kontestimore lejon çdo person që ka aftësi të veprimit të përfaqësojë njërën palë. Mirëpo, ligjet e veçanta, siç është ligji për avokatinë dhe ligji për ndihmën juridike falas këtë çështje e parashohin ndryshe, duke ia dhënë të drejtën për përfaqësim vetëm avokatëve. Për shkak të kësaj, në praktikë nuk kemi përputhje të veprimeve të ndërmarra nga gjyqtarët. Me atë se një pjesë e gjyqtarëve, është i mendimit se vetëm avokatëve ju takon kjo e drejtë, ndërsa disa gjyqtarë të tjerë, këtë drejtë ia mundësojnë çdo personi me zotësi veprimit, por me kusht që e drejta për kompensimin e shpërblimit të përfaqësuesit nga pala humbëse nuk mund të kërkohet. Rekomandojmë që të riformulohen dhe të harmonizohen nenet përkatëse në ligjin për procedurën kontestimore dhe ligjet e veçanta.
- Në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve nuk definohet prokura, duke ia lënë praktikës gjyqësore dhe literaturës juridike definimin e saktë të prokurës. Edhe pse ligjvënësësi definimin e prokurës e ka paraparë në kodin civil të ardhshëm të Kosovës, rekomandojmë që të parashihet definicioni i prokurës edhe në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve për arsye se data e hyrjes në fuqi të kodit civil akoma nuk është e paraparë saktë.

- Në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe po ashtu në kodin civil të ardhshëm të Kosovës janë paraparë përfaqësuesit e shitjeve të udhëtimeve. Nga vetë emri, parimisht kuptohet se kemi të bëjmë me përfaqësues të cilët merren me shitjen e udhëtimeve gjegjësisht ofrimin e ofertave të aranzhmaneve turistike si punë juridike të besuara nga punëdhënësi. Mirëpo, në bazë të ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, përfaqësuesi i shitjeve të udhëtimeve nuk merret me shitjen e ofertave për udhëtime, por autorizimet e tij përfshijnë ofrimin e shërbimeve të ndryshme personave të tretë, dhe në raste të caktuara edhe lidhjen e kontratave në emër të punëdhënësit. Për shkak se ky lloj i autorizimit të dhënë është i njëjtë me autorizimin e punonjësit, rekomandojmë që të bëhet emërimi i duhur i këtij përfaqësimi në bazë të autorizimeve që i posedon përfaqësuesi, në mënyrë që të mos krijojë konfuzion në qarkullimin juridik.
- Mungesa e formës së shkruar si kusht për kontratën e përfaqësimit, ka shtyer personat të përpilojnë vetëm prokurën që përmban vëllimin e autorizimeve. Në këtë mënyrë, me mos përpilimin e kontratës të përfaqësimit në formën e shkruar, në raste kontesti mes palëve kontraktuese është e vështirë të dëshmohen elementet themelore të marrëdhënies së përfaqësimit. Kështu që rekomandojmë të parashihet detyrueshmëria e formës së shkruar e kontratës të përfaqësimit. Ky rekomandim shkon në favor të mbrojtjes së palëve kontraktuese dhe e ulë rrezikun e keqpërdorimit të përfaqësimit.
- Në ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve nuk është paraparë rasti i keqpërdorimit të përfaqësimit në rastet e konfliktit të interesit. Ky ligj në asnjë mënyrë nuk i sanksionon rastet kur përfaqësuesi lidh kontratën me veten e tij, në emër të vet, ose si përfaqësues i një pale të tretë për të pasur përfitim personal. Fatmirësisht, në kodin civil të Kosovës, që është në fazë të përpilimit, është paraparë rasti i konfliktit të interesit, ku nuk lejohet lidhja e kontratave nga ana e përfaqësuesit me veten e tij përveç nëse përfaqësuesi ka vepruar me autorizim të veçantë të përfaqësuarit, apo ka qenë i detyruar për të lidhur kontratën, ose përmbajtja e kontratës është përpiluar në mënyrë që të përjashtohet konflikti i interesit, kështu që kontrata e lidhur të mos dëmtojë interesat e të përfaqësuarit. Kjo shkon në favor të përfaqësuarit, duke e mbrojtur nga rastet e keqpërdorimit të përfaqësimit.

## Literatura e shfrytëzuar

### Tekste, monografi, punime dhe artikuj:

- Alishani, Alajdin. (1990). *E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë*. Prishtinë
- Aliu, Abdulla (2013). *E drejta civile, pjesa e përgjithshme*. Prishtinë.
- Brestovci, Faik; Morina, Iset dhe Qehaja Rrustem (2017). *E drejta procedurale civile, procedura kontestimore*. Prishtinë.
- Caputo, Laura. (2013). *Gli effetti del contratto di mandato*. Pisa:Universita degli studi di Pisa, Itali.
- Dauti, Nerxhivane (2003). *E drejta kontraktuese, praktikum*. Prishtinë
- Dauti, Nerxhivane; Berisha, Ruzhdi; Vokshi, Adem dhe Aliu, Abdulla. (2013). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 1)*. Prishtinë.
- Dauti, Nerxhivane; Berisha, Ruzhdi; Vokshi, Adem; Aliu, Abdulla dhe Blakaj, Sefadin. (2013). *Komentar: ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (libri 2)*. Prishtinë.
- Hailezgi, Awet Dhe Damtie, Addisu. (2012). *Genesis and development of the law of agency*. Marrur nga: <https://www.abysinialaw.com/component/k2/item/383-genesis-and-development-of-the-law-of-agency>.
- Janevski, Arsen dhe Zoroska-Kamilovska, Tatjana. (2011). *E drejta procedurale civile, e drejta kontestimore (libri 1)*. Përkthyer nga Zendeli, Emine dhe Zendeli, Nagip. Tetovë: Universiteti i Evropës Juglindore.
- Jashari, Adnan. (2016). *E drejta afariste (kontraktore)*. Tetovë
- Morina, Iset dhe Nikçi, Selim. (2012). *Komentar: Ligji për procedurën kontestimore*. Prishtinë.
- Müller-Freienfels, W. (13 prill 2018). *Agency*. Marrur nga: <https://www.britannica.com/topic/agency-law>
- Nerxhivane, Dauti. (2001). *E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Provera, Giuseppe. (1983). *Mandato*. Enciclopedia del diritto. Vëllimi XXV, Milano.
- Станковић, Обрен dhe Водинелић, Владимир. (2007). *Увод у грађанско право*. Beograd.
- Trimarchi, Pietro. (2009). *Istituzioni di diritto privato*. Vëllimi 18. Itali: Giuffrè.

- Van den Bergh, Rena. (2015). *He's the one who minds the boss's business*. Fundamina, vëllimi 21, numër 2. Afrika e Jugut.
- Zimmermann, Reinhard. (1992). *The law of obligations: Roman foundations of the civilian tradition*. Cape Town, Afrika e Jugut.
- Живковска, Родна. (2011). *Општ дел на граѓанското право*. Shkup.

### **Akte normative:**

- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Kosovës. (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-077).
- Ligji për familjen (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 2004/32)
- Ligji për trashëgiminë (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 2004/26).
- Ligji për procedurën kontestimore (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 03/L-006).
- Ligji për shoqëritë tregtare (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 06/L-016).
- Ligji për falimentimin (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 05/L-083).
- Ligji për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr.06/L-043).
- Ligji për ndihmë juridike falas (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-017).
- Ligji për avokatinë (Gazeta Zyrtare e RKS-së, nr. 04/L-193).
- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. (Gazeta Zyrtare e MRV-së nr. 18/01; 04/02 dhe 05/03)
- Kodi civil i Republikës së Kosovës. Libri 2: detyrimet. (Në fazën e përpilimit).
- Kodi civil i Republikës së Shqipërisë. (Qendra e botimeve zyrtare, dhjetor 2014).
- Kodi civil i Republikës Italiane. (Gazeta Zyrtare e RI-së, nr. 79/1942).
- Akti federal mbi amendamentin e kodit civil Zviceran (Pjesa 5: Kodi mbi detyrimet).
- Kodi civil i Republikës Federale Gjermane. I përkthyer në gjuhën angleze nga Ministria Federale e Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve në bashkëpunim me juris GmbH. (Gazeta Federale Zyrtare e Gjermanisë).
- Kodi Civil i Republikës Franceze. I përkthyer në gjuhën angleze nga Rouhette, Georges me ndihmën e Rouhette-Berton, Anna. (Gazeta Zyrtare e Francës).
- Council directive on the coordination of the laws of the Member States relating to self-employed commercial agents (Office Journal of the European Communities, No. L382/17).

## Modele të kontratës së përfaqësimit, prokurës dhe autorizimit

### Shembulli Nr. 1

#### KONTRATË PËR PËRFAQËSIM

Më datë 15.03.2019 në Prishtinë , në bazë të vullnetit të tyre të lirë është lidhur kontrata për përfaqësim në mes:

- **Rinor Nuhiu**, i lindur më 07.10.1996 në Vranje, Serbi, me vendbanim në Prishtinë, me numër personal 2911975818, të vertetuar në bazë të dokumentit publik të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, **në tekstin e mëtejme në cilësinë e të përfaqësuarit**, dhe
- **Sokol Zeneli**, i lindur më 14.10.1994 në Gjilan, me vendbanim në Gjilan, me numër personal 1232853456, të vertetuar në bazë të dokumentit të publik të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, **në tekstin e mëtejme në cilësinë e përfaqësuesit**.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, palët formalizojnë raportet e tyre kontraktuale nga kjo kontratë për përfaqësim, për çka palët dakordohen si vijon:

#### Neni 1

Në bazë të kësaj kontrate, përfaqësuesi obligohet që në emër dhe llogari të përfaqësuarit t'i kryejë punët juridike të parapara në këtë kontratë.

#### Neni 2

Përfaqësuesi sipas autorizimit me shkrim dhe të nënshkruar nga i përfaqësuarit duhet të ndërmarrë veprimin juridik për blerjen e një banese nga ndërtuesi N.P.N. "Hoxha" me seli në Prishtinë.

#### Neni 3

Banesa ka sipërfaqe prej 136.3 m<sup>2</sup>, gjendet në katin e parë në objektin 1, seksioni B, të kompleksit HIG Center në rrugën C, Mati 1 në Prishtinë.

#### Neni 4

Përfaqësuesi ka për detyrim që të blejë banesën deri në shumë të 100.000 Euro dhe të bartë pronësinë e banesës në pronë të përfaqësuarit, duke e lidhur kontratën e shitblerjes në emër dhe llogari të përfaqësuarit.

#### Neni 5

Çmimi i shitjes do t'i jepet shitësit të banesës në momentin kur kontrata për blerjen e banesës bëhet e plotfuqishme, duke e vërtetuar aktin juridik në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe duke e paguar tatimin për qarkullim.

#### Neni 6

Përfaqësuesi është i detyruar që ta informojë të përfaqësuarin për çdo veprim që ndërmerr në llogari të tij dhe të paguajë dëmin që i përfaqësuarit mund ta pësoj gjatë ndërmarrjes së veprimeve juridike në interes të përfaqësuarit.



Përfaqësuesi në këtë rast ka për detyrë që të vërtetojë se është ndërmarrë veprimi juridik nga i cili ka pësuar dëm i përfaqësuarit, dhe në rast nevojë këtë vërtetim të dëmit të pësuar mund ta vërtetojë edhe me ndihmën e vlerësimit dhe mendimit të ekspertit gjyqësorë. Përfaqësuesi mund të lirohet nga ky detyrim, vetëm nëse vërtetohet se dëmi i shkaktuar nuk është si rrjedhë e veprimit të tij.

#### **Neni 7**

I përfaqësuarit ka për detyrë që t'i paguajë shpërblim të caktuar të përfaqësuesit për ndërmarrjen e veprimeve juridike. Shuma e paraparë me këtë kontratë është 200 Euro. Përveç pagesës të shpërblimit, i përfaqësuarit është i detyruar t'i paguajë përfaqësuesit edhe shpenzimet e nevojshme për kryerjen e punës juridike të besuar.

#### **Neni 8**

Përfaqësuesi duhet personalisht të përfaqësojë të përfaqësuarin në kryerjen e punëve juridike, kurse në raste të jashtëzakonshme, këto punë juridike mund t'i kryejë edhe substituti i përcaktuar nga përfaqësuesi, i cili do t'i vazhdojë këto veprime juridike deri në kryerjen e punëve në tërësi ose deri në momentin kur përfaqësuesi lirohet nga pengesa e caktuar për kryerjen e këtyre veprimeve juridike.

#### **Neni 9**

Kontrata për përfaqësim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

#### **Neni 10**

Për çdo që nuk është paraparë në bazë të kësaj kontrate, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrime të Kosovës dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore.

#### **Neni 11**

Në rast të kontekstit ndërmjet palëve kontraktuese, kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë.

#### **Neni 12**

Kontrata për përfaqësim është e përpiluar në 4 kopje identike, prej të cilave secila palë mban nga 2 kopje.

#### **PALËT KONTRAKTUESE**

1. I përfaqësuarit

2. Përfaqësuesi

---

---

## Shembulli Nr. 2

### KONTRATË PËR PËRFAQËSIM

Më datë 22.05.2019 në Prishtinë , në bazë të vullnetit të tyre të lirë është lidhur kontrata për përfaqësim në mes:

- **Innovation Centre Kosovo**, me seli në Prishtinë, rruga Rexhep Mala 28A, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar **Uranik Begu, në tekstin e mëtejme në cilësinë e të përfaqësuarit**, dhe
- **Manaj & Associates IP L.L.C.**, zyrë për shërbime juridike në mbrojtje të pronësisë intelektuale, me seli ne Prishtinë, Mati 1, rruga “Bedri Berisha”, Obejkti D 1/ 37, të cilën e përfaqëson **Florije Manaj Zogaj**, e lindur me dt. 04.01.1978 në Gllarevë, komuna e Klinës, me numër personal 1011019826 , **në tekstin e mëtejme në cilësinë e përfaqësuesit**.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, palët formalizojnë raportet e tyre kontraktuale nga kjo kontratë për përfaqësim, për çka palët dakordohen si vijon:

#### Neni 1

Në bazë të kësaj kontrate, përfaqësuesi obligohet që në emër dhe llogari të përfaqësuarit t'i kryejë punët juridike të parapara në këtë kontratë.

#### Neni 2

Përfaqësuesi sipas prokurës është i detyruar që të përfaqësoj të përfaqësuarin në procedurat administrative dhe administrative-gjyqësore për aplikimet dhe regjistrimet për: patentë, markë tregtare, dizajn industrial dhe treguesit gjeografik në të gjitha aplikacionet e tashme dhe ato të ardhshme në Agjencinë për Pronësisë Industriale të Kosovës, në gjykata dhe organet e tjera kompetente.

#### Neni 3

Përfaqësuesi është i autorizuar t'i ndërmerr veprimet juridike në vijim:

- Të bëjë regjistrimin e markave tregtare, patentave, dizajneve industriale;
- Të bëjë regjistrimin e ndryshimeve / licencave në regjistër;
- Të tërheq /revokoj / të heqë dorë nga regjistrimi;
- Të paraqet kundërshtime / të filloj procedurën për anulimin e patentës, markës tregtare, dizajnit industrial dhe treguesit gjeografik nëse ato janë te njëjta apo të përafërta me regjistrimet e të përfaqësuarit;
- Të përgjigjet për të gjitha kundërshtimet / refuzimet / anulimet e regjistrimeve;
- Të marre pjesë në ekzekutimin e vendimeve;
- Të kërkoj masat e sigurimit gjyqësor dhe të kërkoj anulimin e tyre, dhe në përgjithësi të ndërmerr të gjitha veprimet e mundshme ligjore me qëllim të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes të së drejtës.

#### Neni 4

1. Përfaqësuesi është i detyruar t'i ndërmerr veprimet juridike në bazë të udhëzimeve të dhëna nga i përfaqësuarit.

2. Përfaqësuesi ka për detyrim që veprimet juridike t'i marrë në kohë dhe përgjatë ushtrimit të detyrës së përfaqësuesit të sillet si ekspert i mirë.

#### **Neni 5**

Përfaqësuesi është i detyruar që ta informojë të përfaqësuarin për çdo veprim që ndërmerr në llogari të tij, dhe të dërgojë raport për punën e kryer.

#### **Neni 6**

1. Përfaqësuesi është i detyruar të paguajë dëmin që i përfaqësuarit mund ta pësoj gjatë ndërmarrjes së veprimeve juridike në interes të përfaqësuarit.

2. Përfaqësuesi në këtë rast ka për detyrë që të vërtetojë ndërmarrjen e veprimit juridik nga i cili ka pësuar dëm i përfaqësuarit, dhe në rast nevojë këtë vërtetim të dëmit të pësuar mund ta vërtetojë edhe me ndihmën e vlerësimit dhe mendimit të ekspertit gjyqësorë.

3. Përfaqësuesi mund të lirohet nga ky detyrim, vetëm nëse vërtetohet se dëmi i shkaktuar nuk është si pasojë e veprimit të tij.

#### **Neni 7**

1. I përfaqësuarit ka për detyrë që t'i paguajë shpërblim të caktuar përfaqësuesit për ndërmarrjen e veprimeve juridike të përcaktuara në këtë kontratë.

2. Shuma e shpërblimit përcaktohet në bazë të tarifës të përfaqësuesit për çdo punë juridike të kryer.

3. Përveç pagesës të shpërblimit, i përfaqësuarit është i detyruar t'i paguajë edhe shpenzimet e domosdoshme për kryerjen e punëve juridike që përfshin tarifën për regjistrim të markave tregtare, patentave, dizajneve industriale, si dhe tarifën e tjera për ndërmarrjen e veprimeve juridike në Agjencinë për Pronësinë Industriale në Kosovë, në gjykata dhe organe tjera kompetente.

#### **Neni 8**

Përfaqësuesi duhet personalisht të përfaqësojë të përfaqësuarin në kryerjen e punëve juridike, kurse në raste të jashtëzakonshme, këto punë juridike mund t'i kryejë edhe substituti i përcaktuar nga përfaqësuesi, i cili do t'i vazhdojë këto veprime juridike deri në kryerjen e punëve në tërësi ose deri në momentin kur përfaqësuesi lirohet nga pengesa e caktuar për kryerjen e këtyre veprimeve juridike.

#### **Neni 9**

Kontrata për përfaqësim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

#### **Neni 10**

Për çdo që nuk është paraparë në bazë të kësaj kontrate, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrime të Kosovës dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës kontraktore.

### Neni 11

Në rast të kontekstit ndërmjet palëve kontraktuese, kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë.

### Neni 12

Kontrata për përfaqësim është përpiluar në 4 kopje identike, prej të cilave secila palë mban nga 2 kopje.

### PALËT KONTRAKTUESE

1. I përfaqësuari

2. Përfaqësuesi

### Shembulli Nr. 3

### PROKURË

Të nënshkruarit:

**Innovation Centre Kosovo (ICK)**

**Rruga: Rexhep Mala 28A,**

**Prishtinë, Kosovë**

Nëpërmjet kësaj prokure:

### AUTORIZOJMË

Florije Manaj Zogaj

Manaj Associates IP L.L.C.

Prishtinë, Kosovë

Që të na përfaqëson në procedurën administrative në lëndët e aplikacioneve tona për aplikimet dhe regjistrimet për: patentë, markë tregtare, dizajn industrial dhe treguesit gjeografik në të gjitha aplikacionet e tashme dhe ato të ardhshme në Agjencinë për Pronësisë Industriale të Kosovës; të bëjë regjistrimin e ndryshimeve/licencave në regjistër; të tërheq/revokoj/ të heqë dorë nga regjistrimi; të paraqet kundërshtime/të filloj procedurën për anulimin e patentës, markës tregtare, dizajnit industrial dhe treguesit gjeografik nëse ato janë te njëjta apo të përafërta me regjistrimet tona; të përgjigjet për të gjitha kundërshtimet/refuzimet /anulimet e regjistrimeve tona; të marre pjesë në ekzekutimin e vendimeve; të kërkoj masat e sigurimit gjyqësor dhe të kërkoj anulimin e tyre, dhe në përgjithësi të ndërmerr të gjitha veprimet e mundshme ligjore me qëllim të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes të së drejtës.

Ky autorizim vlen deri në revokimin e tij.

Vendi dhe data: 22.05.2019

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Emri dhe titulli \_\_\_\_\_

Vula

#### Shembulli Nr. 4

#### **AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIM**

Sot më datën 23.12.2014 para meje Learte F. Cana, notere në Prishtinë, Kosovë, rr. Luan Haradinaj, nr. 29, hyrja 4, kati 1-rë, nr. 4 është paraqitur:

- **Samir (Ujup) Rexha**, i lindur më 24.03.1968 në Barilevë, shtetas i Republikës së Kosovës, identitetin e të cilit e konstatova në bazë të letërnjoftimit me nr. personal 1015252908, madhor me zotësi të plotë të veprimit, **në tekstin e mëtejme si dhënësi i autorizimit – autorizuesi.**

Pasi që është konstatuar nga unë Notere që pala është e aftë për të ndërmarrë këtë veprim juridik, i kam sqaruar atij efektet juridike të këtij autorizimi, pala e paraqitur për përpilimin e këtij akti noterial ka dhënë këtë:

#### **AUTORIZIM**

- Për avokatin **Avni Vula**, i lindur më 31.01.1945 në Prishtinë, bartës i letërnjoftimit me nr. personal 20044309947, të lëshuar nga MPB e R. së Kosovës, në tekstin e mëtejme si i autorizuari.

Që në emër dhe për llogarinë time, pa praninë time, t'i kryej të gjitha veprimet juridike të përfaqësimit të autorizuar në kontestin civil numër C.nr.308/12 në Gjykatën Themelore në Prishtinë lidhur me ngastrën kadastrale P-71914059-07177-11, Zona Kadastrale Prishtinë me Padi të Gani Bajrami nga Podujeva.

I autorizuari ka të drejtë të paraqesë padi, të zgjerojë padinë, nga e njëjta të heq dorë, të paraqet mjete juridike dhe nga të njëjtat të heq dorë, deri në përfundimin e procedurave të ndryshme, në të gjitha instancat gjyqësore.

Të gjitha veprimet juridike të ndërmarra nga i autorizuari do t'i konsideroj sikur t'i kisha bërë unë. Ky autorizim është i vlefshëm vetëm për kryerjen e veprimeve të specifikuar si më lartë, si dhe nuk vlen për veprime të tjera. Autorizimi është valid deri në revokimin e të njëjtit nga ana ime si autorizues.

Unë noterja e poshtëshuar e hartova këtë akt, në prani të palës dhe pasi u konstatua identiteti i tij dhe aftësia e plotë e veprimit, akti u lexua me zë, dhe pala deklaroi se ky akt shpreh vullnetin e tij të lirë dhe të plotë. Pala pasi pagoi tarifën, ashtu siç përcaktohet në UA 02/2012, 11.60 euro me TVSH për tarifat e përkohshme noteriale, e nënshkroi këtë akt pa asnjë vërejtje.

Ky akt është hartuar në një faqe dhe një fletë.

Prishtinë, 23.12.2014  
Autorizimdhënësi  
Samir Rexha

---